RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT "FINANCIAR" TË USHTRUAR NË BASHKINË PATOS"

Tiranë, 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtimet	1-3
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	4-13
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-11
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	11-13
II.	**HYRJA**	13-19
1.	Objekti i auditimit	14-15
2.	Qëllimi i auditimit	15-15
3.	Identifikimi i çështjes	15-15
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	15-15
5.	Përgjegjësitë e audituesve	16-17
6.	Kriteret e vlerësimit	17-17
7.	Standardet e auditimit	17-18
8.	Metodat e auditimit	18-18
9.	Dokumentimi i auditimit	18-19
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	19-20
10	**-**Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	19-20
	IV. **Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**	20-91
11	**1**Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	20-47
	2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	47-75
12	**3.** Vlerësimi i raportimit financiar	75-90
14	**4.** Ankesa	90-91
	IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	91-102
	V. ANEKSE	102-149

Shkurtimet

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonimë
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të Programit të Auditimitnr.51/1 prot., datë 18.01.2022,miratuar nga Kryetari i KLSH,nga data 09.01.2022, deri më datën 25.02.2022 në institucionin Bashkia Patosu krye në teren auditimi ñFinanciarò.

Auditimi mbuloi periudhën nga data01.01.2019 deri më datën 31.12.2021dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike dhe të ardhurat. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve tëauditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 5 akt konstatime dhe një akt verifikim.

Në datë 25.02.2022, nga grupi i auditimit të KLSH u zhvillua takimi për ballafaqim e problematikave në ambientet e Bashkisë Patos me punonjësit e Bashkisë. Nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe Projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Auditimi në terren ka filluar në datën 19.01.2022 dhe ka përfunduar në datën 25.02.2022.

Projektraporti i auditimit është nisur në subjekt me shkresën nr. 51/3prot., datë23.03.2022 dhe me shkresën nr. 120/10datë20.04.2022 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me 51/5prot, datë 26.04.2022, Bashkia Patos është njohur me projektraportin e auditimit në datën 25.03.2022 dhe me shkresën e sipërcituar janë paraqitur në KLSH observacione lidhur me projektraportin e auditimit.

Takimi përmbyllës midis punonjësve të Bashkisë Patos dhe grupit të auditimit nuk u realizua, pasi me shkresën nr. 120/10, datë 20.04.2022 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me 51/5 prot, datë 26.04.2022, Bashkia Patos ka shprehur dakortësin mbi vazhdimin e procedurave pasi nuk u pa e arsyeshme zhvillimi i një takimi ballafaques.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, nga Bashkia Patos nuk është krijuar një bazë e plotë dhe e saktë të dhënash, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, vlera e likuiduar dhe e pa likuiduar dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave. Gjithashtu nuk është kryer rakordim me këta agjentë në lidhje me	66-75	*E lartë*	**Rekomandim:**Bashkia Patos, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera

detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Patos, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga Dega e Thesarit Fier. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., si dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, kreu VIII ñ*Vlerësimi tatimor*ò, etj.			përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Patos, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj,), për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.
Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë për taksën e ndërtesës, Bashkia Patos nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave. Nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Bashkia Patos nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse është aksionare e vetme e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Patos ShA dhe bazuar në pikën (ii) , neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore. Nga auditimi i taksës së ndërtesës, rezulton me vlerë debitore prej **16,247,474 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i kësaj takse deri në datën 31.12.2021.	66-75	*E lartë*	**<u>Rekomandim:</u>**Bashkia Patos të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë. **<u>Rekomandim:</u>**Bashkia Patos, të marrë masa për të propozuar dhe ɨ miratuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Patos ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për

Nga auditimi i tarifës së pastrimit, rezulton me vlerë debitore prej **25,922,986 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i kësaj tarife në datën 31.12.2021. Nga auditimi i tarifës së shërbimit vaditje dhe kullim, rezulton me vlerë debitore prej**2,337,424 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i kësaj tarife deri në datën 31.12.2021. Në total, vlera e të ardhurave të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve është **44,507,884 lekë**. Kjo vlerë debitore është e pa kontabilizuar. Gjithashtu nga auditimi, rezulton se sipas ligjit 7501 ñ*Për tokën*ò, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 4,042 familje dhe 5,588 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 44 %. Nga 4,042 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 2,563 familje ose më shumë se gjysma janë debitore për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit. Nga auditimi i taksës së tokës, rezultoi vlera totale debitore**40,491,275 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., si dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, kreu VIII ñ*Vlerësimi tatimor*ò, etj. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj.,, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, kreu VIII ñ*Vlerësimi tatimor*ò,, ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.			arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët. **<u>Rekomandim:</u>**Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitore prej **44,507,884 lekë**.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se Bashkia Patos ka të mbartura nga ish-komuna Ruzhdie 52 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore, të cilat janë lidhur në vitet 2009-2012. Detyrimi për pagesën e qerasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në Njësinë Administrative Ruzhdie. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëriten gjatë vitit, pagesat e tokës me qera nuk janë bërë në mënyrë të rregullt, duke rezultuar në një vlerë debitore në totale **1,612,831 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar nga struktura e financës. Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tokën lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.	66-75	*E lartë*	**<u>Rekomandim:</u>**Bashkia Patos të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuardetyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,612,831 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.
Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për periudhën objekt auditimi, janë dhënë 1,526 leje legalizimi për 312,567 m^2 sipërfaqe ndërtimi, me vlerë investimi prej 9,842,890,526 lekë. Shuma totale e taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhetj vjelë për këtë vlerë investimi (0.5%) është 49,214,453 lekë. Personave të cilët janë paraqitur vullnetarisht në Bashkinë Patos për të bërë pagesën e taksës u është faturuar dhe vjelë vlera 15,816,320 lekë. Diferenca prej **33,398,133 lekë**, e cila nuk është shlyer nga 1,006 posedues të lejeve të legalizimit, për një sipërfaqeje prej 221,087 m^2, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë	66-75	*E lartë*	**<u>Rekomandim:</u>**Bashkia Patos nëpërmjet bashkëpunimit institucional të kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi

03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 9 dhe 27; VKB Patos ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Patos*ò, etj.			pranë Bashkisë Patos. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve,të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **33,398,133 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë, sipas listës në aneksin pasqyrë nr. 15 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Gjetje nga auditimi:Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave vendore në Bashkinë Patos, rezultoi se ka 142 subjekte debitore nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesisi në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Në fund të vitit 2019 numri i debitorëve është 49 subjekte në vlerën ~~prej~~ 1,216,763 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve është 142 subjekte në vlerën prej 3,984,802 lekë. Vlera progresive e taksave dhe tarifave vendore të papaguara deri në fund të vitit 2021 (përfshirë vlerën debitore para vitit 2019) është **11,346,600 lekë** (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba). Kjo vlerë përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Patos nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur vlera e gjobës (kamatëvonesës) në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò me	66-75	*E lartë*	**<u>Rekomandim:</u>**Bashkia Patos, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej **11,346,600lekë** (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba, sipas, sipas listës në aneksin nr. A-16, A-17 dhe A-18 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur rrugët e mëposhtme: ***a. T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.** ***b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit***, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme. ***c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar***, Sektori i

ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.			zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar. ***d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset***, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Patos, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Patos ushtrojnë aktivitetin 11 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Për subjektin E. 11 OE, me NUIS L.....H, pavarësisht se ka sekuestro konservative për asetet, qëllimi i sekuestros është ndalimi i shitjes së aseteve, statusi në QKB është ñAktivò dhe duhett të pajiset me licencë për tregtimin e hidrokarbureve, duke plotësuar dokumentacionin dhe likuiduar detyrimet përkatëse. Për subjektin G.ShPK, me NUIS L.....A, licenca e të cilit ka përfunduar në datën 21.09.2020 dhe për periudhën e mëparshme është debitor në vlerën 900,000 lekë, është llogaritur e gjithë vlera e papaguar, për të cilën ky subjekt është debitor. Për subjektin B.ShA Zharrëz, me NUIS K.....H, është licencuar për tregtimin me shumicë të hidrokarbureve dhe nuk është subjekt i licencimit nga pushteti vendor. Pagesat e kryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitore për subjektet e pajisura me autorizime për tregtimin e hidrokarbureve janë paraqitur**,** në aneksin nr. A-22 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Vlera prej **5,550,000 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të*	66-75	*E lartë*	**<u>Rekomandim:</u>** Nga Bashkia Patos të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikanëte dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **5,550,000 lekë,** sipas listës/pasqyrës aneks nr. A22 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të AuditimitNë rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren

*kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.			veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.
Gjetje nga auditimi: Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Edhe pse për periudhën objekt auditimi janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi si dhe nuk janë planifikuar pozicione me status ñ*ekselent*ò, si dhe pozicione me status ñ*Grup i veçantë*ò, ku përfshihen 17 kategori të ndryshme. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk ka programe të licencuara e për rrjedhojë programet me të cilat punohet nuk garantojnë mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017ò Për financat e vetëqeverisjes. vendoreò, urdhrin e Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017.	20-39	*E mesme*	**<u>Rekomandimi:</u>**Nga Nëpunësi Autorizues, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. **<u>Rekomandimi:</u>**Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa që në rregulloren e brendshme të përcaktohen qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.
Gjetje nga auditi Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos më 31/12/2021 paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Patos ShA me NUIS ñJ.....B dhe numër aksionesh 1,000 me vlerë nominale 14,530 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 14,530,000 lekë. Në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.	75-90	*E lartë*	**<u>Rekomandimi</u>:** Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ñUjësjellës Kanalizime Patos ShA me vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Gjetje nga auditimi. Llogaria 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò, më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 28,878,324 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,392,300 lekë, për 41 subjekte të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.Gjatë vitit 2021 shesta janë në vlerën 10,775,298 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 9,261,321 lekë për 12 subjekte. Nga analiza e llogarisë u konstatua se për 26 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 4,186,584 lekë të garancisë së punimeve sipas aneksit nr.11, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit nuk është bërë likuidimi i vlerës së mësipërme të garancisë, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për likujdimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interespublik të këtyre fondeve, në rastet kur në objekt janë konstatuar parregullsi të cilat nuk janë riparuar nga kontraktori, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50.*	75-90	*E lartë*	**Rekomandimi:**Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të njoftoj subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.

3. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit
OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i pamodifikuar, me "Theksim çështjeje"[1]:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Patos, për vitin ushtrimor 2020 dhe 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705[2], dhe ISSAI 1200[3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e

[1] ***Opinioni i pamodifikuar me theksim çështjeje.*** *Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.*

buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi ñTheksimi i Çështjesò, të cilat edhe pse ekzistojnë, nuk ndryshojnë opinionin e dhënë.

Baza për opinionin e pamodifikuar, me Theksim çështjeje:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Patos, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit.

Theksimi i çështjeve:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Patos, sa i takon llogarive të mëposhtme**:**

Llogaria 466 ñKreditore për mjete nën ruajtjeò, është mbivlerësuar për vlerën 4,186,584 lekë, në fund të vitit 2021;

Llogaria 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò, është nënvlerësuar për vlerën 14,530,000 lekë, në fund të vitit 2021;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Patos:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit regullative në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Patos janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[4], nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur

---

[2] *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

[3] *Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi*

[4] *ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.*

kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhett të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Hyrja (Të dhëna mbi raportin e auditimit)

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, në zbatim të Programit të Auditimitnr. 51/1 Prot., datë 18.01.2022, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Patos nga data 19.01.2022 deri në datën 25.02.2022, u krye ñ*Auditim Financiar*ò, për periudhën nga 01.01.2019 deri më 31.12.2021, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. Z. H.I
2. Z. J.P
3. Znj. S. J.

a- <u>Titulli:</u> Auditim financiar në Bashkinë Patos.

b- <u>Marrësi:</u> Raporti Përfundimtar i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Patos.

1. <u>Objektivat dhe Qëllimi i Auditimit</u>

- Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2. <u>Identifikimi i çështjes</u>

Projektraporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Patos, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

3. <u>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>

Kryetari i Bashkisë, znj. R.B, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. M.SH, Drejtore e Drejtorisë së Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, ñ*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*ò, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, etj.

4. <u>Përgjegjësitë e audituesve</u>

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.
Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhett të vlerësojë:
- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;
Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.
Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Patos, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

5. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò;
- ***Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:***

- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò
- Ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2019*ò, Ligji nr. 88/18.12.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2020*ò dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 ñ*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*ò
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015;
- VKM 783 datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*ò;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 ñ*Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*ò, etj;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò;

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 ñ*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ò ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e buxhetit vendor*ò;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 ñ*Për buxhetin e vitit 2018*ò, pikat 82-91 ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò,
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò,
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2019*ò, pikat 106-110, ñ*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ò, dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore''*.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, ñ*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*ò), Fletore zyrtare 196/2014;

- ***Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:***

- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuarligjin nr. 9477 datë 9.2.2006*ò, aktualisht i shfuqizuar;
- VKM nr. 248, date 10.4.1998 ñ*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*ò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*ò;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ñ*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 ñ*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj*ò;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ò, i ndryshuar;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 ñ*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*ò.

- ***Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:***

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në RSH*ò, i ndryshuarò;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Lokale*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*ò, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, ñ*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*ò;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar;

- ***Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:***

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñ*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, ñ*Për Nëpunësin Civil*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, ñ*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të*

*shpërblimeve*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, ñ*Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, ñ*Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore*ò, i ndryshuar;

- *Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH";*
- *Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së";*
- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 ñParimet themelore të Auditimit të Sektorit Publikò, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 ñUdhëzues të Auditimit Financiarò;
- ISSAI 2300 ñPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareò;
- INTOSAI GOV 9100 ñUdhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publikò si dhe INTOSAI GOV 9110 ñUdhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëmò;
- ISSAI 400 ñParimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisëò, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 ñPrezantim i përgjithshëm i Udhëzimeve për Auditimin e Përputhshmërisëò; si dhe ISSAI 4200 ñUdhëzime për Auditimin e Përputhshmërisëò;
- INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7. Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:
- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet

sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

- ***Kontrolli aritmetik***

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- ***Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese***

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar.

- ***Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese***

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- ***Kontrolli i vlerësimeve***

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhett të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- ***Konfirmimi nga të tretët***

Transaksionet e përzgjedhura për tõju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- ***Kontrolli sipas një treguesi***

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna ñjashtë normalesò, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- ***Intervista***
- ***Raporte dhe Informacione***
- ***Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK***

8. Praktikat e ndjekura

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke

krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.
Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tâu audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231).
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[5].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky ProjektraportAuditimi.
Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- ***Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim***

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhett të ishin regjistruar janë regjistruar.

[5] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- ***Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës***

Ekzistenca:Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.
Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhett të ishin regjistruar janë regjistruar.
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- ***Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese***

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhett të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Patos

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Patosit kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkinë Mallakastër dhe në lindje me Bashkinë Roskovec. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Patosi.
Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011 Bashkia e re Patos ka një popullsi prej 22.959 banorësh, ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banues 42.738 banorë. Territori i Bashkisë së re është vetëm 82.5 km^2. Në bazë të të dhënave të regjistrit civil densiteti i popullsisë është 518 banorë për km^{2,} ndërsa në bazë të censusit densiteti i popullsisë është 278.3 banorë për km^2.

Të dhëna të tjera: Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si ñPatos-Marrinzaò është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur.
Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdiakanë si burim kryesor

ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.
Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fasone. Për shkak të relievit malor, në këtë bashki ka zona të largëta me qendrën e Bashkisë, popullsia e tyre është reduktuar ndjeshëm për shkak të zhvendosjes drejt qendrave urbane të vendit ose drejt vendeve fqinje.
Kuadri ligjor:
BashkiaPatos e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.
Kryetar i Bashkisë Patos është Znj. R.B dhe Këshilli Bashkiak përbëhet nga 21 anëtar.

IV. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

1. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Bazuar *<u>në Misionin</u>* e Vetëqeverisjes Vendore ñ*për të* siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëveò nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; *<u>në Vizionin</u>* e Bashkisë së Patosit dhe Objektivat Strategjikë përshkruar hollësisht në ñPlanin e Përgjithshëm Vendorò, ku citohet se ñ..zhvillimi i ardhshëm orienton bashkëjetesën e industrisë me bujqësinë, duke strukturuar vendbanimet, rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për tôi shërbyer popullsisë së rajonit të Fieritò[6]; referuar dhe Ligjit nr.10296 dt.08.07.2010, kreu III ñKomponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollitò, neni 19, në të cilin citohet: *"Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetri: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi, Monitorimi*ò, Bashkia e Patosit (BP), ka përgatitur pyetësorin e vetëvlerësimit për dy vite (2019 & 2020) dhe më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i Kontrollit

Referuar nenit 20 të Ligjit nr.10296 ñMenaxhimi Financiar dhe Kontrolliò, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit"*; neni 9 pika 4/a *"Përgjegjshmëria menaxheriale e*

klit të MFK sipas Manualit të MFK miratuar me Urdhër të
i nr.108/2016.

*Nëpunësit Autorizues*ò, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV ñ*Zbatimi i MFK*ò, pika, 4,2,10/a ñ*Roli i nëpunësit autorizues të njësisë*ò, janë hartuar ñPlan i Përgjithshëm Vendorò me Fokus Strategjia Territoriale, Zhvillimi i Territorit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor si dhe ñRregullore e Planit Vendoròmiratuar meVKB nr.48 datë 04.12.2020 dhe VKKT nr.2 datë 28.12.2020, të cilëtpërmbajnë objektivat strategjikë dhe rregullat e zhvillimit me instrumentet për zbatueshmërisë e tyre për periudhën 2019 e në vazhdim..

1.1 **Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues.**

a. Bashkia e Patosit gjatë periudhës nën auditim 2019-2021 ka funksionuar me 3 (tre) rregullore ñMbi organizimin**,** funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Patos**",** hartimi dhe miratimi i të cilave është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò neni 9 pika 1/1 gërma ôbô, Kodit të Punës, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] të çdo viti respektiv ñMbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagaveò si dhe Vendimit të Kryetares ñPër miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Patosò. Këto Rregullore janë miratuar me Vendim të Kryetares nr.44 datë 09.01.2018 dhe ka funksionuar dhe *<u>për vitin 2019</u>*; Vendimi i Kryetares nr.53 datë 07.01.2020 *<u>për vitin 2020</u>* dhe Vendimi i Kryetares nr.31 datë 05.01.2021 *<u>për vitin 2021</u>* e në vazhdim. Nga auditimi rezultoi se për periudhën nën auditim, Strukturat organizative dhe Organigramat përkatëse të miratuara, janë *shoqëruar me miratimin e RRRregullores së re ku gjejnë pasqyrim ndryshimet.*

b. *Mbi respektimin e etikës* nga punonjësit e institucionit, Bashkia e Patosit ka miratuar me Vendim të Kryetares nr.52 datë 07.01.2020 *"Kodin e sjelljes për Bashkinë Patos"* në zbatim të Ligjit nr.9131, datë 8.9.2003 ñPër rregullat e etikës në administratën publikeò, Ligji nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò neni 9, pika 1/1 gërma ôbô. Nga auditimi u konstatua se deri në fund të vitit 2019 Bashkia e Patosit nuk ka funksionuar me Kod Etike të veçantë. Kodi i Etikës i miratuar ka shërbyer për vitin 2020, 2021 e në vazhdim.

c.Bashkia e Patosit deri në fund të vitit 2019 nuk ka disponuar një Rregullore të posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Me Vendimin e Kryetares nr.3480 datë 24.12.2019 është miratuar *"Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit"* e cila ka shërbyer për vitet 2020, 2021 e në vazhdim.
ñKodi i Etikësò dhe ñ Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesitò përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhett të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cënimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

1.2. Politika menaxheriale dhe stili i punës.

Punësimi në Bashkinë e Patosit bëhet në zbatim të Ligjit nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, Ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar dhe Ligjit nr.7961 /1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëô i ndryshuar, VKM nr.243/2015 i ndryshuar me VKM nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë së Patosit: - Drejtoria e Burimeve Njerëzore [DBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar dhe VKM nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr.243/2015 i ndryshuar ;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e, ë, f, g të Ligjit nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò.

Skema e procedurës së punësimit

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Patosit hartojnë në fillim të çdo viti Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, konform Ligjit nr.152/2015 ñPër nëpunësin civilò neni 18, VKM nr. 108/2014 ñPër plani vjetor të pranimit në shërbimin civilò, VKB ñMbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyreò si dhe Vendimeve të Kryetares ñPër miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Patosò për çdo vit ushtrimor. Planet vjetore janë miratuar respektivisht: për *vitin 2019* me nr.202 datë 18.01.2019; për *vitin 2020* me nr.475 datë 17.02.2020 dhe për *vitin 2021* me nr.466 datë 05.02.2021 dhe janë hartuar mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Publikimi i vendeve vakanëte nga ana e Bashkisë së Patosit bëhet në faqen zyrtare të saj, konform VKM nr.243/2015 ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò i ndryshuar Kreu II pika 6.

Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhett të plotësohen nga kanëdidatët, janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla*Politikat e burimeve njerëzore duhett të garantojnë kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye kriteret duhett të jenë pjesë në Rregulloren e brendshme të Bashkisë, neni ñpërshkrimet e punësò. DBNJ nga ana e saj pasi njihet me planin vjetor, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, duke zbatuar përcaktimet ligjore në fuqi, Ligjin nr.152/2015 ñPër nëpunësin civilò, VKM nr.108/2014 ñPër plani vjetor të pranimit në shërbimin civilò, VKM nr.243/2015 ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò i ndryshuar.

Gjithashtu DBNJ harton Formularët e Përshkrimit të Pozicionit të Punës të çdo pozicioni në strukturë, duke e bërë pjesë të dosjes në zbatim të VKM nr.142 datë 12.03.2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò, i ndryshuar. Ky formular është pjesë përbërëse e manualit të procedurave të njësisë publike.

Konstatim f.1.2. Rregullorja e Bashkisë së Patosit (në mungesë të manualit të procedurave, duhett të përmbajë dhe <Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës> për çdo pozicion të strukturës organizative, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar, Ligjit nr.10296/2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò i ndryshuar dhe ñManualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe VKM nr.142 datë 12.03.2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò, i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr120/10. datë 20.04.2022, nga z. SH.B në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm, protokolluar në KLSH me nr.51/5 datë 26.03.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Ne nuk jemi dakort me Konstatimin 1.2/a: Në rregulloren e Bashkisë së Patosit përshkrimet e punës së çdo pozicioni në strukturën organizative, nuk shoqërohen me përcaktimin e kritereve të përgjithshme dhe atyre specifike të nevojshme/të domosdoshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar,

për të cilën po ju sqarojmë si më poshtë:- Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë pasqyrohen vetëm funksionet, detyrat dhe proçedurat e punonjësve dhe nuk pasqyrohen kriteret e përgjithshme dhe specifike. Ligji nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò, nuk përcakton se kriteret e përgjithshme dhe specifike të pozicionit të punës duhett të pasqyrohen në Rregulloren e Brendshme. Është VKM nr. 142, datë 12.3.2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò, i ndryshuar, ajo që përcakton metodologjinë e hartimit të përshkrimit të Pozicioneve të punës ku përcaktohen edhe se kriteret e përgjithshme dhe specifike. Pra në këtë VKM është e përcaktuar qartë që kriteret e përgjithshme dhe specifike përcaktohen në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës i cili është dokument më vete dhe nuk është pjesë e rRRregullores së brendshme. Formulari i Përshkrimit të Pozicionit të Punës është hartuar nga ana e Bashkisë Patos për çdo pozicion pune dhe është në dosjen e çdo punonjësi dhe është kontrolluar nga Audituesi i KLSH-së. Bashkëlidhur po vendosim disa Formular të përshkrimeve të pozicioneve të punës ku përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>: Lidhur me observacionin tuaj mbi përshkrimet e punës ju sjellim në vëmendjen tuaj se referuar ligjit nr.10296/2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe ñManualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò për plotësimin në tërësinë e tyre të kërkesave për 5(pesë) Komponentët e MFK- së, duke cituar te ñStili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimitò Ÿ Politikat dhe praktikat që lidhen me Burimet Njerëzore, ndër të tjera citohet se../.. Politikat e burimeve njerëzore duhett të garantojnë Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në proçesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent../..; gjë e cila *<u>në mungesë të Manualit të Procedurave</u>*, duhett të ishte e përshkruar në një dokument rregullator apo manual dhe konkretisht në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë. Mungesa e përcaktimit të kritereve profesionalë dhe arsimorë është edhe një ndër arsyet e mosplotësimit të të njëjta vendeve vakanëte për një periudhë më shumë se një vjeçare.(trajtuar në materialin e mëposhtëm).<Formulari i Përshkrimit të Pozicionit të Punës> hartuar në zbatim të VKMï së 142 datë 12.03.2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò, i ndryshuar është pjesë e Manualit të Procedurave të njësisë publike, por në mungesë të tij nga ana juaj, ky formular ashtu si lista e proceseve kryesore të punës emërtuar nga ju <matrica>, duhetj të ishte pjesë përbërëse e RRregullores së funksionimit, duke mos e lënë këtë formular të veçuar por të inkorporuar në një dokument rregullator bazë. Për sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

- Në Bashkinë e Patosit Struktura organizative ka pësuar ndryshime nga viti në vit, ndryshime të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetares së Bashkisë si dhe janë pasqyruar në Rregulloren e Brendshme. Drejtoria e Burimeve Njerëzore si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë e Patosit, mbështetur në nevojat që pasqyrohen në Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetare e Bashkisë: *<u>Për vitin 2019</u>* me nr.202 datë 18.01.2019, *<u>për vitin 2020</u>* me nr.475 datë 12.02.2020 dhe *<u>për vitin 2021</u>* me nr.466 datë 05.02.2021. Vendet vakanëtekanë qenë prezentë si në strukturën ekzistuese ashtu edhe në ato të rejat. Kjo si rezultat i ristrukturimeve të Drejtorive apo sektorëve që janë shoqëruar edhe me pozicione të

reja apo suprimime të tyre. Një pasqyrim i vendeve vakanëte në Bashkinë e Patosit (administrata dhe njësitë administrative) jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Viti	Numri sipas planit	Numri në fund viti	Njësi / pozicion i ri	Kërkesa të përsëritura
1	2019	12	9	-	1
2	2020	22	11	1 6	5
3	2021	15	10	1 4	10

Konstatim f.2 Nga auditimi i procesit të planifikimit për punësim dhe i strukturave organizative të Bashkisë së Patosit, të dhënave statistikore të të cilave pasqyrohen në tabelën e mësipërme, vihet re se vjen në rritje numri i kërkesave për punësim dhe po ashtu edhe numri i kërkesave të përsëritura për të njëjtat pozicione vakanëte.
Nga auditimi rezulton se vendet vakanëte në Bashkinë e Patosit janë krijuar jo vetëm si rezultat i ristrukturimeve, por edhe si rezultat i funksionimit të kontrolleve të brendshme. Një pasqyrim më i detajuar i numrit dhe arsyen e krijimit të vendeve vakanëte, jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Arsyeja e lirimit të vendeve	2019	2020	2021
1	KMCAP	1	0	1
2	Pension	13	17	20
3	Largim me Dëshirë	13	10	8
4	Shkurtime	1	1	2
5	Kontrate	3	2	2
6	Largim për mosparaqitje ne pune	3	2	1
7	Ndërruar jete	0	2	0
8	Mase disiplinore	1	0	0
TOTALI		**35**	**34**	**34**

Numri i Personelit në Bashkinë e Patosit referuar strukturave organizativeve, ka ardhur në rritje, por i paplotësuar sipas planit ndonëse edhe numri faktik i tyre ka ardhur në rritje. Situata e personelit në Bashkinë e Patosit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 sipas planit dhe faktit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

STRUKTURA		2019		2020		2021	
		PLAN	FAKT	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT
1	Administrata	112	108	121	114	121	116
2	Njësia Administrative Zharrëz	6	6	6	6	6	6
3	Njësia Administrative Ruzhdie	4	4	4	4	4	4
4	Ndërmarrjet Vartëse	233	228	235	231	235	230
Vende vakanëte për pozicion		**9 (2.4%)**		**11 (3%)**		**10 (2.7%)**	
Totali		**365**	**356**	**366**	**355**	**366**	**356**
Numri i të punësuarve		**395**		**399**		**396**	

Konstatim f/3 Në strukturën organizative të Bashkisë së Patosit (me ndërmarrjet e varësisë) ka vende vakanëte, ku numri më i lartë është në aparatin e Bashkisë dhe më i ulët në ndërmarrjet e varësisë së bashku.
Konstatim f/4 Në strukturën e Bashkisë së Patosit nuk janë planifikuar pozicione me status ñekselentò në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017; si dhe pozicione me status të ñGrup i veçantëò ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme si persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj.) si personel administrativ, në kundërshtim kjo me **Ligjin nr. 152/2013** ñPër Nëpunësin Civilò i ndryshuar **neni 5** ñAdministrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e

shanseve të barabarta, mos diskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civilò; **Ligjin nr.93/2014** ñPër Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuaraò **neni 1/a** ñpërcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerëtò; **neni 2 pika a** ñtë garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; **pika b** ñtë përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qëndrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëriò; **neni 4 pika a "**mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanëò; **pika b** ñbarazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabartaò; **pika ë "**realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cënuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuaraò; **Ligjin nr.15/2019** dt.13.03.2019ñ Për Nxitjen e Punësimitò **neni 3 pika 4** ñGrupe të veçantaò janë punëkërkues të disavantazhuar në tregun e punës (17 kategori sociale); **neni 20** ñPunësimi i personave nga grupet e veçantaò **pika 1/a** ñÇdo punëdhënës duhett të punësojë një person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja ñcò, të këtij ligji, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes ñdhe **pika 1/b** ñnga një person shtesë, sipas grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja ñcò, të këtij ligji, për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronja ñaò të kësaj pikeò; **pika 2** ñPunëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 100% të pagës minimale në shkallë vendiò; **pika 3** ñPunëdhënësit marrin masat e nevojshme për plotësimin e vendeve të lira të punës me personat që i përkasin grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja ñcò, të këtij ligjiò.

b. Nga Bashkia e Patosit janë dërguar çdo vit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik/Drejtoria e Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit në përgjigje të shkresave që kjo e fundit u dërgon bashkive: Pyetësorët e Vetëvlerësimit dhe Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2019 nr. 3353/1 prot., datë dhe 24.02.2020; për vitin 2020 nr. 10/1 prot.,datë 25.02.2021; ndërsa për vitin 2021 është në proces. Bashkia Patos konfirmon mungesën e ñgjurmës së auditimitò për të cilën na komunikoi se strukturat përgjegjëse po punojnë për miratimin sa më shpejt të saj; në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

1.3. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia e Patosit funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen vendoreò dhe Organikë të miratuar nga Këshilli Bashkiak:



Skemë e thjeshtuar e strukturës

A. Organi Përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak
B. Organi Ekzekutiv i Bashkisë - Kryetari i Bashkisë

Gjatë periudhës 3 vjeçare 2019, 2020 dhe 2021 që ne po auditojmë, struktura organizative e Bashkisë së Patosit ka pësuar disa ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak si dhe janë pasqyruar në Rregulloren e Brendshme. Një pasqyrim të kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë së Patosit me njësitë bazë, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	VKB / Viti	Njësi Administrative	Institucione varësie	Drejtori	Sektor	Punonjës plan
1	VKB nr.80/2018 për 2019	2	10	9	19	365
2	VKB nr.83/2019 Për 2020	2	7	8	18	366
3	VKB nr.52/2020 për 2021	2	9	9	17	366

-*Mbi plotësinë e Organigramës si pjesë përbërëse e Strukturës Organike të Bashkisë së Patosit*. Në Vendimet e Kryetares së Bashkisë së Patosit janë miratuar Struktura Organizative Organigrama e të cilave nuk është e plotë në formën dhe përmbajtjen e saj, pasi në to pasqyrohen Departamentet dhe Njësitë përbërëse dhe mungon klasifikimi i pozicioneve të punës për çdo kategori me treguesit sasiorë të tyre (numri i personelit për çdo drejtori). Mungesa e treguesve sasiorë (të numrit të personelit) të çdo Njësie dhe emërtesa për çdo pozicion të tyre në Organigramën Institucionale, krijon pengesa për marrjen e një informacioni statistikor në kohë reale mbi kategoritë e proceseve të punës, por edhe numrin e personelit (faktik apo vakanët) që u përket. Kjo është në kundërshtim me ñManualin MFKò miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, dt. 15.07.2010 dhe atë nr.108/2016; ligjin nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò.

<u>Konstatim 1.3/a:</u> Organigrama e Bashkisë së Patosit nuk pasqyron klasifikimin pozicioneve të punës për çdo kategori me treguesit sasiorë të tyre (numri i personelit për çdo drejtori), duke mos dhënë një informacion të qartë mbi kategoritë e proceseve të punës (sipas llojit të diplomës/profesionit), si dhe numrin e personelit faktik apo të vendeve vakanëte, në moszbatim të përcaktimeve ligjore të Ligjit nr.90/2012 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetëroreò nenit 21 pika 1; ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò, VKM 142/2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkreswn nr120/10. datë 20.04.2022, nga z. SH.B në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm, protokolluar në KLSH me nr.51/5 datë 26.03.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u> Ne nuk jemidakort me **Konstatimin 1.3/a** *Organigrama e Bashkisë së Patosit nuk pasqyron klasifikimin pozicioneve të punës për çdo kategori me treguesit sasiorë të tyre (numri i personelit për çdo drejtori), duke mos dhënë një informacion të qartë mbi kategoritë e proceseve të punës, si dhe numrin e personelit faktik apo të vendeve vakanëte,* **për të cilën po ju sqarojmë si më poshtë:**

Organigrama e një institucioni është një paraqitje skematike e pozicioneve të punës të cilat pasqyrohen sipas hierarkisë së tyre. Organigrama ndërtohet për të përcaktuar varësinë e drejtorive, sektorëve dhe specialistëve me qëllim për të përcaktuar saktë dhënien e Urdhrave dhe hierarkinë e raportimeve për proceset e punës.

Klasifikimin pozicioneve të punës për çdo kategori me treguesit sasiorë të tyre (numri i personelit për çdo drejtori), përcaktohen në strukturën organizative të Bashkisë e cila mirtohet nga Kryetare e Bashkisë, kjo e përcaktuar në nenin 64 gërma ñjò të ligjit nr.139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò:

" j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil……".

Në strukturat organizative të Bashkisë Patos miratuar nga Kryetare e Bashkisë dhe që i është vënë në dispozicion KLSH-së për vitet 2019; 2020; 2021 janë përcaktuar klasifikimet e pozicioneve të punës për çdo kategori me treguesit sasiorë të tyre (numri i personelit për çdo drejtori).

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>: Lidhur me observacionin tuaj për përmbajtjen e Organigramës së Njësisë jo vetëm me tregues cilësorë, por edhe ata sasiorë ju sjellim në vëmendjen tuaj se organigrama si një paraqitje grafike e strukturës organizative, duhett të pasqyrojë një informacion të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë, mbi pozicionet, klasifikimin por edhe mbi numrin e personelit të planifikuar dhe faktik në dispozicion të tyre, në zbatim të nenit 21 pika 1/a, b të ligjit nr.90/2012 ku citohet se..../.... Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore përbëhet nga: **a)** struktura funksionale; **b)** organika e hollësishme e institucionit, që përfshin edhe klasifikimin e pozicioneve të punës, në bazë të legjislacionit të nëpunësit civil../...

Referuar bazës ligjore të sipër cituar, ndiejmë të domosdoshme tôju sjellim në vëmendjen tuaj se neni 21 pika /1, 2 e ligjit nr. 90/2012 të cilit i referohemi lidhur vetëm me organigramën si paraqitje grafike e strukturës së një institucioni (dhe jo vetëm shtetëror) është miratuar para ligjit nr.139/2015 ñPër Vetqeverisjen Vendoreò, dhe si e tillë roli dhe qëllimi i saj nuk kufizohet vetëm me institucionet shtetërore; Organigrama është një mjet informues dhe administrativ, pasi përfaqëson njësitë e strukturës (departamente, drejtori e sektorët e tyre) shpërndarjen e tyre, kompetencat, funksionet dhe kompetencat, si dhe informacionin në lidhje me atributet relacionale dhe strukturat hierarkike të ndërmarrjes. Në një farë mënyre, organigrama simbolizon parimet filozofike mbi të cilat bazohet struktura organizative e njësisë publike.

Për sa më sipër observacioni juaj *<u>nuk merret në konsideratë</u>* nga grupi i auditimit.

- Referuar Ligjit nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen vendoreò mbi funksionet e bashkive, po japim një pasqyrim se si është kompozuar Struktura e Bashkisë së Patosit në zbatim të funksioneve që i jep ligji.

Emërtimi i funksionit	Shërbimet	Njësia përgjegjëse në Strukturë/ Njësi Varësie
<u>1</u>.Infrastruktura dhe Shërbimet Publike	- Për Ujin e pijshëm	Ndërmarrje e Ujësjellës dhe Kanalizime - sha
	-Ujërat e ndotura, ujerat e shiut, mirëmbajtje e rrugëve, varrezat publike, etj	Ndërmarrje e Mirëmbajtjes urbane & rurale
	-dekori, gjelbërimi, etj.	Ndërmarrja e gjelbërimit
	-mbetjet e ngurta,	Ndërmarrja e pastrimit
	-Sistemi arsimor parashkollor	Drejtoria e arsim, kultura, sport & kopshte e çerdhe

	-Shërbimi parësor shëndetësor	Nuk ka
	-Plan, zhvill kontrolli i territorit	Drejtori e Planif Urban
2.Shërbimet sociale	- Shërbimet sociale	Drejtoria e Shërbimit Social./ Drejtori e politikave dhe monitorimit te shërbimeve
3.Kultura, sporti dhe shërbimet argëtuese	-Trashëgimia kulturore, identiteti lokal, biblioteka, sporti	Drejtoria e arsim, kultura, sport
4.Mjedisi	- Ajri, toka, uji, zhurmat, aktivitete edukuese	Sektor ne Drejtorinë e bujqësisë
5.Bujqesi, pyje, kullota, natyre, biodiversitet	- Infrastrukturë e ujitje kullimit, toka bujqësore, informimi bujqësor e blegtoral, skemat e granteve, pyje & kullota, natyra &biodiversiteti	Drejtoria e zhvill bujq bleg pyjor mjedis & kontroll i ushqimit
6.Ekonomia vendore	- Plane strategjike, tregjet, biznesi i vogël, grante për biznesin, informim publik etj.	Drejtori e te Ardhurave Vendore / Drejtoria e Integrim evropian Ÿ Sektori i Zyrës me një Ndalesë
7.Siguria publike	- Mbrojtja civile, parandalim dhe zgjidhje konflikti, kundërvajtjet administrative, - shërbimi zjarrfikës	-Policia Bashkiake - Inspektoriati i ndërtimor - MZSH

- Nga tabela vërejmë se për funksionin ñMbrojtja e Mjedisitò neni 26, në strukturën e Bashkisë së Patosit ky funksion nuk mbulohet nga një njësi e veçantë, por ka një Sektor ñSektori i pyjeve dhe i mjedisitò me nr. të personelit (1+5) ku një prej tyre është specialist mjedisi, në ñDrejtorinë e zhvillimit bujqësor, blegtoral, pyjor, mjedisit dhe kontrollit të ushqimitò. Nga ana e Bashkisë na u komunikua se ky sektor dhe specialisti që mbulon mjedisin, janë efektivë në zbatimin e detyrave funksionale te tyre.
- Gjithashtu funksioni ñShërbimi i shëndetit parësorò pika 13 neni 23, në strukturën e Bashkisë së Patosit nuk ka njësi në funksion të këtij shërbimi; në strukturën organizative ñDrejtoria e Arsimit, Kulturës dhe sporteveò ka një pozicion ñpërgjegjëse e çerdhesò me profesion ñinfermiereò.

Konstatim. struktura e Bashkisë së Patosit rezulton që nuk mbulon me njësi të veçanta (drejtori ose sektorë) ñShërbimi parësor shëndetësorò shërbim i përcaktuar në funksionin 1, duke mos zbatuar kështu përcaktimet në nenin 23 pika 13 t ligjit nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen vendoreò .

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkreswn nr120/10. datë 20.04.2022, nga z. SH.B në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm, protokolluar në KLSH me nr.51/5 datë 26.04.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Ne nuk jemi dakort me konstatimin e faqes 18 të projekt raportit ku citohet se ... struktura e Bashkisë së Patosit rezulton që nuk mbulon me njësi të veçanta (drejtori ose sektorë) ñShërbimi parësor shëndetësorò shërbim i përcaktuar në funksionin 1, duke mos zbatuar kështu përcaktimet në nenin 23 pika 13 të ligjit nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen vendoreò për të cilën po ju sqarojmë si më poshtë: Pika 13 e nenit 23 ñFunksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publikeò të ligjit nr. 139/2015 ñPër Vetqeverisjen Vendoreò shprehet se Bashkia është përgjegjëse edhe për ñ*Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj"*. Mbështetur në këtë pikë të nenit nuk flet për kalim të funksioneve por vetëm për mirëmbajtjen e objekteve. Mirëmbajtje e cila bëhet nga Agjencia e Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Patos.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me observacioni tuaj, bazuar në pikën 13 të nenit 23 të cilës edhe ju i referoheni si edhe ne, pjesa e parë e tij mbi ndërtimin , rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor është përgjegjësi e Bashkisë dhe që realizohet (detyrë funnksionale) e Agjencisë së Shërbimeve Mbështetëse: ndërsa përsa i përket zhvillimit të aktiviteteve edukuese e promovuesenë nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, nuk rezulton asnjë njësi e strukturës që ta realizojë. Pra konstatimi i grupit të auditimit nuk ka të bëjë me kalimin e funksioneve , por me mos mbulimin e këtij funksioni nga struktura sipas përcaktimeve të neni 23 pika 13.Pra rezulton që ky funksion realizohet pjesërisht. Sa më lart, observacionet e paraqitura nuk do të merren në konsideratë.

1.4. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Bashkia e Patosit aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, ku janë pasqyruar të gjitha ndryshimet që ka pësuar Struktura organizative e Bashkisë. Rregullorja e Brendshme përmban: bazën ligjore dhe fushën e zbatimit, strukturën organizative, funksionet menaxheriale, rregulla të përgjithshme, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e çdo njësie dhe pozicioni, të drejtat dhe detyrat e personelit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Bashkia e Patosit deri më sot nuk disponon Listën (Hartën) e proceseve/Manualin e Procedurave, ku të jenë pasqyruar të gjitha proceset e punës, por ka hartuar dhe miratuar si pjesë të RRRregullores me emërtesën ñshtojcaò matricat e procedurave të produkteve për njësitë kryesore të Strukturës.

1.5. Aftësitë profesionale të punonjësve.

Për të audituar dosjet e personelit përzgjodhëm dosjet e të punësuarve për vitet 2019, 2020 dhe 2021 në aparatin e Bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil, me Kod Pune. Emërimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin civilò dhe Kodit të Punës.

- a *Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit* u kërkuan dosjet e punonjësve të emëruar në Bashkinë e Patosit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të të gjitha kategorive apo dhe lëvizjeve të personelit /ngritjet në detyrë të kësaj periudhe.

Konstatim 1.5/a: Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjodhëm), emëruar në 2019-2020-2021 u vu re se nuk zbatohej i njëjti standard për plotësimin me dokumentacionin përkatës të dosjeve të personelit për aparatin e Bashkisë me ato të ndërmarrjeve të varësisë.

- Dosjet e personelit të administratës së Bashkisë nuk kanë të unifikuar Formulari Tip ñFletë Inventariñ, nuk ka të listuar emërtesat e dokumentacionit domosdoshmërish përbërës të dosjes ku të jenë të specifikuar dhe dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim. Në këto dosje u konstatuan këto mangësi: disa raste të dokumenteve të arsimimit dhe kualifikimeve fotokopje të pa noterizuara; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; formular i Vetdeklarimit, deklarata e kodit të etikës etj.
- Ndërsa te dosjet e personelit të ndërmarrjeve të varësisë bashkë me mangësitë e mësipërme, rezultojnë edhe mangësi të dokumentacionit bazë: kontrata e punës, raporti mjekësor, dokument identifikues dhe certifikatë e gjendjes familjare, dëshmi penaliteti apo vërtetime të Prokurorisë dhe Gjykatës etj. Mos lidhja e kontratës nga ana e titullarit është në kundërshtim me dispozitat e ligjit me nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, neni 21 pika 1, 2, 3 ,4 të cilat përcaktojnë *formën e shkruar të kontratës, elementët që duhett të përmbajë kontrata, dhe faktin që kur kontrata nuk është nënshkruar për arsye të justifikueshme sipas pikës 1 dhe 3,* ***punëdhënësi duhett ta lidhë atë brenda 7(shtatë) ditëve nga dita e punësimit.***

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr.152/2013 i ndryshuar ñPër nëpunësin civilò neni 17 pika 1,4; VKM nr.117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2.
Personeli i burimeve njerëzore dhe protokoll arkivës (për protokollimin e kontratave të punës) duhett të rishikojë çdo dosje të personelit rekrutuar edhe para vitit 2019, për ti plotësuar me dokumentacionin përkatës (në rast mungese) konformstandarteve të përcaktuara në Ligjin 152/2013 neni 17 pika 1,4 ku citohen: "Çdo institucion shtetëror, institucion i pavarur dhe njësi e qeverisjes vendore krijon dhe administron dosjen e personelit të çdo të punësuari të institucionit (dosja individuale). Dosja individuale përmban të dhënat profesionale për çdo të punësuar dhe nëpunës civil, si dhe çdo të dhënë tjetër, lidhur me marrëdhëniet e punës" dhe *"Këshilli i Ministrave përcakton rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe Regjistrit Qendror të Personelit, të dhënat që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe të përdorimit të të dhënave"; si dhe VKM nr.117 dt. 05.03.2014 Lidhja 1 e 2.*

- b *Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë e Patosit***.**
Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve (të detyrueshëm dhe fakultativ) ofruar nga ASPA nëpërmjet Platformës ZOOM, për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, Auditi i Brendshëm etj. Por nga Bashkia e Patosit nuk rezulton të jenë hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por përzgjedhja e personelit për trajnim është realizuar nga Drejtoria e burimeve njerëzore ose nga vet punonjësit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.
Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: ÅCaktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; ÅVerifikimin e kualifikimeve të kanëdidatëve për vendet e punës; Å Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; ÅFutjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. ÅKryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; ÅZhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Konstatim 1.5/b: Nga strukturat e Bashkisë së Patosit nuk janë hartuar plane/programe vjetore për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, të cilat ndihmojnë në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për tëi kryer me efikasitet ato, në moszbatim të Ligjit nr.10296 /2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe ñManualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò.
2. Menaxhimi i riskut.

2.1. Nga Bashkia e Patosit janë hartuar dhe miratuar Regjistrat e Riskut, ku identifikohen risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe risqe që vijnë nga burime të jashtme:
Regjistri i Riskut për vitin 2019 me nr.66/3 prot.dt.14.01.2019; Regjistri i Riskut për vitin 2020 me nr.45/4 prot. dt.15.01.2020 dhe për vitin 2021 Regjistri i Riskut me nr.93/3 prot. Datë 25.01.2021 konform Ligjit 10296 dt.08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 si dhe Udhëzimit nr.16 dt.20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò. Ky regjistër është i konsoliduari, bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe si *Synim* ñ*Planifikimi dhe*

*Përdorimi me eficencë, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë së Patosit, për arritjen e objektivave*ò. Në këtë Regjistër është paraqitur përshkrimi i risqeve për çdo drejtori, niveli i risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, por nuk është pasqyruar mënyra apo rrugëzgjidhja e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.
- Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion lidhur me takimet e detyrueshme vjetore të GMS, që referuar Ligjit nr.10296/2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe ñManualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollinò citohet se ñ*Grupi për Menaxhimin Strategjik duhett të mblidhet <u>të paktën katër herë në vit</u>. Vendimet e Grupit duhett të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhett të pasqyrohen në dokumente dhe t'i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë"* GMS në Bashkinë e Patosit referuar procesverbaleve/vendimeve të takimeve që iu vunë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se ka realizuar 3 takime në *<u>vitin 2018</u>* ku janë diskutuar projektbuxheti i vitit 2019 me nr.874/9 datë 29.10.2018 dhe 874/11 datë 09.11.2018 si dhe ai afatmesëm 2019-2021 me nr.874/10 datë 05.11.2018; *<u>Për vitin 2019</u>*, Vendimet nr.1 date 04.03.2019, nr.2 date 30.05.2019, nr.3 date 06.09.2019, nr.4 date 12.11.2019 nr.5 date 13.11.2019, nr.6 date 15.11.2019 dhe nr.7 date 22.11.2019; ndërsa *<u>për vitin 2020</u>* dhe 2021, nga ana e Bashkisë së Patosit grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë dokument tjetër, ku të pasqyrohet aktiviteti funksional i GMS së Bashkisë për njohjen, prezantimin dhe direktivat e funksionimit të tij;

<u>Konstatim 2.1/a</u>. Bashkia e Patosit nuk ka miratuar një plan strategjik dhe plan pune vjetor të **GMS** lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen, si dhe grafikun e takimeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi.
<u>Konstatim 2.1/b</u>. GMS në Bashkinë e Patosit referuar procesverbaleve vendimeve të takimeve që iu vunë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se nuk janë realizuar numri i detyrueshëm i takimeve në vitin 2018, 2020 dhe 2021; takimet e realizuara të GMS-së janë kufizuar vetëm për diskutimin dhe hartimin e tavaneve buxhetore për PBA dhe planet buxhetore vjetore të viteve pasardhëse, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr.10296/2010 ñPër Menaxhimin financiar dhe Kontrollinò dhe ñManualit të menaxhimit financiar dhe Kontrollinò.

TAKIMET VJETORE TE GMS				
Viti \ Tremujorët	I	II	III	IV
2018				x
2019	x	x	x	x
2020	x		x	
2021	x	x		

2.2 Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhett të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhett tâu vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.
Duhett theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhett të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit

vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.
Nga auditimi rezulton se në lidhje me i*dentifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut:*
Konstatim 2.2/a Nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, ku citohet se ñTitullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskutò.

2.3. Duke audituar regjistrat e riskut për tre vite të njëpasnjëshëm (2019, 2020 dhe 2021), rezulton se risqet e identifikuara kanë përshkrime kryesisht të përgjithshëm, kanë të njëjtin koeficient vlerësimi (i njëjtë për të tre vitet), por nuk janë parashikuar masa konkrete për tô ndërmarrë nga personat përgjegjës sipas drejtorive, në mënyrë që të bëhet dhe ndjekja e tyre (gjurmimi).

a. Nga auditimi i regjistrave të Riskut lidhur me identifikimin dhe adresimin e tij, rezulton se:

Konstatim 2.3/a. Nuk është vlerësuar me risk vendet vakanëte në strukturë dhe veçanërisht ato në NJAB që prej vitesh rezulton të funksionojë me strukturë të cunguar, në kundërshtim kjo me Ligjin 114/2015 ñMbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò

b. Lidhur me Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT, grupi i auditimit kërkoi informacion mbi sistemit IT me të cilat operon Bashkia e Patosit (të gjitha bashkitë) për të gjitha shërbimet që u ofron qytetarëve. Nga ana e saj na u dha kjo përgjigje: janë sisteme kombëtare on*line dhe që administrohen në zbatim të VKM nr.673/2017 nga AKSHI. Bashkia e Patosit ka në administrimin e saj (server dhe softuerë) vetëm TAIS ï Sistemin ne taksave vendore dhe FAIS- dhuratë e USAID por nuk janë në funksion për mungesën e suportit.

NR	EMERTIMI	DREJTORIA
1	Sistemi ñRevalbò	DSHS
2	Sistemi i Shërbimeve të kujdesit Shoqëror	DSHS
3	Sistemi Online i pikëzimit për ndihmën ekonomike	DSHS
4	Sistemi për personat me aftësi të kufizuar	DSHS
5	Sistemi TAIS	DAV
6	Sistemi FAIS	Drejtoria e Financës
7	AFMIS	Drejtoria e Financës
8	e-leje	DPUZHK
9	e-planifikimi	DPUZHK
10	Regjistri i Planifikimit të Territorit	DPUZHK
11	e-Albania	Zyra me një Ndalesë, DPUKZH, DSHS, DBNJ
12	ASIG Geoportal	DPUKZH
13	Adresari	Zyra me një Ndalesë DPUKZH
14	e-prokurime	NJPP
15	Administrata AL	DBNJ
16	Microsoft Office 2016 word/excel	DF

Konstatimb.1.Bashkia e Patosit nuk ka treguar vëmendje dhe kujdes për mirëmbajtjen e sistemit TAIS e FAIS ï sistem i taksave vendore, i cili si aktiv i qëndrueshëm i saj (Bashkisë) ndonëse dhuratë e USAID për Bashkinë e Patosit, duhett tô nënshtrohej zbatimit të VKM nr.

710/2013 i ndryshuar ñPër Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit Të Shërbimitò.

*Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës***.** Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe proçedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proçeseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhett të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një proçesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të proçesit;shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

Konstatim b.2*:* Bashkia e Patosit nuk ka hartuar manualin e procedurave, në moszbatim të Ligjit nr.10296 /2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe ñManualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e përditësuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108/2016.

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkreswn nr120/10. datë 20.04.2022, nga z. SH.B në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm, protokolluar në KLSH me nr.51/5 datë 26.03.2022, ku janë shprehur komentet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit: Ne nuk jemi dakort me Konstatimin: Bashkia e Patosit nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr.10296 /2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe ñManualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108/2016, për të cilën po ju sqarojmë si më poshtë:- Bashkia Patos e ka hartuar vit për vit listën (hartën)/manualin e proceseve të punës dhe e ka bërë pjesë përbërëse të RRRregullores së Brendshme të Bashkisë për vitin përkatës. Konkretisht në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Patos për vitin 2020, miratuar me vendimin e Kryetares me nr.53 datë 07.01.2020 nga faqja 122 deri në faqen 142 janë parashikuar të gjitha proceset e punës për çdo drejtori të Bashkisë. Gjithashtu edhe në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë për vitin 2021, miratuar me vendimin e Kryetares me nr.31 datë 05.01.2021 nga faqja 122 deri në faqen 142 janë parashikuar të gjitha proceset e punës për çdo drejtori të Bashkisë.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me observacionin tuaj mbi listën(hartën)/manualin e proceseve të punës, po ju sjellim në vëmendjen tuaj se referuar Ligjit nr. 10296 /2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollin ñ si dhe Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollinò , ku citohet se .../...Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre../..; ju në rregulloren e brendshme të Bashkisë keni dhënë përshkrimin e proceseve në emërtimin ñmatricaò të cilat paraqesin tablo të pjesshme të proceseve kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë (grupi i auditimit e ka përmendur) Gjithashtu mungesa e Manualit të proceseve të punës është në kundërshtim me aktet ligjore të sipërcituara ku shprehimisht citohet se ../...Qëllimi i manualit të proceseve të punës është që të përcaktojë në detaje rolin dhe detyrat brenda njësisë publike. Autorizimi, kontrolli, delegimi dhe ndarja e detyrave janë të përcaktuara qartë në këtë manual. Manuali është i bazuar në hartën e proceseve të punës dhe në procedurat e shkruara. Ky dokument nxjerr në pah atë që duhett bërë dhe nga kush duhett realizuar. Gjithashtu, ai përshkruan të gjitha proceset e punës në njësi duke lejuar identifikimin e dobësive, si mungesën e ndarjes së detyrave apo mungesën e

zëvendësuesve të personave përgjegjës. Kjo përqasje ndihmon që njësia publike të jetë e sigurt se nuk ka asnjë aktivitet pa person përgjegjës dhe që të gjithë anëtarët e stafit kanë përgjegjësitë përkatëse, dhe të drejtën për të nënshkruar dokumente. ../...Hartimi i manualit të procedurave nga Bashkia e Patosit, do të bëjë të mundur rritjen efektivitetit në përmbushjen e objektivave të saj. Nga sa më lart për pjesën e hartave të proceseve të punës *observacioni juaj merret në konsideratë*; ndërsa për mungesën e manualit të proceseve të punës *grupi i auditimit lë në fuqi konstatimin* .

c. *Gjurmët e Auditimit* janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin ï veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.
Nga sa më sipër lidhur me gjurmët specifike të auditimit, nga ana e Bashkisë grupit të auditimit iu vu në dispozicion vetëm harta e proceseve të punës/gjurma e auditimit për prokurimet me vlerë të vogël, hartuar nga Njësia e Prokurimit dhe miratuar nga Kryetare e Bashkisë me nr.41 prot. Datë 04.01.2019.

Konstatim 2.3/c: Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë së Patosit, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollitò kapitulli V; Udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122

3. Veprimtaritë e Kontrollit
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.
Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhett të jenë të përshtatshme; efektive nga pikëpamja e kostos; të gjithanshme; të dokumentuara qartë etj.
- Në Bashkinë Patos për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Nr.	Drejtoritë	Manualet që përdoren
1	Drejtoria e Financës	» Manuali I Klasifikimit te llogarive
		» Manuali I pasqyrave financiare
2	Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve	» Manuali teknik I punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.20155ò Përmiratimin e manualeve teknike të punimeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre.
3	Njësia e Prokurimit	» Manual mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël
		» Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit

		Elektronik (SPE)

Lloji i Kontrollit që zbatohet në Bashkinë e Patosit është ai parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit:

a. Kontrolle në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit

b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ)

c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i 2 firmave)

d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.

e. Ka rregullore për Sistemet IT të cilat iu janë vënë në dispozicion çdo përdoruesi

f. Parashikuar procedura te qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor e elektronik

g. komunikimi dhe trajtimi i Urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësive individuale të çdo pozicioni.

i. Problematikë ka në ndarjen e detyrave dhe realizimin e tyre për shkak të vendeve vakanëte në strukturë, ku një person ngarkohet të bëjë edhe detyrë tjetër.

h.Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, ka një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës të përshkruara në ñRregulloren e funksionimit e sekretari ï arkivitò miratuar me Vendim të Kryetares nr.635 datë 05.03.2019. Bashkia është në procesin e konstruksionit të një ambjenti brenda saj që do të ketë funksionin e Arkivës së Përgjithshme të Bashkisë.

g.1.Bashkia e Patosit ka miratuar me Vendim të Kryetare Rregullore ñPër hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimitò me nr. 251/2 prot. Datë 04.03.2019 në zbatim të ligjit nr.60/2016 ñPër sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesveò

2. Rregullore ñPër hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimitò me nr.251/3 prot. Datë 04.03.2019. shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II.

Gjatë periudhës nën auditim për vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë dërguar në ILDKPKI raportet vjetore me nr.101 datë 10.01.2020 *<u>për vitin 2019</u>*, me nr.119 datë 11.01.2021 *<u>për vitin2020</u>* dhe me nr.145 datë 14.01.2022 *<u>për vitin 2021</u>*. Nga auditimi rezulton se në Bashkinë e Patosit nuk ka patur asnjë rast sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit.

<u>Konstatim 3.1</u> Nga institucioni *nuk ka një Plan të Kontrollit të Brendshëm* (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre. Kjo në kundërshtim me nenin 22, pika 1 **të** ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, ñManualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

4.Informacioni dhe Komunikimi

Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe kanë kryer trajnime mbi Ligjin *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin* ñte organizuar nga ASPA. Kjo ka bërë që në mënyrë të vazhdueshme të ruhet komunikimi ndërmjet njësive brenda strukturës së Bashkisë si dhe Bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal. Bashkia e Patosit disponon një Rregullore të Brendshme ku janë përshkruar edhe ndryshimet e bëra në Strukturë dhe Organikë sipas VKB-ve përkatëse. Në Bashkinë e Patosit është emëruar *Koordinatori për Informim* dhe *Koordinatori i Transparencës*konform Ligjit nr.139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò neni 15, 16. Çdo informacion dhe njoftim publikohen në ËEB-in e Bashkisë. Mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimitriskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

a. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë)

b. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë së Patosit

c. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespodencë shkresore zhytarë dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në Institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhett të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit.

d. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA).

e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar dhe më rrallë elektronike.

5. Monitorimi

Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë edhe të Koordinatorit të Riskut, merr raporte katër mujore nga drejtuesit e programeve buxhetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve, si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti vjetor i monitorimit i cili i dërgohet Ministrisë së Financave. Ky Raportim bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.68 /2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò, nenit 65 të ligjit nr. 9936/2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisëò e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22/2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE: për vitin 2019 me shkresën përcjellëse nr.389/1 datë 10.02.2020; për vitin 2020 me shkresën përcjellëse nr.361 dt.29.02.2020. Këto Raporte Monitorimi përmbajnë: Pyetësorin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funksionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK. Gjithashtu nga ana e Bashkisë Patos , ñDrejtoria e zhvillimit bujqësor, blegtoral, pyjor, mjedisit dhe kontrollit të ushqimitò ku përfshihet edhe sektori që mbulon mbrojtjen e mjedisit, raporton çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Ministria e Turizmit dhe Mjedisin): *<u>për vitin 2019</u>* me shkresën nr.192/1 datë 29.01.2020; *<u>për vitin 2020</u>* me shkresën nr. 164/1 datë 29.01.2021; në zbatim të

Ligjit nr. 10431/2011 ñPër Mbrojtjen e Mjedisitò i ndryshuar , ligjit nr.10463/2011 ñPër Menaxhimin e integruar të mbetjeveò i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 ñPër miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeveò.

Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, konstatuam se baza rregullatorë mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhetn ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nën ligjor që del). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS që është rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, që të mund të kontrollojë, të konstatojë dhe të sistemojë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

Titulli i Gjetjes: Mbi implementimin dhe zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit të Brendshëm

<u>Situata:</u>
Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera në Bashkinë Patos u konstatuan disa mangësi si vijon:
1. Rregullorja e Bashkisë së Patosit (në mungesë të manualit të procedurave), duhett të përmbajë dhe <Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës> për çdo pozicion të strukturës organizative, ku janë përcaktuar dhe kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të nevojshme/të domosdoshme.
2. Në strukturën e Bashkisë së Patosit nuk janë planifikuar pozicione me status ñ*ekselent*ò në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017; si dhe pozicione me status të ñ*Grup i veçantë*ò ku përfshihen **17 (shtatëmbëdhjetë)** kategori të ndryshme si persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (Romë, Egjiptianë etj.) si personel administrativ.
3. Dosjet e personelit të administratës së Bashkisë nuk kanë të unifikuar Formulari Tip ñFletë Inventariò, nuk ka të listuar emërtesat e dokumentacionit domosdoshmërish përbërës të dosjes ku të jenë të specifikuar dhe dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim. Në këto dosje u konstatuan këto mangësi: disa raste të dokumenteve të arsimimit dhe kualifikimeve fotokopje të pa noterizuara; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; formular i Vetdeklarimit, deklarata e kodit të etikës etj. Ndërsa te dosjet e personelit të ndërmarrjeve të varësisë bashkë me mangësitë e mësipërme, rezultojnë edhe mangësi të dokumentacionit bazë: kontrata e punës, raporti mjekësor, dokument identifikues dhe certifikatë e gjendjes familjare, dëshmi penaliteti apo vërtetime të Prokurorisë dhe Gjykatës etj. Mos lidhja e kontratës nga ana e titullarit është në kundërshtim me dispozitat e ligjit me nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, neni 21 pika 1, 2, 3 ,4 të cilat përcaktojnë *formën e shkruar të kontratës, elementët që duhett të përmbajë kontrata, dhe faktin që kur kontrata nuk është nënshkruar për arsye të justifikueshme sipas pikës 1 dhe 3, punëdhënësi duhett ta lidhë atë brenda 7(shtatë) ditëve nga dita e punësimit.*
4.Nga strukturat e Bashkisë së Patosit nuk janë hartuar plane / programe vjetore për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, të cilat ndihmojnë në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për tôi kryer me efikasitet ato.
5.Bashkia e Patosit nuk ka miratuar një plan strategjik dhe plan pune vjetor të **GMS** lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen, si dhe grafikun e takimeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi.
GMS në Bashkinë e Patosit referuar procesverbaleve/vendimeve të takimeve që iu vunë në

dispozicion grupit të auditimit, rezulton se nuk janë realizuar numri i detyrueshëm i takimeve në vitin 2018, 2020 dhe 2021 si detyrim ligjor i aktivitetit funksional të tij; si dhe takimet e GMS janë kufizuar vetëm në diskutimet dhe hartimin e tavaneve buxhetore të PBA dhe planeve vjetore të vitit pasardhës.

6. Në lidhje me i*dentifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut,* nga Bashkia e Patosit rezulton se nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut si dhe nuk janë vlerësuar me risk vendet vakanëte në strukturë dhe veçanërisht ato në NJAB që prej vitesh rezulton të funksionojë me strukturë të cunguar.

7. Bashkia e Patosit nuk ka treguar vëmendje dhe kujdes për mirëmbajtjen e sistemit TAIS e FAIS ï sistem i taksave vendore, i cili si aktiv i qëndrueshëm i saj (Bashkisë) ndonëse dhuratë e USAID për Bashkinë e Patosit, duhett tõ nënshtrohej zbatimit të VKM nr. 710/2013 i ndryshuar ñPër Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit Të Shërbimitò.

8. Bashkia e Patosit nuk ka hartuar dhe miratuar Manualin e Procedurave, duke u mjaftuar vetëm me <matricat> si shtojca në Rregulloren e Brendshme.

9. Gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e punës.

10. Nga Bashkia Patosnuk është hartuar dhe miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit të MFK-së).

Kriteri:

Ligji nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen vendoreò; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò; Udhëzimin nr.16, dt.20.07,2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò; Ligji nr.152 datë 30.05.2013 ñPër Nëpunësin civil në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar; Ligji nr.7961 dt.12.07.1995 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuarneni 9 / 3,4 5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20;Ligjin nr.93/2014 ñPër Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuaraò neni 1/a; neni 2 pika a/b; neni 4 pika a/ b/ ë; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019ñ Për Nxitjen e Punësimitò neni 3 pika 4 ñGrupe të veçantaò (17 kategori sociale); neni 20 pika 1/a e 1/b; pika 2; pika; Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017 ñPër punësimin e studentëve të ekselencësò; Ligji nr.10325/2010 ñpër bazën e te dhënave shtetëroreò;VKM nr.117 dt. 05.03.2014 ñPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò Lidhja 1 e 2; VKM nr.243/2014 ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò i ndryshuar; VKM nr.142 /2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò; me VKM nr.746/2018 VKM nr.639 dt.07.09.2016 ndryshuar me VKM nr.596 dt.04.09.2019 ñPër përcaktimin e rregullave të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punëò; ligji nr.9887 dt.10.03.2003 ose ligji nr.138 dt.17.12.2015; ligjin nr.9049/2003 I ndryshuar, Ligji nr.9367/2005 dhe Udhëzimi nr.1 dt.7.06.2014 të Inspektorit të Përgjithshëm të ñInspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesaveò

Ndikimi

Nga Bashkia e Patosit nuk janë zbatuar rigorozisht elementët nga të cilët përmbahen 5 (pesë) Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. duke rrriskuar sigurinë e arritjes së objektivave të Bashkisë nëpërmjet përdorimit me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.

Shkaku

Gjatë kësaj periudhe (2019,2020 dhe 2021), Bashkia e Patosit nuk ka treguar vëmendjen dhe

përgjegjshmërinë e duhur për plotësimin e aktiviteteve të kontrollit me dokumentacionin përkatës (manuali i procedurave, gjurmët e auditimit, strategji risku, plan vjetor kontrolli të brendshëm) dhe miratimin e tyre nga NA ï Kryetar i Bashkisë, të cilat orientojnë zbatueshmërisë e procedurave të saj konform bazës ligjore në fuqi.

Rëndësia:*E mesme*

Rekomandim:

- Kryetari i Bashkisë Patos, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, të hartojë dhe të miratoj gjurmët e auditimitme qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marri masa për përditësimin e rRRregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicion pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.3 Organizimi dhe funksionimi i njësisë së Auditit të Brendshëm;

Njësia e auditimit të brendshëm NJAB është e organizuar në nivel sektori bazuar në Vendimet e Kryetares ñPër Miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë së Patositò me nr.40 prot. Datë 04.01.2019 *për vitin 2019*; nr.3481 prot. Datë 24.12.2019 *për vitin 2020* dhe nr.1 prot. Datë 06.01.2021 *për vitin 2021*, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, me emërtesën ñNjësia e Auditimit të Brendshëmò dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë e Patosit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, neni 10, germa ñcò si dhe nenit 64, gërma ñaò të Ligjit nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò.

b. *Plani strategjik* 2019-2021 dhe ai vjetor 2019 i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm [NJAB] është dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr.2060/1 prot. datë 18.10.2018; *Plani strategjik* 2020- 2022 dhe ai vjetor 2020 i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm [NJAB] është dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr.2589/3 prot dt.18.10.2019; *Plani strategjik* 2021-2023 dhe ai vjetor 2021 i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm [NJAB] është dërguar në Ministrinë e Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik/Drejtoria e Harmonzimit të Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.2389/2 prot dt.16.10.2019. Planet Strategjikë dhe Vjetorë të NJAB të Bashkisë Patos janë përcjellë në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, në ñManualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò ku ndër të tjera citohet *"..Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, i përgatitur nga Njësitë e AB, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data **20 Tetor** e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave".*

c. *Plani strategjik i Auditimit* mbështetet në programet dhe objektivat e Bashkisë dhe Ndërmarrjeve të Varësisë ku ushtron veprimtarinë audituese, si dhe në *identifikimin dhe vlerësimin e risqeve* që ndikojnë në (mos)realizimin e objektivave të këtyre njësive. NJAB

mbi bazën e njohjes dhe të studimit të objektivave strategjikë dhe të risqeve të Bashkisë dhe Ndërmarrjeve të Varësisë, evidenton jo vetëm subjektet dhe fushat e auditimit që do të realizohen në Programin Strategjik Afatmesëm, por edhe frekuencën e realizimit të këtyre auditimeve. Planifikimi i auditimit është bërë duke patur parasysh anën funksionale e organizative të subjekteve që janë objekt auditimi, raportet vjetore të institucionit, raportet e mëparshme të auditimit të brendshëm, rekomandimet e auditit të jashtëm (KLSH), regjistrat e riskut dhe këshillat/opinionet e drejtuesve të njësive respektive në strukturë. Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm [NjAB] janë hartuar Raportet Vjetore të aktivitetit të saj: *për vitin 2019* miratuar nga Kryetar i Bashkisë me nr.106/2 prot. Datë 17.02.2020; *për vitin 2020* miratuar nga Kryetar i Bashkisë me nr.165/2 prot. Datë 12.02.2021; *për vitin 2021* miratuar nga Kryetar i Bashkisë me nr.109/2 prot. Datë 07.02.2022; si dhe janë dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm *brenda afatit*të përcaktuarnë Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100/2016.

d. *Struktura e NJAB:* Situata e strukturës së NjAB në Bashkinë e Patosit nga data 01.01.2019 deri më 31.12.2021 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NjAB	Përgjegjës	Specialist Auditues	Kualifikimi profesional	Emëruar	Numri i punonjësve Plan / Fakt	
Viti 2019	**1**	**1**	**Financierë**	**Me / Pa çertifikatë**	**3**	**2**
Viti 2020	**1**	**1**	**Financierë**	**Me / Pa çertifikatë**	**3**	**2**
Viti 2021	**1**	**1**	**Financierë**	**Me / Pa çertifikatë**	**3**	**2**

Sipas ligjit nr.114/2015 ñPër Auditin e Brendshëmò në çdo institucion, bazuar në disa kritere të përcaktuara në VKM nr.83 dt.03.02.2016 ñMbi Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò me Vendim të Kryetares së Bashkisë nr. 40 prot. datë 04.01.2019 ñPër miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Patos për vitin 2019ò; Vendimit nr.3481 prot. datë 24.12.2019 ñPër miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Patos për vitin 2020ò; Vendimit nr.1 prot. datë 06.01.2021 ñPër miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Patos për vitin 2021ò, është përcaktuar që NJAB të ketë në përbërjen e saj **3**(tre) punonjës, por që për periudhën nën auditim rezulton se kjo njësi ka funksionuar me **2** (dy) punonjës (**1** përgjegjës i njësisë dhe **1** specialist auditi). Gjithashtu në strukturën e NJAB nuk janë përcaktuar kriteret specifike që duhet të plotësojnë audituesit e brendshëm. Referuar nenit 11 pika 2/a, b, c, ç të Ligjit nr.114/2015 ñPër Auditin e Brendshëm në sektorin Publikò, ñManualit të Auditimit të Brendshëmò miratuar nga Ministër i Financave nr.100/ 2016 dhe VKM nr.83/2016, përcaktohen qartë kriteret e arsimimit dhe numri i personelit në strukturën e [AB] sipas të cilëve mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për tu certifikuar. [NJAB] gjatë periudhës që po auditojmë, ka funksionuar me këtë personel:

Nr	Nga data e krijimit deri me 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi
	Për vitin 2019					
1	H. M.	Përgjegjës i Sektorit	I lartë	41	20	**Çertifikuar**
2	J.Z.	Specialiste	Pasuniversitar	2	1.5	E paçertifikuar
	Për vitin 2020					
1	H. M.	Përgjegjës i Sektorit	I lartë	41	20	**Çertifikuar**
2	J.Z.	Specialiste	Pasuniversitar	2	1.5	E paçertifikuar
	Për vitin 2021					
1	H. M.	Përgjegjës i Sektorit	I lartë	41	20	**Çertifikuar**
2	J.Z.	Specialiste	Pasuniversitar	2	1.5	E paçertifikuar

Nr	Nga data e krijimit deri me 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi
3...	E. H.	Specialiste	Pasuniversitar	4	0.5	E paçertifikuar

Konstatim d.1: Gjatë periudhës që auditojmë [NJAB] e Bashkisë së Patosit nuk ka funksionuar dhe vazhdon të mos funksionojë me kapacitet të plotë të audituesve sipas strukturës së miratuar, në kundërshtim kjo me Ligjin nr.114/2015 ñMbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, ñManualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò, VKM nr.83 dt.03.02.2016 ñPër Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò i ndryshuar, si dhe Vendimeve të Kryetares së Bashkisë së Patosit ñPër miratimin e Strukturave Organizativeò për vitet 2019, 2020 dhe 2021.

Konstatim d,2.Në strukturën e NJABnuk janë përcaktuar kriteret specifikë profesionalë /arsimimi të çdo pozicioni, me qëllim krijimin e një strukture efektive, në kundërshtim kjo me nenin 11 pika 2/a të Ligjit nr. 114/2015 ñMbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò.

e. Trajnimet e [NjAB] dhe certifikimet

Referuar ligjit nr.10296/2010, Manualit të MFK miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave Nr.8980, dt. 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE nr.108/2016 të MFK, Ligjit nr.114/2015 ñMbi Auditimin e Brendshëmò dhe ñManualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò, rëndësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të [NJAB] sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë e Patosit pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër mbiemër	2019	2020	2021	Pozicioni	ASPA
1	H. M.	40	40	40	Përgjegjës	0
2.1	J.Z.	0	0	0	Ish/ Specialist auditi	30
2.2	E. H.	-	-	18	Specialist auditi	1.5
3	Vakanët	-	-	-	-	-

Burimi: *NJAB Bashkia Patos përpunuar prej grupit të auditimit.*

Trajnimi i audituesve të [NJAB] *duhett të përmbushë planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo auditues*, përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Referuar Ligjit nr. 114/2015 ñMbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò si dhe pikës 3 të VKM nr.83 dt.03.02.2016 ñPër Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò i ndryshuar, brenda dy viteve audituesi që nuk ka certifikatë auditi, duhett të pajiset me certifikatë.Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si ñAuditues i brendshëmò, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji. Për mirëfunksionimin e auditit të brendshëm, gjatë procesit audituesduhett të mbështeten në zbatimin me korrektësi të 7 (shtatë) parimeve të përgjithshme, të cilat janë: **a)** ligjshmëria; **b)** paanësia; **c)** integriteti; **ç)** pavarësia dhe objektiviteti; **d)** profesionalizmi & zhvillimi i vazhdueshëm profesional; **dh)** kompetenca dhe **e)**konfidencialiteti

Nga sa më lart përshkruam, përsa i përket specialistes së auditit znj. *J.Z.* (nga 08.05.2019 deri në 24.07.2021) ndonëse për një periudhë 2-vjecare në pozicionin e specialistes së auditit, rezulton të mos ketë zhvilluar asnjë orë trajnimi të programit të detyruar të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.114/2015 ñMbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, ñManualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publikò. Kjo ka bërë që specialistja e auditit të ketë zhvilluar aktivitetin auditues duke mosplotësuar**2** (dy) nga **7** (shtatë) parimet e përgjithshme dhe konkretisht: Å[*profesionalizmi* dhe *zhvillimi i vazhdueshëm profesional]*;Å [*kompetenca]. N*ga ana tjetër kjo specialiste gjatë kësaj periudhe, nuk i është nështruar procedurës së certifikimit të audituesit, ndonëse periudha që ka ushtruar pozicionin e

specialistes së auditit ka qenë e mjaftueshme, referuar përcaktimeve ligjore (Ligjit nr.114/2015) dhe atyre *nënligjore (VKM-së* nr.83 dt.03.02.2016 ñPër Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò i ndryshuar, pika 3). Specialiste e auditit*znjE.H*(nga 24.09.2021 e në vazhdim) gjatë periudhës që është bërë pjesë e strukturës së [NJAB], ka zhvilluar **18** orë trajnimi (për afro 100 ditë) nga **40** orë të detyruara vjetore të programit të detyrueshëm të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE. Po ashtu nga ana e [NJAB] na u komunikua që janë në pritje të fillimit të procedurës për certifikimin e specialistëve të auditit të papajisur me certifikatë.

Konstatim e.1 Nga auditimi*mbi realizimin e trajnimeve vjetore të detyrueshme të audituesve të NJAB rezultoi se* nga [NJAB] të Bashkisë Patos, nuk janë respektuar trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, ñManualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publikò

Konstatim.e.2 Në Strukturën e [AB] për periudhën nën auditim, rezulton të jenë emëruar si audites, punonjës të pa pajisur me ñCertifikatë të Audituesit të Brendshëmò, por edhe të pa angazhuar në fillimin e procedurës për certifikim, që organizon Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Kjo në kundërshtim me nenin 11 pika 2/ç të ligjit nr.114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, VKM nr.83/2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të NJAB-ve në sektorin publikò pika 3 si dhe ñManualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò.

Mos fillimi i procedurës se certifikimit ka rriskuar edhe në mosplotësimin e njësisë së auditit të brendshëm me audites, konform përcaktimeve ligjore të sipërcituara

II. Planifikimi dhe realizimi i auditimeve.

Referuar Planeve Strategjikë 2019-2021, 2020-2022 dhe 2021-2023 dhe atyre Vjetorë 2019, 2020 dhe 2021 planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese për realizim nga [NJAB] me vlerësimin e riskut, është sipas tabelës vijuese;

Nr.	Subjekte të Audituara/Fusha	Vlerësimi i Përgjithshëm i Riskut		
		2019	2020	2021
1	Bashkia Patos			
.	Njësia AdministrativeZharrez	-	I lartë	-
.	Njësia Administrative Ruzhdie	-	I ulët	-
.	Drejtoria e të Ardhurave Lokale	I lartë	I lartë	I lartë
.	Drejtoria e Financës	I lartë	I lartë	I lartë
.	Njësia e Prokurimit Publik	I lartë	I lartë	I lartë
.	Drejtoria e Mirëmbajtjes Urbane	-	I ulët	-
.	Drejtoria e Planifikimit të Territorit	I ulët	-	-
.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	-	I mesëm	-
.	Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik	I mesëm	-	-
.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit	I ulët	-	-
.	Qendra Kulturore e Fëmijëve	I mesëm	-	-
.	Sektori i Shërbimit Social	-	-	I mesëm
.	MZSH	I mesëm	-	I ulët
.	Kopesht dhe çerdhe me Ushqim	-	I mesëm	-
2	Ujësjellës dhe Kanalizime sha Patos	I lartë	I lartë	I lartë
3	Ndërmarrja e Pastrimit	I lartë	I lartë	I lartë
.	Ndërmarrja e Gjelberimt	I lartë	I lartë	
4	Ndërmarrja e Rregullimit te Territorit	I lartë	I lartë	I lartë

5	Klubi sportiv Albpetrol	I lartë	I lartë	I lartë
	Totali i Auditimeve vjetore	**13**	**13**	**9**

Burimi: *NJAB Bashkia Patos përpunuar prej grupit të auditimit.*

Planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese është bërë mbi bazë risku dhe paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	**2019**			**2020**			**2021**		
Numri i auditimeve plan	13			13			9		
Numri i auditimeve fakt	12			12			9		
Niveli i riskut	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët
Numri për çdo nivel	8	3	2	9	2	2	7	1	1
Shprehur në %	**62**	**38**		**69**	**31**		**78**	**22**	

Referuar të dhënave në tabelë rezulton se *nuk janë realizuar* numri i auditimeve të planifikuara në Planet Strategjikë dhe ata Vjetorë për 2 vite radhazi dhe konkretisht për 2019 dhe 2020.; por gjithashtu rezulton se planifikimi i misioneve audituese strategjikë dhe vjetorë është realizuar duke respektuar raportin [60% me 40%] mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, në zbatim të ligjit nr.114/2015 ñPër Auditin e Brendshëm në Sektorin Publikò dhe ñManualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò kapitulli III paragrafi.3 pika 1.6 e 1.7; 3.2; 3.4; 3.5 miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100/2016.

2. Auditimet e planifikuara dhe realizuar nga NJAB e Bashkisë Patos, të klasifikuara sipas llojit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2019	13	12	5	-	7	-	-
2	Viti 2020	13	12	4	1	7	-	-
3	Viti 2021	9	9	3	-	6	-	-

- Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga NJAB mbi aktivitetin e saj për çdo vit ushtrimor, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2019	29	29	-	-	1,296,900	√	-	-
2	Viti 2020	33	33	-	-	31,327,000	√	-	-
3	Viti 2021	18	18	-	-	32,028,000	√	-	-
TOTALI		**80**	**80**	-	-	**64,651,900**	√	-	-

- Përsa i përket Realizimit të auditimeve nga NJAB të Bashkisë Patos për periudhën 2019-2021, paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr.	**Subjekte të Audituara/Fusha**	**Realizimi i Auditimeve të Planifikuara**

		2019	2020	2021
1	Bashkia Patos			
.	Njësia AdministrativeZharrez	-	ã	-
.	Njësia Administrative Ruzhdie	-	ã	-
.	Drejtoria e të Ardhurave Lokale	ã	ã	ã
.	Drejtoria e Financës	ã	ã	ã
.	Njësia e Prokurimit Publik	ã	ã	ã
.	Drejtoria e Mirëmbajtjes Urbane	-	ã	-
.	Drejtoria e Planifikimit të Territorit	ã	-	-
.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	-	0	-
.	Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik	ã	-	-
.	Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit	ã	-	-
.	Qendra Kulturore e Fëmijëve	0	-	-
.	Sektori i Shërbimit Social	-	-	ã
.	MZSH	ã	-	ã
.	Kopësht dhe çerdhe me ushqim	-	ã	-
2	Ujësjellës dhe Kanalizime - sha Patos	ã	ã	ã
3	Ndërmarrja e Pastrimit	ã	ã	ã
.	Ndërmarrja e Gjelbërimt	ã	ã	
4	Ndërmarrja e Rregullimit të Territorit	ã	ã	ã
5	Klubi Sportiv Albpetrol	ã	ã	ã
	Totali i Auditimeve vjetore	**13**	**13**	**9**

Burimi: *NJAB Bashkia Patos përpunuar prej grupit të auditimit.*

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, vihet re se nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara për vitet 2019 e 2020 (janë realizuar nga 1 auditim më pak për vit - Qendra Kulturore e Fëmijëve për vitin 2019 dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për vitin 2020); referuar nivelit të riskut, këto dy subjekte duhett të auditoheshin brenda periudhës 2019-2021, pasi periudha në të cilën ishin planifikuar ka përfunduar; Gjithashtu për periudhën 2019-2021 ka ngelur jashtë aktivitetit auditues Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Sporteve, pasi nuk është pjesë e auditimit as në planet strategjikë e as ata vjetorë.

Konstatim f.1.1: Nga auditimi i tabelave të mësipërme rezulton se: numri i auditimeve të planifikuara për periudhën nën auditim vjen në rënie (nga 13 për 2019 në 9 auditime për 2021) si dhe nuk i janë nënshtruar procesit auditues të gjitha njësitë kryesore në strukturë/drejtoritë këto në moszbatim të ligjit nr.114/2015 ñPër Auditin e Brendshëm në Sektorin Publikò dhe ñManualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò miratuar me Urdhrin e Ministrit të FE nr.100/2016

K. f 1.2: Nga auditimi i raporteve e vjetoretë hartuara nga NJAB dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, u konstatua se nuk është realizuar numri i auditimevekonform planit vjetor të auditimeve/planeve strategjikë dhe se nuk janë pasqyruar këto ndryshime në planet vjetore për vitet 2019 e 2020, Për ndryshimet dhe shmangiet nga plani vjetor audituesitduhett të japin edhe arsyet të cilat kanë çuar në mosrealizim të misioneve audituese të planifikuara, në kundërshtim kjo me ñManualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò miratuar me Urdhrin e Ministrit të FE nr.100/2016

Shpërndarja e rekomandimeve të lëna në çdo auditim për vitet 2019, 2020 dhe 2020 të pasqyruara në aneksin nr. 1 pika 1 bashkëlidhur Projektraportit të auditimit. Subjektet e audituara i klasifikojmë në: *Grupi 1* subjekte ku numri i rekomandimeve vjen në rritje janë 2 (dy) - Drejtoria e të Ardhurave Lokale dhe Klubi Sportiv ñAlbpetrolò;

Grupi 2 subjekte ku numri i rekomandimeve vjen duke u zvogëluar janë 4 (katër) - Drejtoria e Financës,MZSH, Ujësjellës dhe Kanalizime ï sha dhe Ndërmarrja e Pastrimit dhe Gjelbërimit;

Grupi 3 subjekte ku numri i rekomandimeve të çdo viti luhatet rreth të njëjtave vlera dhe janë të të njëjtës natyrë, është Ndërmarrja e Rregullimit të Territorit.

Konstatim f.2.1 mbi rekomandimet e lëna nga ana e NJAB për subjektet e audituara:
» [Grupi 1] - rekomandimet për *Drejtorinë e të Ardhurave Vendore* janë të të njëjtës natyrë ñvjelja e taksave e tarifave biznesit dhe komunitetit, për vitet që i nënshtrohen procedurës së auditimitò në moszbatim të Ligjit nr. 9632/2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar dhe Ligjit nr.9920/2008 ñProcedurat tatimore në RSHò i ndryshuar; si dhe ñzbatim i pjesshëm rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshmeò në moszbatim të Ligjit nr.114/2015 ñPër auditin e brendshëm në Sektorin Publikò; rekomandimi ñdietat e sportistëve dhe të ekipit mbështetësò i është lënë 2 vite radhazi *Klubit Sportiv Albpetrol* në moszbatim të VKM nr. 97/2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò i ndryshuar dhe Ligjit nr.105/2020 ñPër sportinò; ndërsa rekomandimi ñarkëtim për një likujdim OE që e ka kaluar vlerën e shpenzimit faktikò i është lënë vitin e dytë, në moszbatim të Ligjit nr.68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò.
» [Grupi 3] ï rekomandimet e lëna kanë të njëjtën natyrë pasi janë në moszbatim të të njëjtës bazë ligjore VKM nr.248/1998 ñPër miratimin e planit kontabël të pushtetit lokalò i ndryshuar, Udhëzimit të KM nr.30/2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò dhe Udhëzimit të MF nr.8/2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiareò.
Konstatim.f.2.2nga ana e subjekteve të audituaranuk janë hartuar Planet e veprimit të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 20 ditë pune pas dërgimit nga ana e saj të Raportit final, duke mos përmbushur detyrimin nr.5 e skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12 hapi 11ò i ñManualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò.
Konstatim. f 2.3 Mungesa e planeve te veprimit ka sjellë mungesën e monitorimit të NJAB për zbatimin erekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në zbatim të përcaktimeve të kreut 4.1.13.1 dhe 2 ñProcedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimitò paragrafi 3 dhe ñRaportimi i ndjekjes së rekomandimeveò paragrafi 4. Kjo si pasojë e mos raportimit të subjekteve të audituara në moszbatim të kreut 4.1.13.3 ñPërgjegjësitë e njesisë së audituar për të zbatuar rekomandimet e ABò.

- Në njësinë e auditimit të brendshëm, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm të kryera gjatë periudhës objekt auditimi është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit. Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 ñPër Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò me emërtesën ñNjësia e Auditimit të Brendshëmò.
Për periudhën 2019-2021 nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë së Patosit janë lënë 79 rekomandime, të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht; ndonëse auditimet realizohen çdo vit edhe te të njëjtat subjekte, për disa subjekte numri i rekomandimeve vinë në rritje dhe për disa të tjera qëndron në të njëjtat nivele.
Nga sa më lart, grupi i auditimit thekson se mungesa e personelit, mungesa e trajnimeve të stafit të NJAB të Bashkisë si dhe lëvizja e vazhdueshme e punonjësve nga pozicioni i punës përbën një pengesë për mirëfunksionimin dhe në performancën e NJAB së Bashkisë së Patosit. Kjo rezulton në mospërmbushje dhe mosrealizimin e plotë të planeve vjetorë/strategjikë si edhe të Skemës së Procest të Auditimit Ÿ Hapi 4 [Ndjekja e Rekomandimeve], veprime këto në kundërshtim me ligjin 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò dhe ñManualineAuditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò.

Titulli i gjetjes: Mbi Vlerësimin e Aktivitetit të Njësisë së Auditit të Brendshëm

Situata:
Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Patos, për periudhën e audituar 2019 ï 2021 nuk ka funksionuar në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, ku janë konstatuar mangësi në përcaktuar kriteret specifikë profesionalë të arsimimit të çdo pozicioni, nuk janë respektuar trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/ Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është realizuar numri i auditimevekonform planit vjetor të auditimeve dhe planeve strategjikë të miratuar dhe se nuk janë pasqyruar këto mosrealizime të tyre në planet vjetore për vitet 2019 e 2020 si edhe në raportet vjetore si dhe nuk është hartuar procesi i ndjekjes së rekomandimeve për subjektet e audituaranë kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò,
Kriteri:
Ligjin nr.114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëmò dhe ñManualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò; Ligji Nr.10296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò; VKM nr.83/2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të NJAB-ve në sektorin publikò; ligji nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò; ñManuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.8980, dt. 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e ministrit të FE nr.100/2016
Ndikimi
Mungesa e personelit në strukturën e NJAB, mungesa e trajnimeve të stafit të NJAB të Bashkisë/ mos çertifikimi si dhe lëvizja e vazhdueshme e punonjësve nga pozicioni i punës, përbën një pengesë për mirëfunksionimin dhe në performancën e NJAB së Bashkisë së Patosit si dhe në dhënien e sigurisë menaxherit për përmbushjen e objektivave të Bashkisë.
Shkaku
Mos zbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon aktivitetin e Njësisë se Auditimit të Brendshëm në Bashkinë e Patosit
Rëndësia E Lartë
Rekomandimi
- Kryetari i Bashkisë Patos, të marrë masa për plotësimin e organikës së Auditimit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin dhe VKM.
-NJAB në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Patos.
-Njësia e Auditit të Brendshëm, në përfundim të procesit të auditimit në subjekt, të raportojë gjetjet nga auditimi në raportin përmbledhës, të shoqëruar me shkresë përcjellëse dhe tôi kërkohet menaxherit të njësisë së audituar të reagojë në lidhjet me rekomandimet, si dhe të kryhet monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhett të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara menaxhimit sipas Manualit të AB.

2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", ligjet vjetore "*Për buxhetin e shtetit*" të vitit 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur me Urdhrin fillestar të titullarit të institucionit, me nr. 327/1 prot, datë 29.03.2012. Në bazë të këtij Urdhri, çdo vit del urdhër për ndryshimet përkatëse, sipas rastit. Konkretisht, për vitin 2019 ka dalë Urdhri nr. 14/1 prot., datë 01.03.2019, për vitin 2020 ka dalë Urdhri nr. 71 prot., datë 30.12.2019 dhe për vitin 2021 ka dalë Urdhri nr. 6, datë 08.01.2021. Mbledhjet e këtij grupi janë realizuar për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve janë realizuar rregullisht.

Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjeve, garantimin e cilësisë në tregjet publike dhe rritjen e sigurisë në rrugë, përmirësimin e kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimin e shërbimeve sociale, mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e transportit publik dhe turizmit. Është bërë analiza e pagave dhe është llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve.

Si fusha me prioritet për investime në Bashkinë Patos janë konsideruar:

1. Zhvillimi Urban:
- Përmirësimi i aksesit rrugor;
- Zhvillimi i zonave periferike të qytetit;
- Krijimi i hapësirave publike dhe të gjelbëruara në qendër dhe periferi.
2. Zhvillimi Social-Ekonomik:
- Mbështetja e biznesit me politika fiskale për hapjen e vendeve të reja të punës;
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore;
- Mbështetja për krijimin e tregjeve rajonale për shitje.
3. Mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit:
- Menaxhimi i mbetjeve urbane;
- Menaxhimi i gjelbërimit të qytetit;
- Eliminimi i ndotjes nga ujërat e zeza;
- Mbështetje për rehabilitimin e shesheve nga facilitetet e abandonuara të industrisë së naftës ndër vite.
4. Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve:
- Mbështetje për rehabilitimin dhe krijimin e infrastrukturës së ujit;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanëaleve të ujrave të zeza;
- Mirëmbajtja urbane;
- Ndërtimi i një tregu bujqësor;
- Ndërhyrja në sistemin e kullimit, vaditjes, sistemimi i rrugëve të parcelave;
- Shtimi i sipërfaqeve të pyjeve nëpërmjet mbjelljes së sipërfaqeve të zhveshura;
- Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse.
5. Zhvillimi i filialeve bujqësore e blegtorale:
- Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes;
- Organizimi i grupeve të prodhimit bujqësor e blektoral, industrial dhe ofrimi i shërbimeve;
- Mbështetje e biznesit dhe fermerëve për promovimin e produkteve bujqësore e blegtorale të zonës;
- Mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit turistik dhe sektorit bujqësor e blegtoral;
- Paketa fiskale për thithjen e investitorëve të rëndësishëm dhe punëdhënësve të mëdhenj, për zhvillimin e filialeve apo tregjeve bujqësore.
6. Zhvillimi i territorit:
- Zhvillimi ekonomik;
- Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve;

- Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe ambientale.

Këto programe afatmesme janë hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore*ò. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion*(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit)*, tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme)*.
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të ñ*Buxhetit me pjesëmarrje*ò, të cilat janë paraqitur në **Pasqyrën B1**, në anekset bashkëlidhur.
Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga EMP, njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e Bashkisë, ujësjellësi, etj., mbi bazën e të cilave dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur kërkesat më prioritare. Kërkesat Buxhetore në të gjitha rastet janë të argumentuara me analizat dhe preventivat përkatës. Dorëzimi i kërkesave buxhetore në strukturën e Nëpunësit Zbatues është kryer duke filluar nga muaji maj deri në shtator, ku është bërë edhe miratimi i tavaneve buxhetore përfundimtare.
PBA-të dhe buxheti i vitit 2020 janë miratuar në Këshillin Bashkiak, si më poshtë:
- PBA 2019-2021, është miratuar me VKB nr. 59, datë 20.09.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1543/2, datë 10.10.2018;
- PBA 2020-2022, i rishikuar, është miratuar me VKB nr. 67, datë 27.09.2019;
- PBA 2020-2022, faza e parë përgatitore, është miratuar me VKB nr. 21, datë 20.03.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 553/2, datë 03.04.2019;
- PBA 2020-2022, projekti i parë, është miratuar me VKB nr. 46, datë 13.06.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1032/1, datë 20.06.2019;
- Buxheti 2019 është miratuar me VKB nr. 81, datë 20.12.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 2118/3, datë 28.12.2018;
- Buxheti 2020 është miratuar me VKB nr. 87, datë 13.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1929/1, datë 23.12.2019;
- Buxheti 2021 është miratuar me VKB nr. 51, datë 18.12.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1304/1, datë 30.12.2020.

Sipas të dhënave të **Pasqyrës B2** në anekset bashkëlidhur, konstatohet se:
- <u>Për vitin 2019</u>, me të ardhurat e veta Bashkia mbulon 47% të shpenzimeve. Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore në PBA janë planifikuar për vlerën 190,078 mijë lekë, në fakt janë realizuar për vlerën 216,894 mijë lekë ose 26,816 mijë lekë më shumë, diferencë e cila është trashëguar për tâ përdorur në vitin pasardhës.
- <u>Për vitin 2020</u>, me të ardhurat e veta Bashkia mbulon 49% të shpenzimeve. Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore në PBA janë planifikuar për vlerën 218,869 mijë lekë, në fakt janë realizuar për vlerën 234,207 mijë lekë ose 15,338 mijë lekë më shumë, diferencë e cila është trashëguar për tâ përdorur në vitin pasardhës.
- <u>Për vitin 2021</u>, me të ardhurat e veta Bashkia mbulon 52% të shpenzimeve. Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore në PBA janë planifikuar për vlerën 225,338 mijë lekë, në fakt janë realizuar për vlerën 266,847 mijë lekë ose 41,509 mijë lekë më shumë, diferencë e cila ka rezultuar nga arkëtimi i kontributit të BankersPetrolium për lëkundjet e banesave të familjeve në Nj. A. Zharrëz me vlerë 21,653 mijë lekë dhe 19,856 mijë lekë nga realizimi i të ardhurave, të cilat janë trashëguar për tâ përdorur në vitin pasardhës.

Planifikimi i Buxhetit të Bashkisë Patos për vitet 2019, 2020 dhe 2021 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, gërma ñ*dh*ò të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave ñ*Për përgatitjen e buxhetit vendor*ò, konkretisht UMF nr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, në ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 ñ*Për buxhetin e vitit 2020*ò, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkisë Patos.
Programi i të ardhurave për vitet 2020 dhe 2021 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 73 datë 26.11.2019 ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Patos për vitin 2020*ò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1824/1 prot. dhe VKB nr. 47 datë 25.11.2020 ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Patos për vitin 2021*ò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1231/1 datë 09.12.20220.
Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkisë me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Për vitin 2020 buxheti i Bashkisë Patos është hartuar dhe miratuar i ndarë në 15 Programe buxhetore dhe për vitin 2021 në 16 Programe.
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të viteve 2019, 2020, 2021 paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet. Po kështu rezulton se janë bërë argumentimet e transferimeve të ndryshme të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga pushteti qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.
Gjatë periudhës së audituar, janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit, këto lëvizje janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Gjatë vitit 2019, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit dhe kapin vlerat e paraqitura në **Pasqyrën B3**, bashkëlidhur.
Ndryshimet në buxhet (shtesa/pakësime) për vitin 2019 janë si më poshtë:
1. VKB nr. 12, datë 24.04.2019 ñ*Për transferim fondi brenda programit të Arsimit dhe Kulturës*ò duke pakësuar fondin për mirëmbajtjen e tualeteve të pallatit të kulturës dhe shtim fondi për blerjen e 2 bokseve me amplifikim, në vlerën 100,000 lekë.

2. VKB nr. 13, datë 25.04.2019 ñ*Transferim fondi brenda programit të infrastrukturës*ò, duke pakësuar fondin prej 151,308 lekë nga zëri ñ*Lidhje kontrata të reja energjie*ò, në zërin ñ*Blerje bazë materiale për linjat e vaditjes në bulevardin Republika*ò.
3. VKB nr. 17, datë 20.06.2019 ñ*Transferim fondi brenda programit të Mirëmbajtjes Urbane*ò, duke pakësuar fondin prej 263,160 lekë nga zëri shpenzime ndriçimi rrugor, në zërin blerje materiale për mirëmbajtje e sistemim të ujërave të bardha Zharrëz.
4. VKB nr. 20, datë 20.03.2019 ñ*Transferim fondi në programin e Administratës*ò duke e shtuar artikullin 606 me 111,736 lekë dhe duke pakësuar artikullin 600 me 111,736 lekë.
5. VKB nr. 32, datë 20.05.2019 ñ*Për miratim fondi për blerje bazë materiale për riparime shtëpie në shërbim të qytetarëve*ò duke transferuar fondin prej 640,271 lekë nga zëri ñ*Rimbursimqeraje banesa*ò.
6. VKB nr. 45, datë 13.06.2019 ñ*Transferim fondi brenda Njësisë shpenzuese të Bashkisë*ò, për dhënien e ndihmës financiare për ndërtimin e banesave të shkatërruara nga tërmeti në Bashkinë Korçë, duke pakësuar fondet si më poshtë:
- Pakësim fondi në programin 01110, artikulli 602, në vlerën 700,000 lekë;
- Pakësim fondi në programin 01110, artikulli 604, në vlerën 1,500,000 lekë;
- Pakësim fondi në programin 06330, artikulli 602, në vlerën 400,000 lekë dhe duke shtuar fondin në programin 01110, artikulli 606, në vlerën 2,600,000 lekë.

7. V. Titullari nr. 14, datë 20.05.2019 ñ*Transferim fondi brenda programit të infrastrukturës*ò, duke pakësuar fondin prej 2,773,869 lekë nga zëri ñ*Rikonstruksion i rrugës AlitGjiriti*ò, në zërin ñ*Ndërtim emergjent i murit mbajtës në Shëtitoren Republika*ò.
8. VKB nr. 66, datë 27.09.2019 ñ*Për miratim fondi për blerje bazë materiale për riparime shtëpie në shërbim të qytetarëve*ò me fondin prej 200,963 lekë në programin e Infrastrukturës.
9. VKB nr. 68, datë 09.10.2019 ñ*Për miratim fondi për financim të transportit të nxënësve të Shkollës MustafaMatohiti për në shkollat e tjera të Qytetit deri në përfundimin e rikonstruksionit të kësaj shkolle*ò, me vlerë 534,600 lekë, brenda programit të Arsimit Bazë.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të EMP për buxhetin afatmesëm 2019-2021 me shkresën nr. 874/11 protokolli, datë 09.11.2018, ku kërkesat janë hartuar duke iu referuar kryesisht realizimit të artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Patos rezultoi se për vitin 2019, gjendja fillestare e planit të çelur së bashku me fondet e trashëguara është **422,649 mijë lekë**.

Me VKB nr. 16, datë 22.02.2019, buxheti i vitit 2019 është shtuar me 144,542 mijë lekë nga shpërndarja e fondeve të trashëguara.

Në muajin maj, plani vjetor është shtuar me 872 mijë lekë shtesë në funksionin specifik ñ*Arsimi Bazë*ò, në llogarinë ekonomike 600+601.

Nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve rezulton se Bashkia Patos nuk ka pasur shtesë fondi për vitin 2019, përveç shtesës që vjen nga transferta e kushtëzuar dhe ministritë e linjës.

Gjendja e buxhetit të planifikuar në fund të vitit, për vitin 2019 ka qenë **655,069 mijë lekë** nga burimet e veta. Shpenzimet nga burimet e veta, për vitin 2019 kanë vlerën 544,233 mijë lekë dhe diferenca 110,836 mijë lekë është trashëguar për vitin 2020.

<u>Për vitin 2020</u>, çeljet e reja janë paraqitur në **Pasqyrën B4**, bashkëlidhur.

Ndryshimet në buxhet (shtesa/pakësime) për vitin 2020 janë si më poshtë:

1. V. Titullari nr. 2, datë 01.04.2020 ñ*Për transferim fondi Brenda programit të Mirëmbajtjes Urbane*ò duke pakësuar fondin për energji elektrike dhe shtim fondi për blerjen e pajisjeve për dezinfektim për punonjësit në kushtet e Covid 19, në vlerën 100,000 lekë.
2. V. Titullari nr. 9, datë 27.05.2020 ñ*Transferim fondi brenda programit të Nd. Gjelbërimi*ò, duke pakësuar fondin prej 81,120 lekë nga zëri ñ*Shpenzime blerje pesticide dhe lule dekorative*ò në zërin ñ*Blerje pajisje për vaditje dhe aksesorët ndihmës*ò.

3. V. Titullari nr. 10, datë 04.06.2020 ñ*Transferim fondi në programin e Administratës*ò, duke e shtuar artikullin 602 me 251,144 lekë për punime për spostimin e kabinës elektrike dhe duke pakësuar artikullin 602 në zërin shpenzime për energji elektrike.
4. VKB nr. 12, datë 02.04.2020 ñ*Për miratim fondi për shtresat në nevojë në kushtet e Pandemisë së shkaktuar nga Covid 19*ò, duke transferuar fondin prej 500,000 lekë nga llogaria 604 e programit të Emergjencave Civile, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.
5. V. Titullari nr. 14, datë 07.07.2020 ñ*Transferim fondi brenda programit të Administratës Vendore*ò në llogaritë ekonomike:
- pakësim llog. 602, tek zëri Shp. trajnimi në Administratë, me vlerën 120,000 lekë, shtim në llog. 602 për blerje aksesorë për mirëmbajtjen e sistemit të kamerave në vlerën 120,000 lekë;
- shtim në llog. 231, me vlerën 524,000 lekë për blerje perde për gjithë ambjentet Brenda Bashkisë, e cila do të jetë nga çlirim fondi i Rikonstruksionit të Godinës së Bashkisë.
6. VKB nr. 20, datë 27.05.2020 ñ*Mbi rishikimin e buxhetit në kushtet e Pandemisë së shkaktuar nga Covid 19*ò, duke marë masa lehtësuese duke pakësuar tarifat për bizneset e Patosit si më poshtë:
- Pakësim i të ardhurave në vlerën 1,803,000 lekë, fond ky që do të reflektohet në buxhet në pakësim të shpenzimeve tek Llogaria 604 ñ*Fond Kontigjencës*ò.
7. V. Titullari nr. 15, datë 16.07.2020 ñ*Transferim fondi brenda programit të infrastrukturës*ò, duke pakësuar fondin 58,610 lekë nga zëri ñ*Blerje material KUZ mbas 6-Katëshit*ò në zërin ñ*Blerje material KUZ Dukas dhe Margëlliç*ò.
8. VKB nr. 31, datë15.07.2020 ñ*Për miratimin e ndihmës financiare për z. S.V për sëmundje*ò,duke pakësuar fondin prej 200,000 lekë nga artikulli 600, në artikullin 606 për dhënie ndihme.
9. V. Titullari nr. 16, datë 27.07.2020 ñ*Transferim fondi brenda programit të Arsim/ Kulturës*ò, duke përdorur fond nga zëri ñ*Aktivitetet kulturore*ò, në zërin ñ*Blerje flamuj dhe banderola për Institucionet Arsimore*ò.
10. V. Titullari nr. 17, datë 27.07.2020 ñ*Transferim fondi brenda programit të Nd. Pastrimi*ò, duke përdorur fondin 20,000 lekë nga zëri ñ*Blerje veshmbathje*ò në zërin ñ*Blerje klor dhe gëlqere në kushtet e Covid-19*ò.
11. V. Titullari nr. 18, datë 28.07.2020 ñ*Transferim fondi brenda programit të Bujqësisë*ò, duke pakësuar fondin prej 2,000,000 lekë nga zëri ñ*Mbështetje financiare për fermerët që merren me rritjen e bagëtive të imta*ò, duke shtuar zërin ñ*Gërmim, transport, zhavorr mali për mirëmbajtjen e rrugëve bujqësore*ò.
12. V. Titullari nr. 24, datë 24.09.2020 ñ*Transferim fondi Brenda programit të Arsim Kulturës*ò, duke përdorur fondin e çliruar nga zëri ñ*Shpenzime për Blerje bazë materiale për mirëmbajtje lyerje për shkolla e kopshte*ò, me vlerë 205,200 lekë, për zërin ñ*Blerje bazë materiale për dezinfektim të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të shkollave*ò, me vlerë 205,200 lekë, në kushtet e Covid-19.
13. V. Titullari nr. 26, datë 17.09.2020 ñ*Transferim fondi brenda programit Gjelbërim dhe Mirëmbajtje Varreza*ò duke shtuar zërin ñ*Blerje lule dekorative*ò, në vlerën 152,000 lekë dhe duke pakësuar zërat ñ*Blerje bazë materiale mirëmbajtje varreza*ò në vlerën 65,000 lekë, zërin ñ*Blerje bar dhe plehra kimik dhe organik*ò, në vlerën 61,000 lekë dhe ñ*Blerje vegla Pune*ò, në vlerën 26,000 lekë.
14. Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 29.09.2020 ñ*Mbi miratimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2020*ò, duke shtuar zërin e të ardhurave ñ*Tatim i të ardhurave personale*ò me 3,512,555 lekë dhe duke e reflektuar këtë shtesë në zërin e shpenzimeve ñ*Shpenzime për parandalimin e pandemisë në Institucionet Arsimore dhe përballimin e problematikave që dalin në shërbimet publike*ò
15. V. Titullari ñ*Transferim fondi brenda programit të infrastrukturës në llogarinë*

*ekonomike 231*ò, duke përdorur fondin e çliruar nga prokurimi i objektit ñ*Rikonstruksioni i zyrave mbështetëse dhe sistemimi i hapësirave pranë Bashkisë*ò për blerje ñ*Bazë materiale për shtesë të ndriçimit të sallës së këshillit*ò me vlerë 187,716 lekë.

16. V. Titullari nr. 28, datë 02.11.2020 për ñ*Transferim fondi brenda programit të administratës vendore*ò, me pakësim fondi në zërin ñ*Telefon fiks dhe internet*ò, në vlerën 100,000 lekë dhe shtim në zërin ñ*Mirëmbajtje mjete transporti*ò.

17. V. Titullari nr. 29, datë 04.11.2020 për ñ*Transferim fondi brenda programit të ujitje kullimit*ò, duke pakësuar fondin nga zëri buxhetor ñ*Përmirësimi i teknikave të ujitjes, skemave të reja dhe të trashëguara*ò, në vlerën 3,647,482 lekë dhe duke e shtuar në zërin buxhetor ñ*Blerje Pajisje (Rimorkiator dhe freze për ekskavatorin*)ò.

18. V. Titullari nr. 30, datë 05.11.2020, ñ*Transferim fondi brenda programit të administratës vendore*ò nga zëri ñ*Vegla pune*ò për blerje ñ*Rafte Metalike*ò, për zgjidhjen emergjente të situatës së arkivës.

19. V. Titullari nr. 31, datë 26.11.2020, për ñ*Transferim fondi brenda programit të shërbimeve rekreative sportive dhe argëtim*ò, për çlirimin e fondit nga zërat e realizuar për mbulimin e shpenzimeve ñ*trajtim ushqimor*ò me vlerë 1,221,120.

20. V. Titullari nr. 32, datë 26.11.2020 për ñ*Transferim fondi brenda programit të Infrastrukturës*ò duke shtuar vlerën 1,912,158 lekë të financimit në objektin ñ*Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Dukas*ò dhe pakësim të vlerës së financimit në objektin ñ*Krijimi dhe montimi i statujës Fontana*ò.

21. V. Titullari nr. 33 datë 02.12.2020 për ñ*Transferim fondi brenda programit të Arsimit, Trashëgimisë Kulturore*ò nga objekti ñ*Rikonstruksion i ambienteve të shkollës KoliDimo*ò, Frashër në vlerën 5,000,000 lekë për adapatimin në kopësht për fëmijë si pjesë e listës së Projekteve prioritare të miratuar me VKB nr. 87 datë 13.12.201

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të EMP për buxhetin AFM 2020-2022 me shkresën nr. 2518 protokolli, në tetor-nëntor 2019, ku kërkesat janë hartuar duke ju referuar kryesisht realizimit të artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Patos rezultoi se për vitin 2020, gjendja fillestare e planit të çelur së bashku me fondet e trashëguara është **542,757 mijë lekë**.

Në muajin maj, plani vjetor është pakësuar me **1,803, mijë lekë** ñ*Pakësim i të ardhurave nga lehtësimi i bizneseve nga tarifat vendore në kushtet e pandemisë*ò, sipas VKB nr. 20, datë 27.05.2020.

Nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve rezulton se Bashkia Patos nuk ka pasur shtesë fondi për vitin 2020.

Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 29.09.2020 ñ*Mbi miratimin e të ardhurave dhe shpenzimeve shtesë në buxhetin e vitit 2020*ò, duke shtuar zërin e të ardhurave ñ*Tatim i të ardhurave personale*ò, buxheti i Bashkisë Patos është rritur me **3,512 mijë lekë**, duke e shpërndarë këtë shtesë në zërin ñ*Shpenzime për parandalimin e pandemisë në Institucionet Arsimore dhe përballimin e problematikave që dalin në shërbimet publike*ò dhe shtesë nga PNUD në vlerën **284 mijë lekë**.

Gjendja e buxhetit të planifikuar në fund të vitit 2020 ka qenë **544,750 mijë lekë** nga burimet e veta.

Në fund të vitit 2020 ka pasur tejkalim të realizimit të të ardhurave vjetore, në vlerën 13,630 mijë lekë, e cila është trashëguar për vitin 2021.

<u>Për vitin 2021</u>, çeljet e reja janë paraqitur në **Pasqyrën B5**, bashkëlidhur.

Ndryshimet në buxhet (shtesa/pakësime) për vitin 2021 janë si më poshtë:

1. VKB nr. 4, datë 28.01.2021 ñ*Për miratimin e shpërndarjes së fondeve të trashëguara për vitin 2021 në vlerën 172,121,350 lekë*ò.

2. VKB nr. 6, datë 28.01.2021 ñ*Për miratimin e përdorimit të fondit për mbrojtjen civile për ndërtim emergjent të murit mbajtës në Ruzhdie, si pasojë e rrëshqitjes së tokës dhe kthimin e rrugës në gjendjen e mëparshme duke pakësuar llogarinë 604 në vlerën 8,634,380 lekë dhe shtuar llogarinë 231 në vlerën 8,634,380 lekë*ò.
3. VKB nr. 8, datë 24.02.2021 ñ*Për miratimin e përdorimit të fondit për mbrojtjen civile për ndërtimin emergjent të murit mbajtës me gabiona dhe gurë në Dukas-Breg si pasojë e rrëshqitjes së tokës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme*ò duke pakësuar llogarinë 604 në vlerën 6,758,854 lekë dhe shtuar llogarinë 231 në vlerën 6,758,854 lekë.
4. VKB nr. 9, datë 24.02.2021 ñ*Për financimin e lidhjes së kontratës së energjisë elektrike për z. S. S. si familje në kushte të vështira socio-ekonomike*ò në vlerën 33,765 lekë.
5. VKB nr. 10, datë 24.02.2021 ñ*Për shpronësimin në interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit sistemimi i hapësirave publike dhe parkim, lagjja e re, blloku pas ish-Bashkisë*ò bëhet miratimi i shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme z. A.C dhe z. H. Q në vlerën 1,818,523 lekë.
6. VKB nr. 12, datë 08.03.2021 ñ*Për miratimin e shtesës së të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2021*ò, shtesa në total është 15,051,331 lekë.
7. V.Titullari nr. 44, datë 06.04.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të administratës vendore*ò, duke pakësuar fondin për materiale pastrimi llogaria 602 në vlerën 141,500 lekë dhe shtim fondi për blerje veshje uniforma për policinë Bashkiake, llogaria 602 në vlerën 141,500 lekë.
8. VKB nr. 19, datë 20.04.2021 ñ*Për dhënien e ndihmës financiare z. Ç.Ç për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në ballkon*ò duke pakësuar llogarinë 604 në vlerën 23,212 lekë dhe shtuar llogarinë 602 në vlerën 23,212 lekë.
9. VKB nr. 24, datë 27.05.2021 ñ*Për dhënien e ndihmës financiare z. D. A. për shkak të sëmundje të rëndë*ò, duke pakësuar llogarinë 604 në vlerën 75,000 lekë dhe shtuar llogarinë 602-609 në vlerën 75,000 lekë.
10. VKB nr. 25, datë 27.05.2021 ñ*Për dhënien e ndihmës financiare z. R.R për shkak të një sëmundje të rëndë*ò, duke pakësuar llogarinë 604 në vlerën 75,000 lekë dhe shtuar llogarinë 602-609 në vlerën 75,000 lekë.
11. V. Titullari nr. 73, datë 06.07.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të infrastrukturës*ò duke pakësuar zërin ñ*Fond për rimbursimin e familjeve të pastreha*ò, llogaria 602 në vlerën 221,032 lekë dhe shtim fondi në zërin shpronësime në rrugën KoliMarku, llogaria 602 në vlerën 221,032 lekë.
12. V. Titullari nr. 74, datë 06.07.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të infrastrukturës*ò, duke pakësuar zërin ñ*Fond për rimbursimin e familjeve të pastreha*ò, llogaria 602, në vlerën 50,294 lekë dhe shtim fondi në zërin ñ*Shpronësime*ò llogaria 602 në vlerën 50,294 lekë.
13. V. Titullari nr. 75, datë 12.07.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të ujitje dhe kullimit*ò, duke pakësuar zërin ñ*Rehabilitimi i kanëaleve kulluese e vaditëse*ò llogaria 602 në vlerën 1,227,970 dhe shtim fondi në zërin ñ*Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë*ò, llogaria 231 në vlerën 1,227,970 lekë.
14. V. Titullari nr. 84 datë 13.08.2021 ñ*Për miratim fondi brenda programit të infrastrukturës*ò, duke pakësuar zërin ñ*Fond për rimbursimin e familjeve të pastreha*ò, llogaria 602 në vlerën 453,634 lekë dhe shtim fondi në zërin ñ*Blerje materiale për furnizim me uji të familjeve që do strehohen në ambientet e Banesave Sociale, seksioni II*ò llogaria 602, në vlerën 453,634 lekë.
15. V. Titullari nr. 103, datë 23.09.2021 ñ*Për transferim fondi brenda kodeve të projekteve në programin e infrastrukturës*ò duke pakësuar objekt si:
- Rikonstruksioni i rrugës së varrezave Dukas në vlerën 4,283,272 lekë;

- Krijimi dhe montimi i statujës Fontana në vlerën 4,022,842 lekë;
- Sistemim e rivitalizim i miniblloqeve në lagjen e re dhe naftëtari në vlerën 126,587 lekë;
- Pakësohet llogaria 231 dhe bëhet shtim fondi në objektin ñ*Rikonstruksioni i segmentit H. M*ò, llogaria 231 në vlerën 8,432,701 lekë.

16. VKB nr. 45 datë 28.09.2021 ñ*Mbi miratimin e transferimit të fondit midis programeve brenda llogarisë ekonomike 231*ò, shtohet programi i sportit, llogaria 231 në vlerën 2,223,000 lekë dhe pakësohet programi i arsimit bazë, llogaria 231 në vlerën 2,223,000 lekë.
17. VKB nr. 44, datë 28.09.2021 ñ*Për dhënien e ndihmës financiare z. M.Z për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë*ò duke pakësuar llogarinë 604 në vlerën 81,685 lekë dhe shtuar llogarinë 602 në vlerën 81,685 lekë.
18. VKB nr. 111, datë 13.10.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të mirëmbajtje urbane*ò, duke pakësuar zërin sigurim automjetesh llogaria 602 në vlerën 150,000 dhe shtim fondi në zërin pjesë këmbimi dhe mirëmbajtje mjeti ADTM 32 llogaria 602 në vlerën 150,000 lekë.
19. VKB nr. 112, datë 13.10.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të arsimit, kulturës dhe sportit*ò duke pakësuar zërin ñ*Projekte artistike e kulturore*ò, llogaria 602 në vlerën 181,968 dhe shtim fondi në zërat:
- Blerje pompë për furnizimin me ujë në Shkollën Muhamet Shehu, me vlerë 51,420 lekë;
- Blerje bojë për vijëzime, për distancimin fizik në institucionet arsimore me vlerë 47,124 lekë;
- Depozitë uji në shkollën Hekuran Maneku, me vlerë 83,424 lekë, duke shtuar llogarinë 602.

20. VKB nr. 53, datë 04.11.2021 ñ*Për transferimin e fondit midis programeve brenda llogarisë ekonomike 602*ò pakësohen programet:
- Programi ñArsimi bazëò llogaria 602, sasia 2,800 litra karburant;
- Programi ñShërbime Rekreativeò llogaria 602, sasia 800 litra karburant;
- Programi ñAdministrata Vendoreò llogaria 602, sasia 325 litra karburant;
- Shtim fondi i programit të pastrimit, llogaria 602, në sasinë 3,925 litra karburant për mjetet e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, që do të kryejnë transportin e mbetjeve urbane në Inceneratorin e Fierit.

21. V. Titullari nr. 117, datë 19.10.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të shërbimeve sociale*ò, duke pakësuar zërin ñ*Projekte të shërbimit social*ò, llogaria 602, me vlerë 292,911 lekë dhe shtim fondi për projektin ñ*Valid*ò llogaria 602, me vlerë 292,911 lekë.
22. V. Titullari nr. 118, datë 19.10.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit shërbime rekreative sport e argëtim*ò:
- Pakësohet zëri ñ*Dieta e bileta brenda vendit*ò, llogaria 602 me vlerë 12,800 lekë;
- Pakësohet zëri ñ*Mjete stërvitore*ò, llogaria 602 me vlerë 42,400 lekë;
- Shtim fondi në zërin ñ*Mirëmbajtje të fushës dhe Tribunës*ò, llogaria 602 me vlerë 55,200 lekë.

23. V. Titullari nr. 110, datë 13.10.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit të infrastrukturës*ò, pakësim fondi llogaria 231 me vlerë 3,029,000 lekë;
- Shtim fondi në llogarinë 231, zëri ñ*Ndërtim kuartalli i ri varreza e qytetit*ò me vlerë 1,500,000 lekë;
- Shtim fondi në llogarinë 231, zëri ñ*Rrethimi i varrezave publike të fshatrave*ò, me vlerë 644,000 lekë;
- Shtim fondi në llogarinë 231, zëri ñ*Bordura metalike mbrojtëse në disa trotuare në qytetit*ò, me vlerë 310,000 lekë;
- Shtim fondi në llogarinë 231, zëri ñ*Furnizim vendosje guardiale*ò me vlerë 575,000 lekë.

24. V. Titullari nr. 120, datë 01.11.2021 ñ*Për transferim fondi brenda programit shërbime rekreative, sport dhe argëtim*ò, pakësohet llogaria 602, me vlerë 463,000 lekë dhe bëhet

shtim fondi në zërin ñ*Shpenzime page, sigurime shoqërore*ò llogaria 600/601, me vlerë 463,000 lekë.
25. VKB nr. 61 datë 26.11.2021 ñ*Për miratimin e fondit për rikonstruksionin e banesës së qytetarit RaufNuraj*ò, me vlerë 162,782 lekë.
26. VKB nr. 63 datë 26.11.2021 ñ*Për miratimin e fondit për rikonstruksionin e çatisë së banesës së Znj. V.M*ò, me vlerë 411,573 lekë.
Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të EMP për buxhetin AFM 2021-2024 me shkresën nr. 874/10 protokolli, datë 09.09.2020, ku kërkesat janë hartuar duke ju referuar kryesisht realizimit të artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.
Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Patos rezultoi se për vitin 2021, gjendja fillestare e planit të çelur së bashku me fondet e trashëguara është **499,652 mijë lekë**, miratuar me VKB nr. 51 datë 18.12.2020.
Me VKB nr. 4, datë 28.01.2021, buxheti i vitit 2021 është shtuar me 172,121 mijë lekë, nga shpërndarja e fondeve të trashëguara.
Me VKB nr. 12, datë 08.03.2021, plani vjetor është shtuar me vlerën 3,683 mijë lekë në funksionin specifik ñ*Arsimi Bazë+Mesëm*ò, për mbulimin e shtesës së pagave për vitin 2021 për këto funksione, në llogarinë ekonomike 600+601 dhe shtesë buxheti nga të ardhurat vendore me vlerë 11,368 mijë lekë.
Nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve rezulton se Bashkia Patos nuk ka pasur shtesë fondi për vitin 2021, përveç shtesës që vjen nga transferta e kushtëzuar dhe ministritë e linjës.
Gjendja e buxhetit të planifikuar në fund të vitit 2021 ka qenë **679,472 mijë lekë**, nga burimet e veta. Shpenzimet nga burimet e veta për vitin 2021 kanë qenë në vlerën 440,921 mijë lekë dhe diferenca prej 138,551 mijë lekë është trashëguar për vitin 2022.
Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse ñ*Për procedurat standarde të hartimit dhe zbatimit të buxhetit*ò.
Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Patos dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.
Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2020, u konstatua se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit 2020, buxheti i Bashkisë Patos ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Fier.
U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit Patos dhe u gjetën të

rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave dhe tarifave të Bashkisë dhe të granteve. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Patos janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Patos, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.
Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve. Gjatë auditimit, rezulton se Kryetari i Bashkisë ka raportuar normalisht në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare, sipas nenit 64 të ligjit nr. 30/2015 dhe ligjit nr. 139/2015.
Nga sa më sipër, rezulton se kanë gjetur zbatim UMF nr. 1, datë 9.1.1996 ñ*Për procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore*ò dhe UMF nr. 2, datë 27.1.1999 ñ*Për urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave*ò.
Ndryshimet buxhetore janë paraqitur në formë tabelore në **Pasqyrën B6**, në anekset bashkëlidhur.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Titulli i gjetjes: Diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera.
Situata:Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Patos, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Patos, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuara nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.
Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2019, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në **Pasqyrën B7**, në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2019, sipas programeve është paraqitur në **Pasqyrën B8**, në Anekset bashkëlidhur.
Referuar të dhënave të pasqyrës më sipër, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën 470,054 mijë lekë, deri në masën 83%.
Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, për vitin 2019, e zënë investimet me 43%, e ndjekur nga pagat me 39% dhe shpenzimet operative me 18%.
Referuar tabelave më poshtë, të ardhurat e Bashkisë Patos për vitin 2019 janë realizuar në masën 106%, konkretisht nga 203,746 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 216,894 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2018 në vitin 2019 janë 144,542 mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2019 është 138,431 mijë lekë, transferta specifike faktike është 81,613 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2019 është 568,064 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 102%, pra 581,244 mijë lekë. Për vitin 2019 ka pasur një tejkalim të të ardhurave vendore në vlerën 13,179 mijë lekë.
Realizimi i të ardhurave për vitin 2019, referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur në **Pasqyrën B9**, në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2020, referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur në **Pasqyrën B10**, në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2020, sipas programeve është paraqitur në **Pasqyrën B11**, në Anekset bashkëlidhur.

Referuar të dhënave të pasqyrës më sipër, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit është në masën 385,973 mijë lekë ose 71%.
Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, për vitin 2020, e zënë pagat me 53%, e ndjekur nga investimet me 27% dhe shpenzimet operative me 20%.
Referuar tabelave më poshtë, të ardhurat e Bashkisë Patos për vitin 2020 janë realizuar në masën 107%, konkretisht nga 218,869 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 234,208 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020 janë 110,836 mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2020 është 126,610 mijë lekë, transferta specifike faktike është 86,440 mijë lekë, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës është alokuar një shtesë me vlerë 265,376 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2020 është 813,574 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 71%, pra 433,422 mijë lekë (383,973 mijë lekë burimet e veta + 49,449 mijë lekë FZHR).
Realizimi i të ardhurave për vitin 2020, referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur në **Pasqyrën B12**, në Anekset bashkëlidhur.

- **Sipas burimeve të financimit:**

<u>Për vitin 2020</u>, nga **transferta e pakushtëzuar,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 141,012 mijë lekë (126,610 mijë lekë të ardhura gjatë vitit +14,402 mijë lekë të ardhura të trashëguara) dhe janë realizuar në vlerën 99,987 mijë lekë ose në masën 71%, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B13**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga **transferta specifike,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 102,525 mijë lekë (86,440 mijë lekë të ardhura gjatë vitit + 22,526 mijë lekë të ardhura të trashëguara) dhe janë realizuar në vlerën 76,711 mijë lekë ose në masën 75%, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B14**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga të **ardhurat e veta,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 218,869 mijëlekë dhe janë realizuar në vlerën 234,208 mijë lekë ose në masën 107%, nga të cilat73,907 mijë lekë janë trashëguar, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B15**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga **fondet e deleguara,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 203,109 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 202,787 mijë lekë ose në masën 99.8%, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B16**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga **fondet e FZHR dhe ministritë e linjës,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 265,376 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 255,479 mijë lekë ose në masën 96% %, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B17**, në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2021, referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur në **Pasqyrën B18**, në Anekset bashkëlidhur.
Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2021, sipas programeve është paraqitur në **Pasqyrën B19**, në Anekset bashkëlidhur.
Referuar të dhënave të pasqyrës më sipër, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën 440,920 mijë lekë, deri në masën 66.
Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, për vitin 2021, e zënë pagat me 49%, e ndjekur nga investimet me 26% dhe shpenzimet operative me 25%.
Referuar tabelave më poshtë, të ardhurat e Bashkisë Patos për vitin 2021 janë realizuar në masën 97%, konkretisht nga 274,201 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 266,847 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vitin 2021 janë 172,121 mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2021 është 144,143 mijë lekë, transferta specifike (shtuar gjatë vitit me 3,683 mijë lekë) është 96360 mijë lekë, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës është alokuar një shtesë me vlerë 316,973 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 313,972 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2021 është 1,003,799 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 71%, pra 993,443 mijë lekë (679,471 mijë lekë burimet e veta + 313,972 mijë lekë FZHR + transferta e kushtëzuar + Ministritë e Linjës).
Realizimi i të ardhurave për vitin 2021, referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur

në **Pasqyrën B20**, në Anekset bashkëlidhur.
<u>Për vitin 2021</u>, nga **transferta e pakushtëzuar,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 185,168 mijë lekë (144,143 mijë lekë të ardhura gjatë vitit +41,025 mijë lekë të ardhura të trashëguara) dhe janë realizuar në vlerën 123,646 mijë lekë ose në masën 67%, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B21**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga **transferta specifike,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 122,173 mijë lekë (96,360 mijë lekë të ardhura gjatë vitit +25,813 mijë lekë të ardhura të trashëguara) dhe janë realizuar në vlerën 88,700 mijë lekë ose në masën 73%, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B22**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga të **ardhurat e veta,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 274,201 mijëlekë dhe janë realizuar në vlerën 266,847 lekë ose në masën 97% nga të cilat104,084 mijë lekë janë trashëguar, 1,198 mijë lekë nga PNUD-i, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B23**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga **fondet e deleguara,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 191,879 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 189,004 mijë lekë ose në masën 99%, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B24**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga **fondet e ministrive të linjës,** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 124,513 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 124,404 mijë lekë ose në masën 99.9%, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B25**, në Anekset bashkëlidhur.
Gjatë periudhës objekt auditimi, nuk ka pasur financime të huaja.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos dhe znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës.
<u>Kriteri:</u> ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 pika 1.3 germa ñcò dhe ñçò; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñ*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*ò, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.
<u>Ndikimi/Efekti:</u>Planifikimi joreal i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.
<u>Shkaku:</u> Planifikim i të ardhurave dhe më pas i procedurave të prokurimeve për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik. Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mosnxjerrja e konkluzioneve të sakta për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve.
<u>Rëndësia:</u> E lartë
<u>Rekomandim:</u>Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Patos, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të

bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

- **Miratimi i buxhetit faktik:**

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Patos ka miratuar buxheti faktik, ku për vitin 2020 është miratuar me Vendim të KB nr. 04, datë 28.01.2021, bashkë me shpërndarjen e fondeve të trashëguara. Në relacionin përfundimtar të zbatimit të buxhetit është hartuar vetëm realizimi i treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk është shoqëruar me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

- **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:**

Në zbatim të nenit 48 ñ*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*ò të ligjit 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, Bashkia Patos ka raportuar si më poshtë, sipas viteve:

<u>Për vitin 2019</u>, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin, objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

4 mujori i parë:	*Nr. 1282/1, datë 08.05.2019, Informuar KB;*
4 mujori i dytë:	*Nr. 2450, datë 17.09.2019, Informuar KB;*
Raporti i Konsoliduar vjetor:	*Nr. 17. datë 22.04.2020, miratuar në KB.*

<u>Për vitin 2020</u>, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

4 mujori i parë:	*Nr. 1084, datë 15.05.2020, Informuar KB;*
4 mujori i dytë:	*Nr. 2196, datë 14.09.2020, Informuar KB;*
Raporti vjetor:	*Nr. 237. datë 20.01.2021, Informuar KB.*

<u>Për vitin 2021</u>, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

4 mujori i parë:	*Nr. 1171/7, datë 19.05.2021, Informuar KB;*
4 mujori i dytë:	*Nr. 2325/11, datë 17.09.2021, Informuar KB;*
Raporti vjetor:	*Nr. 296. datë 25.01.2022, Informuar KB.*

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/kontigjencës, ku:

<u>Për vitin 2019</u> është planifikuar në masën 4,500 mijë lekë, nga e cila është përdorur vlera 2,600 mijë lekë për dhënie ndihme financiare për Bashkinë Korçë, për ndërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti sipas VKB nr. 45, datë 13.06.2019. Ndërsa vlera tjetër nuk është përdorur.

<u>Për vitin 2020</u> është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/kontigjencës, në masën 4,500 mijë lekë, nga e cila është përdorur vlera 500 mijë lekë për blerje paketa ushqimore për familjet në nevojë në kushtet e pandemisë, në zbatim të VKB nr. 12, datë 02.04.2020. Ndërsa shuma 3,512 mijë lekë është miratuar si shtesë e fondit rezervë për përballimin e shpenzimeve për parandalimin e pandemisë sipas VKB nr. 41, datë 29.09.2020 dhe nuk është përdorur.

<u>Për vitin 2021</u> është planifikuar një fond Rezervë dhe Kontigjencës prej 4,500 mijë lekë, i cili është përdorur gjatë vitit si më poshtë:

Me VKB nr. 24, datë 27.05.2021, me vlerë 150 mijë lekë për ndihmë familjare për sëmundje të rëndë për dy qytetarë;

Me VKB nr. 26, datë 29.06.2021, me vlerë 888 mijë lekë për mbulimin e shpenzimeve mortore për humbjen e katër personave të familjes G.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:**

Nga Bashkia Patos është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2020 ka qenë 17,296 mijë lekë dhe nuk është përdorur, ndërsa për vitin 2021 ka qenë 19,986 mijë lekë dhe është përdorur për ndërtimin e një muri emergjent i shkaktuar nga dukuritë natyrore.
Konstatohet se fondi i krijuar është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shteti, ku referuar buxhetit respektiv të vitit 2020 me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 ñ*Për mbrojtjen Civile*ò, pika 1 e nenit neni 65 ñ*Buxheti i bashkive*ò fondi është parashikuar sa duhett. Fondi për emergjencat civile për vitin 2021 ka qenë 19,986 mijë lekë, e cila është përdorur për ndërtimin e një muri emergjent i shkaktuar nga dukuritë natyrore.

- **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Patos:**

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Patos gjatë periudhës së audituar nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

- **Realizimi i Investimeve:**

Titulli i gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre.
Situata: Grupi i KLSH-së konstatoi se, niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet i ulët, ku **për vitin 2019** investimet janë realizuar në nivelin **79%**, ku nga vlera e planifikuar prej **241,808** mijë lekë është realizuar vlera **185,957** lekë; **për vitin 2020** investimet janë realizuar në nivelin **54%**, ku nga vlera e planifikuar prej **192,095** mijë lekë është realizuar vlera **104,348** lekë; dhe **për vitin 2021** investimet janë realizuar në nivelin **36%**, ku nga vlera e planifikuar prej **304,894** mijë lekë është realizuar vlera **110,341** mijë lekë.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos dhe znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës.
Kriteri: ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 pika 1.3 germa ñcò dhe ñçò; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñ*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*ò, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.
Ndikimi/Efekti: Planifikimi i shpenzimeve pa siguruar burimin e tyre, i cili kryesisht vjen nga të ardhurat, mbështetja e tyre në planin e të ardhurave, çon në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.
Shkaku: Planifikimi i shpenzimeve, pa një studim të mirëfilltë, duke u bazuar në raport me planin dhe jo me faktin.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga Bashkia Patos, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e të ardhurave reale, të disponueshme dhe jo të planifikimit, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Patos.

- **Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore**

Realizimi i buxhetit për vitet objekt auditimi, sipas burimeve të financimit, është paraqitur i përmbledhur në **Pasqyrën B25**, në Anekset bashkëlidhur.

- **Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.**

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga Bashkia Patos gjatë vitit 2020 janë kryer në formën e ndihmës ekonomike 4 transaksione, në vlerën totale 306,335 lekë, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B26**, në Anekset bashkëlidhur.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.).

Nga auditimi i kryer në Bashkinë Patos, rezultoi se nuk ka detyrime të prapambetura për periudhën objekt auditimi. Rezultojnë vetëm detyrimet periodike për muajin Dhjetor të secilit vit, të cilat rakordojnë me detyrimet afatshkurtra në Pasqyrat Financiare. Me fondet e vitit buxhetor 2020, janë likuiduar detyrimet për fatura të palikujduara nga vitet e mëparshme, brenda afateve të përcaktuara me ligj, me përjashtim të tre rasteve: një me listë pagesë ku mungonin referencat bankare dhe dy raste me referenca bankare të mbyllura. Të gjitha detyrimet janë likuiduar me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHR, likuidimet janë bërë sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA-në e periudhës përkatëse, në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2019 është paraqitur në **Pasqyrën B27**, në Anekset bashkëlidhur.

Analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2020 është paraqitur në **Pasqyrën B28**, në Anekset bashkëlidhur.

Analiza e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021 është paraqitur në **Pasqyrën B29**, në Anekset bashkëlidhur.

Nga të dhënat e pasqyrave të përmendura më sipër, konstatohet se, në fund të viteve 2019 dhe 2020, vlera e detyrimeve është vetëm për detyrimet e muajit dhjetor, të cilat janë likuiduar në muajin janar të vitit pasardhës, me përjashtim të tre rasteve për të cilat vonesa ka ardhur si rezultat të paraqitjes së referencave bankare të mbyllura nga operatorët.

Detyrimet e prapambetura janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar të dhënave të rubrikës ñ*Detyrimet e prapambetura*ò, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura është paraqitur në **Pasqyrën B30**, në Anekset bashkëlidhur.

- ***Faturat e palikuiduara***

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Patos, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitet 2019 dhe 2020 nuk ka raste të faturave të paraqitura me vonesë në Degën e Thesarit, ndërsa për vitin 2021 janë pa paguar gjithsej **18** fatura me vlerë totale 6,829,482 lekë, janë paraqitur në **Pasqyrën B31**, në Anekset bashkëlidhur.

Gjithashtu nga Bashkia Patos *(Drejtoria e Financë/Buxhetit)*, ka fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre. Kjo ka ndodhur për vitin 2021 ku janë paraqitur gjithsej **2** fatura me vlerë **20,824 mijë lekë**, të cilat i përkasin objektit ñ*Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të ujësjellësit të qytetit Patos, Loti I dhe II*ò,

të cilat financohen nga Ministria e Infrastrukturës, sipas paraqitjes në **Pasqyrën B32**, në Anekset bashkëlidhur.

- ***Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës dhe detyrimet kontraktuale:***

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, u konstatua se në fund të viteve 2019 dhe 2020 Bashkia Patos nuk ka detyrime që rrjedhin nga Vendimet gjyqësore. Gjatë vitit 2021 shoqëria BankersPetroleumLtd, i është drejtuar Bashkisë Patos me kërkesë për shlyerjen e detyrimit që rridhte nga Vendiminr. 265 datë 12.02.2020 i Gjykatës së Apelit. Midis Bashkisë Patos dhe shoqërisë Bankers është lidhur një akt-marrëveshje për pagesën e detyrimeve me këste për shumën 25,065,019 lekë dhe në marrëveshje është përcaktuar që ekzekutimi i detyrimit do të fillonte në vitin buxhetor 2022, për të cilën është marrë edhe Vendim i Këshillit të Bashkisë Patos nr. 22 datë 27.05.2021, sipas pasqyrës më poshtë:

Vendimet e Gjykatës ku Bashkia Patos është debitorë, janë paraqitur në **Pasqyrën B32**, në Anekset bashkëlidhur.

Bashkia Patos për detyrimin ndaj subjektit Fation dhe Liri Rizaj, ka shlyer 1/3 e shpenzimeve gjyqësore në vlerën 65,413 lekë, 1/3 e shpenzimeve përmbarimore në vlerën 48,541 lekë dhe 1/3 e shtesës së principalit në vlerën 135,509 lekë.

Ky detyrim ka rrjedhur si kundërshtim i VKM-së nr. 600, datë 18.10.2017 ñ*Për shpronësimin për interes publik përsa i përket vlerës së pasurisë së paluajtshme pronë private të paditësve Fation dhe Liri Rizaj*ò që preken nga realizimi i projektit ñ*Rikualifikimi Urban i Shëtitores Republika, Patos*ò. Ky projekt do të përballohej nga ñ*Fondi i Shpronësimeve*ò në Bankën e Shqipërisë. Bashkia Patos ka qenë vetëm përfituese e projektit.

Vendimet e Gjykatës ku Bashkia Patos është kreditore, janë paraqitur në **Pasqyrën B33**, në Anekset bashkëlidhur.

- ***Shpronësimet:***

Bashkia Patos, në cilësinë e subjektit në favor të të cilit bëhet shpronësimi për interes publik, për vitin 2020, konstatohet se ka njohur gjithsej 6 qytetarë për vlerën 3,593,866lekë, të cilët preken nga projekti ñ*Rikonstruksioni i rrugës "KoliMarku"*ò për të cilën ka dalë VKM nr. 634, datë 27.10.2021.Janë likuiduar 2 qytetarë, U.L dhe Arben e A. R për vlerën totale 1,896,716 mijë lekë. Katër qytetarëve të tjerë për të cilët është miratuar shpronësimi me VKM nr. 634, datë 27.10.2021nuk kanë paraqitur dokumentacion e duhur për të përfituar vlerën e shpronësimit.

Bashkia Patos *(Drejtoria e Financës dhe Buxhetit)*, nga ana e saj nuk ka informacion në lidhje me pagesat që janë kryer nga MEF ndaj qytetarëve përfitues të shpronësimeve që përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Nga dokumentacioni i paraqitur me shkresat nr. 637 prot., datë 11.11.2021 dhe nr. 1920/1 prot., datë 24.10.2017, nga Bashkia Patos, konstatohet se në 2 raste të miratuara me VKM nr. 634, datë 27.10.2021 dhe VKM 600 datë 18.10.2017 (shpronësimet për projektin ñ*Rikualifikimi Urban i shëtitores Republika*ò si dhe shpronësimet për projektin ñ*Rikonstruksioni i Rrugës "KoliMarku"*ò), është përcjellë në ASHK (ish-ZVRPP) Fier, për ndryshimin e pronësisë të parcelave dhe regjistrimin në pronësi të Bashkisë Patos (nga poseduesi përfitues i vlerës së shpronësuar tek Bashkia Patos), për të cilën ASHK është në proces.

Duke qenë se ASHK Fier nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë këto pasuri nuk kanë kaluar as si vlerë Aseti dhe më pas të kalonin në librat e llogarive përkatëse për rritjen e vlerës së Aseteve të kësaj bashkie *(pasqyrimi në kontabilitet dhe aktiv të pasqyrat financiare).*

2.5. <u>Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre</u>

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për periudhën 2019-

2021, në lidhje me investimet publike, u konstatua se:

- Bashkia Patos ka pasur gjithsej 2 projekte të financuara nga FSHZH, me vlerë kontrate 154,125 mijë lekë, ku për një projekt kontrata është lidhur në vitin 2018 me vlerë 68,160 mijë lekë dhe për projektin tjetër kontrata është lidhur në vitin 2019 me vlerë 85,965 mijë lekë. Financimi është mbuluar gjatë viteve 2018-2020. Të dy projektet kanëqenë Rikonstruksion të objekteve Arsimore me bashkëfinancim, ku vlera e bashkëfinancimit për të dy projektet shkon 15,879 mijë lekë.
- Nga Ministritë e linjës, janë 4 projekte me vlerë kontrate 1,282,826 mijë lekë dhe me vlerë kontrate të likujduar 330,981 mijë lekë, nga e cila kontrata e projektit me vlerë 16,233 mijë lekë është lidhur në vitin 2018 dhe është financuar në vitin 2018-2019. Ky projekt ka qenë me bashkëfinancim me vlerë 7,002 mijë lekë. Ministritë që financojnë këto projekte janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës (AKUM).

Për Projektin me vlerë 23,340 mijë lekë kontrata është lidhur në vitin 2020 dhe është financuar në vitin 2020-2021. 2 projekte e me vlerë kontrate 1,272,333 mijë lekë lidhur në vitin 2020, financuar pjesërisht në vitin 2020-2021, të cilat i përkasin ñ*Rikonstruksionit të magjistralit Kryesor të Ujësjellësit të Qytetit Patos Loti i I dhe II*ò, vazhdojnë të jenë në proces.

- Nga donacionet (Projekte të fituara nga konkurrimi me financimet e huaja) janë 2 projekte me vlerë kontrate 53,010 mijë lekë, nga të cilat një projekt me vlerë 28,510 mijë lekë financuar nga IADSA në vitin 2021, i cili do të vazhdojë të jetë në proces për vitin 2022 dhe një projekt me vlerë 24,500 mijë lekë financuar në vitin 2021 nga Ushtria Amerikanëe, i cili ka përfunduar dhe është në proces të marrjes në dorëzim nga Bashkia, është e ardhur në natyrë për Bashkinë pasi të gjitha procedurat janë bërë nga vetë donatori.
- Nga fondet e Bashkisë Patos dhe Grantet, janë financuar 26 projekte me vlerë kontrate 400,644 mijë lekë, nga të cilat: për vitin 2019 janë financuar 26 projekte me vlerë 185,957 mijë lekë, për vitin 2020 janë financuar 24 projekte me vlerë 104,347 mijë lekë, për vitin 2021 janë financuar 23 projekte me vlerë 110,340 mijë lekë.

Bashkia Patos në bazë të planifikimit të investimeve sipas buxheteve vjetore dhe buxheteve AFM ka realizuar në kohë kontratat e lidhura dhe ka zbatuar ligjin e prokurimeve ku asnjë prokurim nuk është kryer pa pasur likuiditete në Thesar.

Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Fier dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas planifikimit në PBA. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesat e tyre dhe në rastet kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

➢ ***Burimi i krijimit të ardhurave:***

<u>Për vitin 2019,</u> të ardhurat nga 203,746 mijë lekë janë arkëtuar në vlerën 216,894 mijë lekë ose 107%, me një diferencë prej 13,148 mijë lekë tejkalim.

<u>Për vitin 2020,</u> të ardhurat nga 218,869 mijë lekë janë arkëtuar në vlerën 234,207 mijë lekë ose 107%, me një diferencë prej 15,338 mijë lekë tejkalim.

<u>Për vitin 2021,</u> të ardhurat nga 274,201 mijë lekë janë arkëtuar në vlerën 266,847 mijë lekë ose 97%, me një diferencë prej 7,354 mijë lekë mosrealizim..

Me të ardhurat e veta në totalin e shpenzimeve, Bashkia mbulon 37% për vitin 2019, 41% për vitin 2020 dhe 39% për vitin 2021.

➢ ***Për zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020)***

<u>Për vitin 2019,</u> struktura dhe pagat e punonjësve janë miratuar me VKB nr. 80, datë 20.12.2018 ñ*Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe*

*Funksioneve të Deleguara - 2019"*dhe konfirmuar nga Prefekti Fier me shkresën nr. 2118/3/1 prot, datë 28.12.2018.

<u>Për vitin 2020,</u> struktura dhe pagat e punonjësve janë miratuar me VKB nr. 52, datë 18.12.2019 ñ*Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2020"*, konfirmuar nga Prefekti Fier me shkresën nr. 1929/1 prot, datë 23.12.2019.

<u>Për vitin 2021,</u> struktura dhe pagat e punonjësve janë miratuar me VKB nr. *51, datë 18.02.2020 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2021",*konfirmuar nga Prefekti Fier me shkresën nr. 136/1 prot, datë 11.02.2021.

Buxheti i pagave dhe sigurimeve shoqërore për periudhën e audituar është paraqitur në **Pasqyrën B34**, në Anekset bashkëlidhur.

Nuk u konstatua tejkalimi i numrit të punonjësve të miratuar me Vendim të KB, konstatuar kjo nga auditimi i listpagesave të periudhave janar-prill 2019, mars-qershor 2019, tetor-dhjetor 2019 dhe janar-prill 2020, nëntor-dhjetor 2020;

Të dhënat mbi largimet dhe emërimet e punonjësve nga puna janë paraqitur në **Pasqyrën B35**, në Anekset bashkëlidhur.

U konstatua se Aktet e emërimit në pozicione pune të punonjësve me status të Nëpunësit civil, janë në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 ñ*Për Statusin e Nëpunësit Civil*ò, i ndryshuar dhe Kreut II, IV dhe VI të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015.

Mbulimi me fonde i pagave të punonjësve sipas periudhave është paraqitur në **Pasqyrën B36**, në Anekset bashkëlidhur.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë në lekë është paraqitur në **Pasqyrën B37**, në Anekset bashkëlidhur, nga ku konstatohet se me fondet e veta Bashkia Patos mbulon 50% të fondit të pagave 2019,b53% për vitin 2020 dhe 52% për vitin 2021, ndërsa diferenca mbulohet me grandet e ardhura nga Pushteti Qendror.

2.6. <u>Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor</u>

- ***Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore***

Në Bashkinë Patos, për vitin 2019 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 80 datë 20.12.2018. për vitin 2020 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 83 datë 13.12.2019 dhe për vitin 2021, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 52 datë 18.12.2020. në këtë strukturë përfshihet edhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, e cila përbëhet nga 5 punonjës, konkretisht 1 drejtor, 1 përgjegjës, 2 specialistë dhe 1 punonjës tregu. Aktualisht, është vakanët pozicioni i përgjegjësit të sektorit, pasi përgjegjësi ka kaluar në pozicionin e drejtorit, pas daljes në pension të drejtorit paraardhës.

Krahas strukturës në bashki, në njësitë administrative ka nga një person të ngarkuar me vjeljen e taksave dhe tarifave të popullatës, ndërsa në Njësinë Administrative Zharëz ka dy punonjës tregu.

Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitet 2019, 2020 dhe 2021 është paraqitur në **Pasqyrën A1,** në Anekset bashkëlidhur.

- ***Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve***

<u>Titulli i gjetjes:</u>Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.

<u>Situata:</u> Për vitin 2019, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Patos është miratuar me VKB nr. 78, datë 20.12.2018, e konfirmuar nga Prefekti Fier me shkresën nr. 2118/3 datë 28.12.2018.

Nga të dhënat e **Pasqyrës A2,**në Anekset bashkëlidhur, shihet se për vitin 2019të ardhurat nga 203,746,000 lekë të planifikuara, janë realizuar 216,925,943 lekë ose 106%, për shkak të tejkalimit në zëra të veçantë si taksa e rentës, taksa e ndikimit në infrastrukturë, si dhe dhurata dhe sponsorizime të ndryshme.
Për vitin 2020, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 73, datë 26.11.2019, e konfirmuar nga Prefekti Fier me shkresën nr. 1824/1 datë 06.12.2019.
Nga të dhënat e **Pasqyrës A2**, shihet se për vitin 2020të ardhurat nga 220,578,000 lekë të planifikuara, janë realizuar 228,794,680 lekë ose 104%.
Për vitin 2020, ka pasur tejkalim të të ardhurave totale të planifikuara pasi kompania B.P.A LTD ka paguar në vitin 2020 detyrimet për taksat dhe tarifat vendore të dy viteve 2019 dhe 2020, kryesisht në zërin ñtarifë e ndotjes së mjedisitò.
Gjithashtu, ka pasur edhe të ardhura nga dhuratat dhe sponsorizimet si dhe nga sekuestrimet dhe zhdëmtimet.
Për vitin 2021, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr.47, datë 25.11.2020, e konfirmuar nga Prefekti Fier me shkresën nr. 1231/1, datë 09.12.2020.
Nga të dhënat e **Pasqyrës A2**, shihet se për vitin 2021 të ardhurat nga 274,201,000 lekë të planifikuara, janë realizuar 245,194,327 lekë ose 90%.
Për vitin 2021, ka pasur mos realizim në vlerën 29,006,673 lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit.
Nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave, rezultoi se faktorët kryesorë të mos realizimit janë: 1. Niveli ekonomiko-financiar i familjeve; 2. Emigrimi dhe migrimi; 3. Probleme të pronësisë; 4. Edukimi fiskal i komunitetit për pagesën e taksave dhe tarifave vendore. Komuniteti nuk është ndërgjegjësuar për pagesën me vullnet të lirë të detyrimeve vendore.
Për mosrealizimin gjatë viteve 2020 dhe 2021, një faktor i rëndësishëm për mos realizimin e zërave të të ardhurave si për popullatën, ashtu edhe për biznesin ishte pandemia Covid-19.
Për periudhën e audituar, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: znj. V.D, në cilësinë e specialistes të Degës së Thesarit Fier dhe znj. S.M, në cilësinë e specialistes së taksave në Bashkinë Patos.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Fier, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për periudhën e audituar është paraqitur i detajuar në **Pasqyrën A2,** në Anekset bashkëlidhur.
Referuar **Pasqyrës A2**, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
Në këtë konkekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të BashkisëPatos, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos, znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës, znj. A.L, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, aktualisht dalë në pension, z. A.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, znj. S.M, me detyrë specialiste në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore dhe z. E.A, me detyrë inspektor në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore,
Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e*

*Shqipërisë*ò i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 64, ñ*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë*ò; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ñ*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò i ndryshuar, neni 5, ñ*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*ò, neni 42, ñ*Administrimi i mjeteve monetare*ò, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, ñ*Raportimi financiar*ò nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV ñ*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*ò pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për Sistemin e Taksave Vendore*ò, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkaku kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Patos, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

- ***Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:***

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve dhe mosndjekja e mjaftueshme e detyrimeve të familjarëve nga struktura tatimore. Probleme me vjeljen e taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndërtesës e tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjarë.

Situata:Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhett të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Fier, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Patos dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Fier.

Në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, u konstatua se nga Bashkia Patos nuk është krijuar një bazë e dhënash e plotë dhe e saktë, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Patos, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit Fier.

Po kështu, edhe në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Patos nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.

Përsa i përket rakordimeve me agjentët tatimorë, u konstatua se:

1. Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet bëhet rakordim periodik i rregullt mujor me Degën e Doganës Vlorë dhe mbahet korespondencë me Ministrinë e Financave. Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Nga grupi i auditimit gjykohet se korrespondenca vetëm me një degë doganore nuk është e mjaftueshme, pasi eksporte mund të bëhen edhe nga degë të tjera, gjë që e bën të domosdoshëm bashkëpunimin dhe rakordimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
2. Për Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin ndiqet rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier.
3. Për Taksën vjetore të mjeteve të përdorura janë mbajtur rakordime me D.R.SH.T.RR. Fier në periudha të ndryshme brenda vitit.
4. Taksa e kalimit të pronësisë është derdhur për llogari të Bashkisë në kohë jo periodike.
5. Aktet e Rakordimit nuk janë mbajtur rregullisht, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 7 ñ*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*ò dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 15 ñ*Parapagimi*ò, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 ñ*Për taksat Kombëtare*ò.

Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Patos Sh.a., nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën A3,** në Anekset bashkëlidhur.

➢ ***Detyrimet e familjarëve:***

- *Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Tarifa e Pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të Bashkisë. Për këtë, nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore përdoren kontratat e popullatës për furnizimin me energji elektrike, sipas OSHE me përditësimet përkatëse.

Taksa e Ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Tarifa mirëmbajtje vaditje+kullim aplikohet vetëm në Njësinë Administrative Zharrëz. Parashikimi bëhet në bazë të sipërfaqes së tokës brenda zonës ku ofrohet ky shërbim.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Patos për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në dy Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.

Paketa Fiskale e Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nëpërmjet kryepleqve dhe pleqësive të fshatrave.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Bashkia Patos në të dy Njësitë Administrative dhe në Zyrën me një ndalesë ka sportel të Postës Shqiptare ku pranohen pagesat e detyrimeve vendore për familjarët dhe bizneset.

Me VKB nr. 5 datë 28.01.2021, Bashkia Patos ka miratuar pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të taksave dhe tarifave vendore. Ky vendim ka pasur si qëllim ndihmën për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për pagesën e menjëhershme të këtyre detyrimeve.
Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën A4,** në Anekset bashkëlidhur.
Planifikimi dhe realizimi i detyrimeve të familjarëve për taksat dhe tarifat vendoregjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën A5,** në Anekset bashkëlidhur.
Numri i familjarëve dhe vlera debitore për taksën e ndërtesës është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në **Pasqyrën A6,** në Anekset bashkëlidhur.
Numri i familjarëve dhe vlera debitore për tarifën e pastrimit është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në **Pasqyrën A7,** në Anekset bashkëlidhur.
Numri i familjarëve dhe vlera debitore për tarifën e shërbimit vaditje+kullim, është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në **Pasqyrën A8,** në anekset bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit. Plotësojin të gjitha këto raste.
Vlera prej **16,247,474 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës deri në datën 31.12.2021.
Vlera prej **25,922,986 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit deri në datën 31.12.2021.
Vlera prej **2,337,424 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i tarifës së shërbimit vaditje+kullimderi në datën 31.12.2021.
Nga auditimi, rezultoi se në total, vlera e të ardhurave të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve është **44,507,884 lekë**. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.

- ***Taksa e tokës:***

Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 ñ*Për tokën*ò, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 4,042 familje dhe 5,588 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 44 %. Nga 4,042 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 2,563 familje ose më shumë se gjysma janë debitore për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit.
Numri i familjeve përfituese dhe sipërfaqja e tokës të trajtuar sipas ligjit 7501, është paraqitur në **Pasqyrën A9,** në Anekset bashkëlidhur.
Planifikimi dhe realizimi i vjeljes së taksës së tokës për Bashkinë Patos dhe numri i familjeve debitore për vitet 2019-2021, është paraqitur në **Pasqyrën A10,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e debisë për taksën e tokës bujqësore në BashkinëPatos, është paraqitur e përmbledhur në **Pasqyrën A11,** në Anekset bashkëlidhur.
Parashikimi për të ardhurat e taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Patos bëhet në bazë të sipërfaqes së tokës bujqësore që kanë përfituar familjet në të tre Njësitë Administrative e ndarë sipas kategorive, duke i shtuar vlerën debitore deri në 18 muaj.
Nga auditimi rezultoi vlera totale debitore**40,491,275 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos, znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës, znj. A.L, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, aktualisht dalë në pension, z. A.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, znj. S.M, me detyrë specialiste në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore dhe z. E.A, me detyrë inspektor në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore,
Kriteri:ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 4

pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.

Ndikimi/Efekti: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave në **vlerën debitore prej 40,491,275 lekë,** nga mospagesa e taksës së tokës bujqësore, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e BashkisëPatos. Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në **vlerën debitore prej 44,507,884 lekë**, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore prej familjarëve, si e ardhur e munguar në buxhetin e BashkisëPatos.

Shkaku: Ka munguar përditësimi i të dhënave të regjistrave përkatës, niveli ekonomik i familjeve, mungesa e strategjive për vjeljen e detyrimeve nga administrata, mungesa e kontratës me UK sha si agjent tatimor, etj.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim 1: Bashkia Patos, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Patos, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj,) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Rekomandim 2: Bashkia Patos, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Për familjet fermeredebitore të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **40,491,275 lekë** dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

Rekomandim 3: Bashkia Patos, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Patos ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhett të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Rekomandim 4: Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitore prej **44,507,884 lekë**.

- ***Të ardhurat dhe vlerat debitore nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve të Bashkisë Patos:***

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga dhënia me qera e aseteve të Bashkisë, si troje, toka bujqësore, pyje e kullota.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore të BashkisëPatos u konstatua se për vitet 2019-2021 nga shfrytëzimi i hapësirave publike janë arkëtuar të ardhura nga 1 subjekt, sipas kontratave, konkretisht për vitet 2019 dhe 2020 ka qenë 7,200 lekë dhe për vitin 2021 ka qenë 22,500 lekë, vlera e të cilave është likuiduar.

Bashkia Patos ka të mbartura nga ish-komuna Ruzhdie 52 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore, të cilat janë lidhur në vitet 2009-2012. Detyrimi për pagesën e qerasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në Njësinë Administrative Ruzhdie. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëri gjatë vitit, pagesat e tokës me qera nuk janë bërë në mënyrë të rregullt duke rezultuar në një vlerë debitore në totalin **1,612,831 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Kontratat, pagesat dhe vlera e debisë deri në datën 31.12.2021 janë paraqitur në **Pasqyrën A13,** në Anekset bashkëlidhur.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos, znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës, znj. A.L, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, aktualisht dalë në pension, z. A.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, znj. S.M, me detyrë specialiste në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore dhe z. E.A, me detyrë inspektor në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore,
Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.
Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Patos në vlerën **1,612,831 lekë** (pa llogaritur kamatëvonesat).
Shkaku: Mosndjekja e procedurave nga strukturat përgjegjëse. Mangësi në përcaktimin specifik të detyrave dhe mungesë e personelit përgjegjës.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: BashkiaPatos të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (duke llogaritur kamatëvonesat) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,612,831 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

- ***Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:***

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.
Situata: Nga auditimi, u konstatua se deri në datën **31.12.2018,** janë dhënë 638 leje legalizimi debitore për sipërfaqen 136,173 m^2 ndërtim, me vlerë investimi 4,365,170,946 lekë, për një vlerë totale TNI (0.5%) prej **21,825,855 lekë**, nga e cila është vjelë 8,624,182 lekë.
Për vitin 2019, janë dhënë 689 leje legalizimi për sipërfaqen 135,655 m^2 ndërtim, me vlerë investimi 4,168,236,600 lekë, për një vlerë totale TNI (0.5%) prej**20,841,183 lekë**, nga e cila është vjelë shuma 5,647,456 lekë ose 27% e planifikimit.
Për vitin 2020, janë dhënë 159 leje legalizimi për sipërfaqen 31,545 m^2 ndërtim, me vlerë investimi prej 1,018,970,720 lekë, për një vlerë totale TNI (0.5%) prej **5,094,854 lekë**, nga e

cila është vjelë shuma 1,544,682 lekë ose 30% e planifikimit.
Për vitin 2021, janë dhënë 40 leje legalizimi për 9,194.3 m^2 ndërtim, me vlerë investimi prej 290,512,260 lekë, për një vlerë totale TNI (0.5%) prej **1,452,561 lekë**, e cila nuk është vjelë.
Numri i lejeve të legalizimit, sipërfaqja, vlera dhe shuma debitore e TNI deri në datën 31.12.2021 është paraqitur në aneksin **Pasqyrw nr. A14,** bashkëlidhur raportit twauditimit.
Debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë deri në datën 31.12.2021 janë paraqitur në **Pasqyrën A15,** në Anekset bashkëlidhur.
Konkluzion: Për periudhën objekt auditimi, janë dhënë 1,526 leje legalizimi për 312,567 m^2 sipërfaqe ndërtimi, me vlerë investimi prej 9,842,890,526 lekë. Shuma totale e TNI që duhetj vjelë për këtë vlerë investimi (0.5%) është 49,214,453 lekë. Personave të cilët janë paraqitur vullnetarisht në Bashkinë Patos për të bërë pagesën e taksës u është faturuar dhe vjelë vlera 15,816,320 lekë. Diferenca prej **33,398,133 lekë**, e cila nuk është shlyer nga 1,006 posedues të lejeve të legalizimit, për një sipërfaqeje prej 221,087 m^2, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos, znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës, znj. A.L, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, aktualisht dalë në pension, z. A.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, znj. S.M, me detyrë specialiste në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore dhe z. E.A, me detyrë inspektor në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore.
Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 9 dhe 27; VKB Patos ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Patos*ò, etj.
Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **33,398,133 lekë,** nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit nga përfituesite lejes së legalizimit.
Shkaku: Mos bashkëpunimi i fortë me ASHK-në dhe mosmarrja e masave të duhura për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Patos nga subjektet private dhe individët për objektet në proces legalizimi.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Patos nëpërmjet bashkëpunimit institucional tô kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Patos. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në **Pasqyrën A15,** bazuar në legjislacionin tatimor.

➢ ***Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:***
Për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike regjistri për taksat dhe tarifat vendore për subjektet private dhe familjarët, si më poshtë:
- Regjistri Elektronik për Bizneset në formatin Excel.
- Regjistri Elektronik për taksën e Tokës në formatin Excel.
- Regjistri Elektronik për Popullatën në formatin Excel.

Gjithashtu, regjistrat janë hartuar dhe funksionojnë edhe në formë manuale, konform me formatin përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.
Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Patos janë përmbledhur në **Pasqyrën A12,**në Anekset bashkëlidhur.

➢ ***Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.***

Titulli i gjetjes: Mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Patos.

Situata: Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të ardhurave vendore në Bashkinë Patos, rezultoi se ka 142 subjekte debitore nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesisi në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të vitit 2019 numri i debitorëve ishte 49 subjekte në vlerën prej 1,216,763 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ishte 142 subjekte në vlerën prej 3,984,802 lekë. Vlera progresive e taksave dhe tarifave vendore të papaguara deri në fund të vitit 2021 (përfshirë vlerën debitore para vitit 2019) është **11,346,600 lekë** (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba). Kjo vlerë përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Patos nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur vlera e gjobës (kamatëvonesës) në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 114 ñ*Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit*ò, pika 1

Vlera e debitorëve e paraqitur në vlerë detyrimi plus kamatëvonesën e përllogaritur dhe numrin e subjekteve, është paraqitur në **Pasqyrën A16,** në Anekset bashkëlidhur.

Numri i subjekteve dhe vlera (pa kamatëvonesa) e debisë gjendje në fund të viteve ushtrimore, e ndarë sipas njësive administrative është paraqitur në **Pasqyrën A17,** në Anekset bashkëlidhur.

Vlerat debitore të rezultuara sipas viteve ushtrimore, të ndara sipas llojeve të taksave (pa kamatëvonesa) për vitet 2019, 2020 dhe 2021 është paraqitur në **Pasqyrën A18,** në Anekset bashkëlidhur.

Për vitin 2019 janë bërë 211 bllokime të llogarive bankare, 211 vendosje e barrës hipotekore në ASHK, 211 vendosje e barrës së sigurisë në DRSHTRR Fier për subjektet debitore. Janë bërë 2 ekzekutime bankare për shlyerjen e detyrimit të dy subjekteve të cilët kishin gjendje në llogari.

Për vitin 2020 janë bërë 384 letër kujtese për subjektet që nuk kishin likujduar detyrimin tatimor, janë bërë 320 bllokime të llogarive bankare, 320 vendosje e barrës hipotekore në ASHK, 320 vendosje e barrës sigurie në DRSHTRR Fier për subjektet debitore .

Për vitin 2021 janë bërë 371 letër kujtese për subjektet që nuk kishin likujduar detyrimin tatimor, janë bërë 198 bllokime të llogarive bankare, 198 vendosje e barrës hipotekore në ASHK, 198 vendosje e barrës sigurie në DRSHTRR Fier për subjektet debitore .

Subjektet juridike debitore (Biznesi i madh) për Bashkinë Patos, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në **Pasqyrën A19,** në Anekset bashkëlidhur.

Subjektet debitore (Biznesi i vogël) për Bashkinë Patos, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në **Pasqyrën A20,** në Anekset bashkëlidhur.

Totali i vlerës debitore për Bashkinë Patos, i ndarë sipas llojit të bizneseve, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse është paraqitur në **Pasqyrën A21,** në Anekset bashkëlidhur.

Në Bashkinë Patos nuk ka institucione debitore për taksat dhe tarifat vendore.

Sa më sipër, nuk gjen zbatim ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, neni 89 ñ*Njoftimi dhe kërkesa për të paguar*ò.

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të Bashkisë Patos, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat

tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, neni 93 dhe 94.
Gjithashtu nga strukturat tatimore të Bashkisë Patos, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, ñ*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*ò, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., si dhe neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos, znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës, znj. A.L, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, aktualisht dalë në pension, z. A.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, znj. S.M, me detyrë specialiste në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore dhe z. E.A, me detyrë inspektor në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore.
Kriteri:Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.
Ndikimi/Efekti: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme. Efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Patos.
Shkaku: Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej **11,346,600lekë** (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba,) *(sipas **PasqyraveA16**, **A17** dhe **A18** në Anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit)*, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:
***a. T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.**
b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme.
c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të BashkisëPatos, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

➢ ***Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:***

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Patos.

Situata: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Patos ushtrojnë aktivitetin 11 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka.

Duke qenë se lëshimi i autorizimit për tregtimin e hidrokarbureve në Bashkinë Patos nuk bëhet nga Drejtoria e të ardhurave, drejtoria e të ardhurave nuk ka informacion të plotë për subjektet të cilat kanë shlyer detyrimet.

Subjektet për të cilat nuk ka informacion në Bashkinë Patos në lidhje me pagesat e kryera, do të konsiderohen debitorë dhe vlera e papaguar për pajisjen me autorizime do të konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.

Për subjektin E.Shpk, me NUIS L.....H, pavarësisht se ka sekuestro konservative për asetet, qëllimi i sekuestros është ndalimi i shitjes së aseteve, statusi në QKB është ñAktivò dhe duhett të pajiset me licencë për tregtimin e hidrokarbureve, duke plotësuar dokumentacionin dhe likuiduar detyrimet përkatëse.

Për subjektin G.Shpk, me NUIS L.....A, licenca e të cilit ka përfunduar në datën 21.09.2020 dhe për periudhën e mëparshme është debitor në vlerën 900,000 lekë, është llogaritur e gjithë vlera e papaguar, për të cilën ky subjekt është debitor.

Për subjektin B-Oil Sha Zharëz, me NUIS K.....H, është licencuar për tregtimin me shumicë të hidrokarbureve dhe nuk është subjekt i licencimit nga pushteti vendor.

Pagesat e kryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitore për subjektet e pajisura me autorizime për tregtimin e hidrokarbureve janë paraqitur në **Pasqyrën A22,** në Anekset bashkëlidhur.

Vlera prej **5,550,000 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e znj. R.B, me funksion Kryetare e Bashkisë Patos, znj. M.SH, me funksion Drejtore e Financës, znj. A.L, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, aktualisht dalë në pension, z. A.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, znj. S.M, me detyrë specialiste në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore dhe z. E.A, me detyrë inspektor në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore.

Kriteri: Kjo procedurë është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në **vlerën 5,550,000 lekë** nga mospagesa e tarifës së plotë apo të një pjese të tarifës së liçencës/autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të hidrokarbureve pa rinovuar liçencën e tregtimit.

Shkaku: Mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga Bashkia Patos, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikanëte dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **5,550,000 lekë,** sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, **Pasqyra A22**. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit

në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

3. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020 dhe 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme'', ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022.

➢ ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***
Për vitin 2020 dhe 2021 nga njësia shpenzuese ñ**Bashkia Patos**ò për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Fier si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

➢ ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***
Për vitin 2020 dhe 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

➢ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***
Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program ñ***Excel***ò
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna per shkakun e veprimit, datën dhe

vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat qe kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu; dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➢ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar për vitin 2020 dhe vitin 2021.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhett të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar dhe të analizuar përsa i përket aseteve e ish-Komunave. Ndërsa detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhett të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në**

terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2020-2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;
Totali i Aktivit për vitin 2021 është **1,366,998,293 lekë** dhe për vitin 2020 është **1,136,964,885 lekë,** i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas **Aneksit nr. 1 pika 3** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit, si në vijim.

A.Aktivet.
Për vitin 2020 dhe 2021
Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.
Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; ***llogaria 520*** ñ*Disponibilitete në Thesar"*, në pasqyrat financiare është në vlerën **200,999,763 lekë** për vitin 2020 dhe në vlerën **268,943,196lekë**. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Fier, kjo llogari është e analizuar sipas tabelës vijuese.
Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2020	2021
1	Llogaria 520 ñDisponibilitete në thesarò	200,999,763	268,943,196
2	Llogaria 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò	28,878,323	30,392,300
3	Llogaria 85 òRezultati i veprimtarisë së ushtrimitò	172,121,440	238,550,896

- Llogaria 520 ñ*Disponibilitete në Thesar"* është e rakorduar ***me të dhënat*** e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, duke pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor në vlerën 200,999,763 **lekë** për vitin 2020 dhe në vlerën **268,943,196lekë për vitin 2021,*në përputhje*** *me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.*

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë **31 "Materiale",** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,236,649 lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 1,770,607 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.
-Gjendja e llogarisë **32 "Inventar i imët"** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 20,674,975 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 22,950,536 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

3.Nënrubrika, llogari të arkëtueshme,-Gjendja e llogarisë **468 "Debitorë të ndryshëm**ò në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 14,297,594 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 14,298,576 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj Bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021. Në mënyrë analitike paraqitet në aneksi nr.2, pika 3 bashklidhurProjektraportit të auditimit.

Titulli gjetjes: Mos kontabilizimi i vlerës debitoretë subjekteve private dhe familiar, për mos pagimin e taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej **136,906,723** lekë

Situata:

Llogaria **468 "Debitorë të ndryshëm"** për vitin 2020 paraqitet në vlerën **14,297,594lekë** dhe me 31.12.2021 paraqitet në vlerën **14,298,576 lekë** e cila përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Sektorit i të ardhurave dhe tarifat vendore dhe ñDrejtoria e Financësò nuk kanë koordinuar punën ndërmjet tyre mbi pasqyrimin e gjendjsdebitore të subjekteve taksapagues privat dhe familjar, në vlerën **136,906,723lekë** gjendje 31.12.2021. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò në vlerën **136,906,723 lekë**. *Në mënyrë të detajuar paraqitet në akt konstatimin nr. 1 datë 25.0.2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, aneksi 1, pika 3.3, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 "Të ardhurat", pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.*

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi;

1. z. A.M, me pozicion ish përgjegjës sektori, aktualisht Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, në Bashkinë Patos;

2. znj. M.SH, me pozicion Drejtore e Drejtorisë së Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues (NZ).

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

Ligjin 10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò,Urdhri nr.64 datë 22.07.2014 ñ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 ñTë ardhuratò, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës UMF nr. 08, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò, kapitulli II, pika 6.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitet 2020-2021 të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò si dhe nuk janë pasqyruar debitorët e subjekteve private dhe tarifave vendore në vlerën prej **136,906,723 lekë**

Shkaku:

Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore për vitet 2020 - 2021 në vlerën **136,906,723 lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.
- Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

II. Rubrika, aktivet afatgjata.

1.Nënrubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llogarisë **202 "Studime dhe kërkime",** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 359,386 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën

neto 305,478 lekë, (836,000 ï 530,522) = 305,478 me diferencë në ulje në vlerën 53,908 lekë e cila përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur për vitin 2021. Kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr 3 pika 3 për projektet, ñStudimet e kërkime dhe vlerat përkatëseò, gjendje më 31.12.2021.

2.Nënrubrika, aktive afatgjata materiale,

-Gjendja e llogarisë **210 "Toka, Troje, Terrene"** në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën neto 3,486,492 lekë, në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën neto 3,321,167 lekë (4,220,846 - 908,679). Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas aneksi nr. 4, pika 3, ñToka, Troje, Terreneò, Pasqyrat Financiare, viti 2021 bashklidhurProjektraportit.

-Gjendja në llogarinë **212 "Ndërtime e konstruksione"** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën neto 546,652,775 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 547,911,628 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Në mënyrë të detajuar llog212 ñNdërtime e konstruksioneò është analizuar sipas aneksi nr.5, pika 3, bashklidhurProjektraportit.

-Gjendja në llogarinë **213 "Rrugë, rrjete vepra ujore"** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën neto 84,516,725 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 80,290,890 lekë (93,442,926 ï 13,152,036), e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Në mënyrë të detajuar llog**213 "Rrugë, rrjete vepra ujore"** është analizuar sipas aneksi nr.6, pika 3, bashkëlidhur Projektraportit.

-Gjendja e llogarisë **214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën neto 5,782,877 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 7,415,385 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe paksimet nga amortizimi. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të detajuar është analizuar sipas inventarit fizik.

-Gjendja e llogarisë **215 "Mjete transporti"** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën neto 9,510,308 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 3,787,446 lekë. Në mënyrë të detajuar llog**215 "Mjete transporti"** është analizuar sipas aneksi nr.7, pika 3, bashkëlidhur Projektraportit.

-Gjendja e llogarisë **218 "Inventar ekonomik",** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën neto 46,991,944 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 40,529,442 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe paksime gjatë vitit 2021, sipas listës analitike të sektorit të financës.

Për vitin 2021 gjendja e llogarisë **219 "Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara",** amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b(gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatim mbi të ardhuratò, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019ò Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò i ndryshuar. *Më hollësisht trajtuar në aneks nr. 8 pika*

3 bashkëlidhur Projektraportit.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 ñHuadhënie e nën huadhënieò dhe 6 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetëò, më 31.12.2020 dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Titulli i gjetjes: Mos kontabilizimi i vlerës monetare 14,530,000 lekë, në llogarinë 26 ñAktive afatgjata financiareò si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Patos SHA me NUIS ñJ.....Bò

Situata: Për vitet 2020 dhe 2021 rezultoi se**:** Bashkia Patos, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Patos SHA me NUIS ñJ.....Bò e cila është shoqëri aksionare me objekt ñShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreò. Shoqëria duhett të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqiò. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 14,530 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 14,530,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalitme 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Patos në ñUjësjellës Kanalizime Patos SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.*Përsa me sipër, ngarkohet me përgjegjësi: znj.* XH.GJ*, në cilësinë e Përgjegjëses së Kontabilitetit për periudhën 2020-2021.*

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 ñ*Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabiliteti të Përimtuar*ò, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 ñ*Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*ò, pika 55, 56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2020 dhe 2021, të llog 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò, çka ka sjell një nënvlerësuar të llog 26 në vlerën 14,530,000 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia:*I lartë*

Rekomandimi:Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ñUjësjellës Kanalizime Patos Sh.a me vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

4.Nënrubrika, investime.

-Gjendja e llogarisë **231 "Për aktive afatgjata materiale"** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 186,227,456 lekë, në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 336,104,052 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ñAktive afat gjata materialeò. *Në mënyrë të detajuar llog231 "Për aktive afatgjata materiale" është analizuar sipas aneksi nr.9, pika 3, bashkëlidhur Projektraportit.*

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 ñFurnitorë dhe llogari te lidhura me toò , të 42 ñPersoneli e llogari të lidhura me toò, -të 431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim-taksaò, të 435 ñDetyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreò, të 436 ñDetyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreò, janë të barabarta me gjendjen e llogarisë 4342 ñOperacione me shtetinò në vlerën 16,227,939 lekë për vitin 2020 dhe në vlerën 39,379,075 lekë për vitin 2021 të analizuara me vlerat e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2020	Gjendje 31.12.2021
1	Paga Personeli llogaria 42	7,066,658	8,998,929
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	548,172	576,789
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,656,022	2,697,661
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	362,006	368,319
5	Furnitorëllogaria.401-408	4,386,277	25,344,587
6	Kreditore të ndryshëm	1,208,804	1,392,790
	TOTALI	16,227,939	39,379,075

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 "Operacione me shtetin, të drejta" dhe vlerës të pasqyruara në 6 (gjashtë) llogarive pasive,** pra në vitin 2020 dhe 2021, është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja e llogarisë 401-408 **"Furnitorë e llogari të lidhura me to"**, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 4,386,277 lekë dhe në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 25,344,587 lekë për 19 subjekte e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor të likuidimin të detyrimeve në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*ò, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.05.2022, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20.*Në mënyrë të detajuar llog*401-408 *"Furnitorë e llogari të lidhura me to",është analizuar sipas aneksi nr.10, pika 3, bashkëlidhur Projektraportit.*

Titulli gjetjes:*Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje".*

Situata:

Llogaria 466 **"Kreditorë për mjete në ruajtje",** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 28,878,324 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,392,300 lekë, për 41 subjekte të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.Gjatë vitit 2021 shesta janë në vlerën 10,775,298 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 9,261,321 lekë për 12 subjekte. Nga analiza e kësaj llogarie,konstatohet se:

a) Për 26 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 4,186,584 lekë, *sipas aneksit nr.11, pika 3,* nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interespublik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50.

Pika 30."Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera,konformë kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet",

Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhett të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhett të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet)",
UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.
Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, Kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.
Më hollësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 5, datë 25.02.2022 si dhe në pikën 3, faqe 64-78 të Projektraportit të Auditimit

Kriteri:
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: *UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 Kap. III, pikat 30, 50.*
Ndikimi/Efekti:
Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò
Shkaku:
Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar*
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi:
- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 ñ*Kreditore për mjete nën ruajtje*ò, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

-Testimi i llogarisë 600 "Pagat dhe shpërblime"
Për vitin 2019 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 80 datë 20.12.2018. Miratuar në total numri 211 punonjës gjithsej + 5 punonjës Gjendjes Civile gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 204 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.
Për vitin 2020 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 83 datë 13.12.2020. Miratuar në total numri 223 + 5 punonjës Gjendjes Civile gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 219 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.
Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiakë nr.52 datë 18.12.2020. Miratuar në total numri 224 + 5 punonjësit të Gjendjes Civile gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 217 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos, është miratuar me Urdhër të Kryetares të Bashkisë; për vitin 2019 nr.40 datë 04.01.2019, për vitin 2020 nr.3481 datë 24.12.2019 ,si dhe për vitin 2021 nr.1 datë 06.01.2021.
Sipas listë pagesave të muajve Janar 2019, Shkurt 2020 dhe Gusht 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.
Listë pagesat janë të firmosura nga Specialiste e pagave, Drejtoresha e Financës, dhe Kryetare e Bashkisë.

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2019- 31.12.2021.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Mars-Tetor 2019, Shtator-Dhjetor 2020 dhe Prill-Shtator 2021) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga Titullari i Bashkisë. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,ò Kodi i Punësò, i ndryshuar.
Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Patos, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSHò.
-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos, është miratuar me Urdhër të Kryetares të Bashkisë të sipërcituara.
Sipas listë pagesave të muajve (Mars-Tetor 2019, Shtator-Dhjetor 2020 dhe Prill-Shtator 2021) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.
Listë pagesat janë të firmosura nga Specialiste e pagave znjA.H, Drejtoresha e Financës znj. M.SH dhe Kryetare e Bashkisë znj. R.B.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Specialiste e pagave znj. A.H, Drejtoresha e Financës znj. M.SH dhe Kryetare e Bashkisë znj. R.B.
Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtoresha e Burimeve Njerëzoreznj. J. S. dhe nga Kryetare e Bashkisë znj. R.B.
Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, në Bashkinë Patos nuk është bërë asnjë ndalesë tjetër.
Paraqitja në formë tabele e burimit të Financimit.

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transfertë specifike
Viti 2019	133,136	122,568	92	53,417	7,890	4,809	56,451
Viti 2020	140,243	127,276	90	32,696	35,024	3,391	56,164
Viti 2021	148,734	133,849	89	38,784	31,404	5,260	58,399

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë

000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2019			VITI 2020	Viti 31/12/2021				
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	133,136	122,568	92	140,243	127,276	90	148,734	133,849	89
2	F. Sig. Shoq	21,378	19,241	90	22,574	20,737,241	91	24,768,275	21,353	86
3	F. Veçantë	3,311	2,770	83	1,860	343	18	3,339	1,919	57

<u>*Saktësia e plotësimit të Urdhër shpenzimeve.</u>

Për vitin 2019, u audituan urdhër shpenzimet e muajit Tetor nga nr. 413 deri te urdhër shpenzimi nr. 460. **Për vitin 2020**, u audituan urdhër shpenzimet e muajit Mars nga nr. 90 deri te urdhër shpenzimi nr. 129. **Për vitin 2021**, u audituan urdhër shpenzimet e muajit Prill nga nr. 122 deri te urdhër shpenzimi nr. 179 dhe për muajin Nëntor nga nr. 514 deri te urdhër shpenzimi nr. 546. Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues.

Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet janë konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe janë likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

*Për rastet e likuidimit të punimeve të ndërtimit, urdhër shpenzimet kanë të bashkëlidhur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhri për ngritjen e KVO-së, formulari njoftim fituesi, buletini i APP për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate, kontrata e lidhur midis palëve, situacioni i punimeve të kryera, fatura e tvsh së subjektit përfitues, certifikata e përkohshme ose përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve, akt kolaudimi përfundimtar.

*Për rastet e blerjeve të materialeve të ndryshme, urdhër shpenzimet kanë të bashkëlidhur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhër për ngritjen e KVO-së, fotokopje e buletinit të APP për njoftim fituesi dhe njoftim për lidhje kontrate, fotokopje e kontratës së lidhur midis palëve, fatura e subjektit përfitues, proces verbali i marrjes në dorëzim dhe numri i fletë hyrje e magazinës.

*Për rastet e likuidimeve të shërbimeve e konkretisht të shërbimit të pastrimit të qytetit, të shërbimit të gjelbërimit, të shërbimit të varrezave të qytetit, të shërbimit të trotuareve, urdhër shpenzimet kanë të bashkëlidhur dokumentet si Situacioni i punimeve të kryera në fakt, fatura e tvsh së subjektit përfitues, kontrata e lidhur midis Bashkisë dhe Subjektit, proces verbali i marrjes në dorëzim të punimeve e shërbimeve.

Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhett të ishin regjistruar janë regjistruar. Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme. Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël dhe janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

<u>Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Patos</u>

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: për vitin 2020 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 83 datë 18.12.2019, për vitin 2021 struktura organizative është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 52 datë 18.12.2020. Rreferuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Rezulton se në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Patos nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, por është caktuar një specialist në Drejtorinë e Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban si dhe me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë ñPër krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patosò janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.).

<u>Bashkisë Patos</u>, me VKM nr. 443, datë 15.06.2016 ñPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Patos, të Qarkut Fierò, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 300.

Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë ñPër krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patosò grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësive Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 100 (njëqind) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 1700 (njëmijë e shtatëqind) miratuar me VKB nr. 52, datë 04.11.2021, dërguar ASHK ï së Fier me shkresën nr.2881 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Ish Komunës Rruzhdie, sot Njësia Administrative Rruzhdie me VKM nr. 432, datë 15.05.2013 ñPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Zharëz, të Qarkut Fierò, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 865. Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë ñPër krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patosò grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësive Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 54 (pesëdhjetë e katër) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 902 (nëntëqind e dy) miratuar me VKB nr. 50, datë 04.11.2021, dërguar ASHK ï së Fier me shkresën nr.2883 prot datë 08.11.2021për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Ish Komunës Zharrëz sot Njësia Administrative Zharrëz e Bashkisë Patos, me VKM nr. 558, datë 27.07.2016 ñPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësia Administrative Zharrëzò, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 178. Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë ñPër krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patosò grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshmeshtetrore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësive Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 20 (njëzetë) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 201 (dyqind e një), miratuar me VKB nr. 51, datë 04.11.2021, dërguar ASHK ï së Fier me shkresën nr.2882 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Përsa sa më sipër Bashkia Patos ka krijuar regjistrin e aseteve por nuk i ka regjistruar në kontabilitet pasi me shkresat e sipërcituara janë dërguar në (ASHK), për vazhdimin e procedurave të mëtejshme mbështetur në nenin 8, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 ñPër pronat e paluajtshme të shtetitò, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetëroreò, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendoreò, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 ñPër mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publikeò

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si vijon:

Nr.	Bashkia/ Njësite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2019	Nr. Praktikave te Certifikuara 2019-2021	Prona te pa Rregjistruara
1	Zharrëz	178	0	2	176
2	Patos	300	0	15	285
3	Ruzhdie	865	0	1	864 *

Numri i pronave sipas iventarizimit fizik dhe të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të dërguara në ASHK, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin përfundimtar dhe çertifikimin e tyre.					
1	Zharrëz	201			Në Proces
2	Patos	1700			Në Proces
3	Ruzhdie	902			Në Proces

<u>Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Patos të kaluara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyje dhe kullota publike ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020.</u>

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se në zbatim të ligjit Nr.9385 datë 04.05.2005 ñPër Pyjet dhe Shërbimin Pyjorò, ligjit Nr.111/2018 ñPër Kadastrënò dhe VKM Nr.433 datë 08.06.2016, Ministria Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit dhe kompanisë së kontraktuar C-Pi & D, me mbështetjen e Bankës Botërore, Qeverisë Suedeze dhe Fondit për Mjedis Global, filloi ñRegjistrimin Fillestar të Pasurive të Tipit Pyje dhe Kullotaò në pronësi/administrim të Bashkisë Patos.
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit me shkresën nr. 11423 prot. date 30.12.2019 ka njoftuar Bashkinë Patos mbi ñProcesin e regjistrimit fillestar të pasurive të tipit Pyje dhe Kullotaò, në pronësi të Bashkisë Patos. Në vijim të korrespondencës Bashkia Patos me shkresën nr.12/3 prot. datë 28.02.2020 i dërgoi informacion Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, mbi procesin e ñRegjistrimit fillestar të pasurive të Tipit Pyje dhe Kullotaò në pronësi të saj, bashkëlidhur vendimin e Këshillit Bashkiak nr.4 datë 04.02.2020 si dhe listën e inventarit të pasurive Pyje dhe Kullota e cila fillon me numër rendor 1-42 faqe 2, konfirmuar me shkresën nr.188/1 prot. datë 14.02.2020 të Prefektit të Qarkut Fier mbi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Patos.
Me shkresën nr. 5 prot. datë 25.08.2020, kompania C.P&D i është drejtuar Bashkisë Patos, DrejtorisëVendore të ASHK Fier për takim konsultativ dhe diskutim mbi kufijtë Kadastral në të cilat po kryhet Regjistrimi Fillestar i Pyjeve dhe Kullotave në emër të Bashkisë Patos dhe me shkresën nr.37 prot. datë 15.12.2020 i është drejtuar Bashkisë Patos, për dijeni Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit mbi ñRegjistrimin Fillestar të Pyjeve dhe Kullotaveò të transferuara në pronësi të Bashkisë Patos me anë të VKM Nr.684 datë 02.09.2020.
Ministria Turizmit dhe Mjedisit me shkresë nr.5710 prot. datë 10.08.2021 i drejtohet Bashkisë Patos për të përshpejtuar miratimin e produktit përfundimtar të regjistrimit të pasurive Pyje dhe Kullota në administrim/pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, nëpërmjet Drejtorisë Vendore ASHK Fier. Bashkia Patos me shkresën nr.2048/1 prot. datë 13.08.2021 i drejtohet Drejtorisë Vendore ASHK Fier për të përshpejtuar regjistrimin. Për këtë u njoftua Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2048/3 prot. datë 26.08.2021.
Bashkia Patos me shkresë nr. 391 datë 03.02.2022 ka kërkuar informacion A. B. O. C. P.&D., Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorisë Vendore të ASHK Fier se në çfare faze është procesi dhe kur do të filloj certifikimi i pronave Pyje dhe Kullota. Përgjigja e Drejtorisë Vendore të ASHK Fier.
Për sa argumentuam me lartë Bashkia Patos është në proces regjistrimi të pronave të kaluara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyje dhe kullota publike ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020.

<u>Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale; Jo materiale dhe Qarkulluese, sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shtesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur, për periudhën ushtrimore raportuese 2019, 2020 dhe 2021</u>

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin e pasqyrat financiareò, pika (1), neni (7) ñInventari aktiveve e detyrimeveò; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu (IV) ñSistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveveò pika (81) dhe UMF nr. 28, datë 15.12.2011 ñMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit te kontrollit te brendshëm në njësite publikeò, në njësinë publike vendore Bashkia Patos u auditua procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë të administruara në llogaritë; ñ*aktive afatshkurtër*ò; ñ*gjendje inventar qarkullues*ò; ñ*materiale*ò; ñ*inventar i imët*ò; ñ*Aktive afatgjata jo materiale*ò dhe ñ*Aktive afatgjata materiale*ò.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhat raportuese objekt auditimi (*2019-2021*), u konstatua se, për realizimin e procesit të inventarizimit fizik të ñ*aktiveve afatgjata dhe afatshkurtër*ò (*materiale e jo materiale*) dhe ñ*inventar qarkullues*ò të pasurisë, Aseteve dhe vlerave materiale në përdorim të njësisë publike vendore Bashkia Patos për periudhën raportuese ushtrimore 2019, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 56, datë 22.10.2019 ñ*Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Patos*ò me përbërje; z. R. B. në cilësinë e kryetarit, z. V. N. në cilësinë e anëtarit, znjI.Sh në cilësinë e anëtarit, z. A.S në cilësinë e anëtarit, z. L.C në cilësinë e anëtarit, znj S.T në cilësinë e anëtarit si dhe znj. E .Q në cilësinë e anëtarit. Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur vetëm një relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik duke evidentuar materiale të dëmtuara respektivisht:

- Llogaria 214 ñInstalime teknike, makineri e pajisjeò të dala jashtë përdorimit në vlerën 38,600 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218 ñInventar Ekonomikò të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,951,398 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218/1 ñInventar Ekonomik, pajisje informatikeò të dala jashtë përdorimit në vlerën 2,117,238 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 327/1 ñInventar i Imëtò të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,951,398 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- - Llogaria 312/3 ñNdërtesa dhe konstruksione, Inventar magazina 312/3ò të dala jashtë përdorimit në vlerën 36,589 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).

Në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të institucionit, konstatohet se janë ndjekur procedurat sa më poshtë vijon:

Urdhri 56 datë 22.10.2019	Kryetari ka ngritur Komisionin e vlerësimit të Aktiveve të Bashkisë Patos
Shkresa nr. 3450/3 prot datë 30.12.2019.	Relacion shoqërues i inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve të inventarizimit të Aseteve të Bashkisë Patos + Njësit Administrative Zharëz dhe Rruzhdie.
Datë 05.12.2019	Procesverbalet e inventarizimit dhe vlerësimit
Shkresa nr. 3450/3 prot datë 30.12.2019.	Informacion Këshillit Bashkiak mbi nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve të inventarit viti 2019.
Vendimi nr. 1 datë 20.01.2020	Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit viti 2019
Shkresa 3450/7 prot datë 06.02.2020	Informacion për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të imta.
Urdhri nr. 18 datë 26.05.2020	Për ngritjen e komisionit të Asgjesimit

Referuar të dhënave të inventarëve në fund të vitit 2019 dhe pasqyrave financiare dërguar në Degën e Thesarit Fier nga ku u konstatua se gjendja kontabël përputhet me gjendjen fizike në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i

ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin e pasqyrat financiareò, pika (1), neni (7) ñInventari aktiveve e detyrimeveò; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò,

Bashkia Patos për periudhën raportuese ushtrimore 2020, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 2718/1 datë 29.10.2020 ñ*Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Patos dhe njësive Administrative Rruzhdie dhe Zharëz*ò Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik duke evidentuar materiale të dëmtuara respektivisht:
- Llogaria 214 ñInstalime teknike, makineri e pajisjeò të dala jashtë përdorimit në vlerën 39,200 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218 ñInventar Ekonomikò të dala jashtë përdorimit në vlerën 8,808,598 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218/1 ñInventar Ekonomik, pajisje informatikeò të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,343,940 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 327/1 ñInventar i Imëtò të dala jashtë përdorimit në vlerën 3,871,882 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- - Llogaria 312/3 ñNdërtesa dhe konstruksione, Inventar magazina 312/3ò të dala jashtë përdorimit në vlerën 81,615 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
Në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të institucionit, konstatohet se janë ndjekur procedurat sa më poshtë vijon:

Urdhri 2718/1 datë 29.10.2020	Kryetari ka ngritur Komisionin e vlerësimit të Aktiveve të Bashkisë Patos
Shkresa nr. 662 prot datë 26.02.2021.	Relacion shoqërues i inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve të inventarizimit të Aseteve të Bashkisë Patos + Njësit Administrative Zharëz dhe Rruzhdie.
Shkresa nr. 831 prot datë 19.03.2021.	Informacion Këshillit Bashkiak mbi nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve të inventarit viti 2020.
Vendimi nr. 31 datë 26.02.2021	Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit viti 2020
Urdhri nr. 35 datë 10.05.2021	Për ngritjen e komisionit të Asgjësimit
Shkresa 1206/3 prot datë 02.09.2021	Relacion shoqërues Këshillit Bashkiak për vlerësimit dhe asgjësimit të materialeve të inventarit të Bashkisë Patos dhe Njësive Administrative Rruzhdie dhe Zharëz.
Shkresa nr. 1206/6 prot datë 02.09.2021	Procesverbal i materialeve të skrapit nga inventarët për vitin 2020
Fatura nr. 476 datë 28.10.2021	Materialet metalike shitur për skrap

Referuar të dhënave të inventarëve në fund të vitit 2020 dhe pasqyrave financiare dërguar në Degën e Thesarit Fier me shkresën nr. 237/3 prot datë 19.03.2021 u konstatua se gjendja kontabël përputhet me gjendjen fizike në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin e pasqyrat financiareò, pika (1), neni (7) ñInventari aktiveve e detyrimeveò; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò,
Bashkia Patos për periudhën raportuese ushtrimore 2021, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 131 datë 21.10.2020 ñ*Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Patos dhe njësive Administrative Rruzhdie dhe Zharëz*ò dhe me Urdhrin nr. 132 datë 21.10.2021 është krijuar ñKomisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e aseteveò Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e

kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik duke evidentuar materiale të dëmtuara respektivisht:
- Llogaria 214 ñInstalime teknike, makineri e pajisjeò të dala jashtë përdorimit në vlerën 100,900 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218 ñInventar Ekonomikò të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,072,653 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218/1 ñInventar Ekonomik, pajisje informatikeò të dala jashtë përdorimit në vlerën 695,250 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 327/1 ñInventar i Imëtò të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,368,542 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).

Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.
Bashkia Patos për vitet 2020 ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për ti dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare konfirmuar me shkresën nr 1374 prot datë 28.05.021 dërguar MFE, ndërsa për vitin 2021 pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë janë brenda afatit ligjor. **Në vartësi të Bashkisë Patos janë katër Njësi vartëse.** Pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën e viteve 2020, të Njësive ekonomike në vartësi të Bashkisë Patos, janë dorëzuar në degën e thesarit Fier, Veprimet janë në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollitò; neni 9,pika 4, germa ñdò, neni 12 pika 2. germa ñbò Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollitò, neni 9, pika 4, germa ñdò dhe neni 12, pika 2, germa ñbò. UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, kapitulli II, pikat 98; 99; 100; 101, germa ñbò, pika 118.

- **Pika nr. 4 e programit të Auditimit: Të ndryshne të dala gjatë auditimit**

Ankesa nr.1Objekti i këtij verifikimi është:-Shkresa nr. 850/1, datë 30.10.2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit i është drejtuar Bashkisë Patos, për trajtimin e ankese nga ankuesi z. K.X., duke sugjeruar që Njësia e Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Patos, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga titullari i Bashkisë, të verifikojë problematikën për të cilën pretendon zgjidhje ankimuesi z. K. X.
- Ankesa e administruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit, me nr. 126 prot., datë 22.01.2021, jemi rivënë në dijeni nga qytetari K.Xh, lidhur me mosveprimin e Njësisë Administrative Zharrëz, Bashkia Patos, në drejtim të mos trajtimit të kërkesës dhe mos kthimit të përgjigjes qytetarit mbi problematikën e drejtuar prej tij.

Nga auditimi u konstatua se: Me urdhrin nr. 63 datë 14.11.2019 të Kryetares së Bashkisë është ngritur komisioni për verifikimin në terren dhe shqyrtimin e dokumentacionit që disponojnë qytetari. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Z. K.H.Xh dhe Z. H .D.Xh, janë pajisur me AMTP, konkretisht Z. H.D.XH pasuria nr.56/8/1 me sipërfaqe 2400 m^2 z.K.H.Xh pasuria me nr. 56/8/2 dhe sipërfaqen 2000 m^2 · Përsa i përket qytetarëve Sh.A.G është pajisur me AMTP nr. 29305/2 me dhe pasuria nr.- 60/1 me sip 8600 m^2 dhe 60/2 me sip 1400 , kurse qytetarët N.G dhe F.G nuk kanë paraqitur dokumentacion por janë plotësuar me tokë në zbatim të V.K.M nr. 531, datë 21.08.1998. Me Vendimin nr. 2, datë 10.07.2003 të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Zharrëz, konfirmuar me Vendimin nr. 39, datë

01.03.2005 të Këshillit të Qarkut Fier, bashkëlidhur fotokopje të Vendimit dhe fotokopje të formularit nr. 6-A .
- Nga verifikimi në teren u kostatua se K.Xhdhe H.Xh, nuk disponojnë tokë tek pasuria nr. 56/8. Te kjo pasuri në fakt me sipërfaqe 4400 e disponon F. A. G., të cilën sip prej 2000 e ka marrë me vendimin nr. 2 datë 10.07.2003 të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Zharrëz, konfirmuar me Vendimin nr. 39, datë 01.03.2005 të Këshillit të Qarkllt Fier, bashkëlidhur fotokopje të Vendimit dhe fotokopje të formularit nr. 6-A .
Duke ballafaquar dokumentacionin u konstatua se; pasuria me nr. 56/8/2 me sipërfaqe prej 2000 m2, ka vepruar Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit Sheqishte në zbatim të ligjit nr. 7501 datë 19.07. 1991 "Për tokën" , ku ka plotësuar me tokë K.XH referuar AMTP me nr. 5942 akti datë 3. 12.1992. Komisioni i ngritur nga kryetarja e Bashkisë sipas Urdhrit nr. 63 datë 14.11.2019 ñMbi shqyrtimin e ankesës së z. K.XH ka bërë verifikimin në teren të problematikës ta adresuar nga KLSH, **duke konkluduar se** ñReferuar AMTP me nr. 5942 akti datë 03.12.1992 në pronësi të zotit K.Xh dhe AMTP ï së me nr. akti 29305/2 datë 04.10.2005 aprovuar me vendimin nr. 2 datë 10.07.2003 të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Zharrëz, konfirmuar me Vendimin nr. 39, datë 01.03.2005 të Këshillit të Qarkut Fierò nuk mund ti jepet një zgjidhje problemit pasi ka mbivendosje dokumentacionesh dhe me shkresën nr. 398/2 prot datë 24.02.2021 i është kthyer përgjigje z. K.XH duke i rekomanduar ti drejtohet gjykatës mbi shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të dokumentacionit dhe përcaktimin e pasurisë sipas AMTP-së. *Veprimet e mësipërme janë në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe nenit 22 të "RRRregullores së brendshme të Bashkisë Patos".*

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Edhe pse për periudhën objekt auditimi janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi si dhe nuk janë planifikuar pozicione me status ñ*ekselent*ò, si dhe pozicione me status ñ*Grup i veçantë*ò, ku përfshihen 17 kategori të ndryshme. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk ka programe të licencuara e për rrjedhojë programet me të cilat punohet nuk garantojnë mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017ò Për financat e vetëqeverisjes. vendoreò, urdhrin e Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017.
(Më hollësisht trajtuar në pikan 1 , faqet 20-39 të Raportit të Auditimit).

<u>1.1. Rekomandimi:</u>Nga Nëpunësi Autorizues, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë

impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa që në rregulloren e brendshme të përcaktohen qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Patos, u konstatua se Njësia e Auditit të Brendshëm ka ushtruar veprimtarin e saj me 2 audites dhe jo me 3 audites sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 114/2015, ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, si dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò. Gjithashtu nga këta punonjës nuk janë kryer trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/ Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, duke mos marrë masa për ngritjen e tyre profesionale.
Nuk është realizuar numri i auditimevekonform planit vjetor të auditimeve dhe planeve strategjikë të miratuar dhe nuk janë pasqyruar këto mosrealizime në planet vjetore për vitet 2019 e 2020, në raportet vjetore si dhe nuk është hartuar procesi i ndjekjes së rekomandimeve për subjektet e audituara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò.
(Më hollësisht trajtuar në pikan 1, faqet 39-47 të Raportit të Auditimit

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB me personel konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke përcaktuar kriteret specifike profesionale për çdo pozicioni të strukturës së NJAB si dhe ndjekë në kohë procedurën për çertifikimin e audituesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Rekomandimi: NJAB në hartimin e planeve vjetore të planifikohen, të kryhet monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara menaxhimit sipas Manualit të AB.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultuan diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera.
Për vitin 2019, shpenzimet janë realizuar në nivelin 83%, ku nga vlera e planifikuar prej 568,065 mijë lekë është realizuar vlera 470,054 mijë lekë me një diferencë 98,011 mijë lekë.
Për vitin 2020, shpenzimet janë realizuar në nivelin 54%, ku nga vlera e planifikuar prej 544,750 mijë lekë është realizuar vlera 385,973 mijë lekë me një diferencë 158,777 mijë lekë.
Për vitin 2021, shpenzimet janë realizuar në nivelin 65%, ku nga vlera e planifikuar prej 686,825 mijë lekë është realizuar vlera 440,921 mijë lekë me një diferencë 245,904 mijë lekë.
Për vitin 2019, të ardhurat janë realizuar në masën 106%, konkretisht nga 203,746 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 216,894 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2018 në vitin 2019 janë 144,542 mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2019 është 138,431 mijë lekë, transferta specifike faktike është 81,613 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2019 është 568,064 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 102%, pra 581,244 mijë lekë. Për vitin 2019 ka pasur një tejkalim të të ardhurave vendore në vlerën 13,179 mijë lekë.

Për vitin 2020, të ardhurat janë realizuar në masën 107%, konkretisht nga 218,869 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 234,208 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020 janë 110,836 mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2020 është 126,610 mijë lekë, transferta specifike faktike është 86,440 mijë lekë, nga FZHR dhe Ministrite e Linjes është alokuar një shtesë me vlerë 265,376 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2020 është 813,574 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 71%, pra 433,422 mijë lekë (383,973 mijë lekë burimet e veta + 49,449 mijë lekë FZHR).
Për vitin 2021, të ardhurat janë realizuar në masën 97%, konkretisht nga 274,201 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 266,847 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vitin 2021 janë 172,121 mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2021 është 144,143 mijë lekë, transferta specifike (shtuar gjatë vitit me 3,683 mijë lekë) është 96360 mijë lekë, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës është alokuar një shtesë me vlerë 316,973 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 313,972 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2021 është 1,003,799 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 71%, pra 993,443 mijë lekë (679,471 mijë lekë burimet e veta + 313,972 mijë lekë FZHR + transferta e kushtëzuar + Ministritë e Linjës). Mosrealizimi në vlerën 29,006 mijë lekë, përbëhet kryesisht nga taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit.
Realizimi i shpenzimeve në masën 54% deri 83% dhe i të ardhurave në masën 97% deri 107%, tregon se buxheti planifikohet mbi nevojat që ka Bashkia Patos dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore dhe vlerave të përcaktuara.
Për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.
Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 pika 1.3 germa ñcò dhe ñçò; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñ*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*ò, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 47-66 të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandimi:Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Patos, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse. Të kryhet në mënyrë të saktë kontabilizimi i të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurohet rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe

Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet i ulët. **Për vitin 2019** investimet janë planifikuar në vlerën **241,808** mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën **185,957** lekë ose **79%**, **për vitin 2020** investimet janë planifikuar në vlerën **192,095** mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën **104,348** lekë ose **54%** dhe **për vitin 2021** investimet janë planifikuar në vlerën **304,894** mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën **110,341** mijë lekë ose **36%**. Duke pasur parasysh se deficiti i të ardhurave për periudhën e audituar nuk ka qenë shumë i lartë, rezultoi se mosrealizimi i investimeve kryesisht ka ndodhur për shkak të mosmenaxhimit të procedurave dhe problemeve në planifikim.
Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 pika 1.3 germa ñcò dhe ñçò; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñ*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*ò, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 47-66 të Raportit të Auditimit)

<u>4.1. Rekomandimi:</u>Nga Bashkia Patos, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e të ardhurave reale, të disponueshme dhe jo të planifikimit, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Patos.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiarerezultoi se llogaria **468 "Debitorë të ndryshëm"** për vitin 2020 paraqitet në vlerën **14,297,594lekë** dhe me 31.12.2021 paraqitet në vlerën **14,298,576 lekë** e cila përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Nga analiza e llogarisë u konstatua se Drejtoria e të Ardhurave dhe ñDrejtoria e Financësò nuk kanë koordinuar punën ndërmjet tyre mbi pasqyrimin e gjendjes debitore të subjekteve taksapagues privat dhe familjar, në vlerën **136,906,723lekë** gjendje 31.12.2021. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò në vlerën **136,906,723 lekë**. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, aneksi 1, pika 3.3, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 "Të ardhurat", pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 75-90 të Raportit të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore për vitet 2020 - 2021 në vlerën **136,906,723 lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

6. Gjetje nga auditi Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos më 31/12/2021 paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Patos ShA me NUIS ñJ.....B dhe numër aksionesh 1,000 me vlerë nominale 14,530 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 14,530,000 lekë. Në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 75-90 të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ñUjësjellës Kanalizime Patos ShA me vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2022

7. Gjetje nga auditimi. Llogaria 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò, më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 28,878,324 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,392,300 lekë, për 41 subjekte të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.Gjatë vitit 2021 shesta janë në vlerën 10,775,298 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 9,261,321 lekë për 12 subjekte. Nga analiza e llogarisë u konstatua se për 26 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 4,186,584 lekë të garancisë së punimeve sipas aneksit nr.11, pika 3, bashkangjitur raportit të auditimit nuk është bërë likuidimi i vlerës së mësipërme të garancisë, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për likujdimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interespublik të këtyre fondeve, në rastet kur në objekt janë konstatuar parregullsi të cilat nuk janë riparuar nga kontraktori, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 75-90 të Raportit të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës të njoftoj subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TË ARDHURAVE TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezulton se në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, nga Bashkia Patos nuk është krijuar një bazë e plotë dhe e saktë të dhënash, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, vlera e likuiduar dhe e pa likuiduar dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave. Gjithashtu nuk është kryer rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Patos, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga Dega e Thesarit Fier.
Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., si dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, kreu VIII ñ*Vlerësimi tatimor*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 66-75 të Raportit të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Patos, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj,), për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë për taksën e ndërtesës, Bashkia Patos nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave. Nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.
Bashkia Patos nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse është aksionare e vetme e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Patos ShA dhe bazuar në pikën (ii) , neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore.
Nga auditimi i taksës së ndërtesës, rezulton me vlerë debitore prej **16,247,474 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i kësaj takse deri në datën 31.12.2021.
Nga auditimi i tarifës së pastrimit, rezulton me vlerë debitore prej **25,922,986 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i kësaj tarife në datën 31.12.2021.
Nga auditimi i tarifës së shërbimit vaditje dhe kullim, rezulton me vlerë debitore

prej**2,337,424 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i kësaj tarife deri në datën 31.12.2021.
Në total, vlera e të ardhurave të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve është **44,507,884 lekë**. Kjo vlerë debitore është e pa kontabilizuar.

Gjithashtu nga auditimi, rezulton se sipas ligjit 7501 ñ*Për tokën*ò, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 4,042 familje dhe 5,588 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 44 %. Nga 4,042 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 2,563 familje ose më shumë se gjysma janë debitore për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit.
Nga auditimi i taksës së tokës, rezultoi vlera totale debitore**40,491,275 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., si dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar, kreu VIII ñ*Vlerësimi tatimor*ò, etj.
Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj.,, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, kreu VIII ñ*Vlerësimi tatimor*ò,, ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 66-75 të Raportit të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Bashkia Patos të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier).
Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masa për të propozuar dhe ŕ miratuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Patos ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.3. Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitore prej **44,507,884 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezulton se Bashkia Patos ka të mbartura nga ish-komuna Ruzhdie 52 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore, të cilat janë lidhur në vitet 2009-2012. Detyrimi për pagesën e qerasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të

cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në Njësinë Administrative Ruzhdie. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëriten gjatë vitit, pagesat e tokës me qera nuk janë bërë në mënyrë të rregullt, duke rezultuar në një vlerë debitore në totale **1,612,831 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar nga struktura e financës.
Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 66-75 të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Bashkia Patos të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,612,831 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezulton se për periudhën objekt auditimi, janë dhënë 1,526 leje legalizimi për 312,567 m^2 sipërfaqe ndërtimi, me vlerë investimi prej 9,842,890,526 lekë. Shuma totale e taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhej vjelë për këtë vlerë investimi (0.5%) është 49,214,453 lekë. Personave të cilët janë paraqitur vullnetarisht në Bashkinë Patos për të bërë pagesën e taksës u është faturuar dhe vjelë vlera 15,816,320 lekë. Diferenca prej **33,398,133 lekë**, e cila nuk është shlyer nga 1,006 posedues të lejeve të legalizimit, për një sipërfaqeje prej 221,087 m^2, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Patos. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 9 dhe 27; VKB Patos ñ*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Patos*ò, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 66-75 të Raportit të Auditimit)

4.1. Rekomandim: Bashkia Patos nëpërmjet bashkëpunimit institucional tôi kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Patos. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **33,398,133 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë, sipas listës në aneksin pasqyrë nr. 15 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave vendore në Bashkinë Patos, rezultoi se ka 142 subjekte debitore nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesisi në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Në fund të vitit 2019 numri i debitorëve është 49 subjekte në vlerën 1,216,763 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve është 142 subjekte në vlerën prej 3,984,802 lekë. Vlera progresive e taksave dhe tarifave vendore të papaguara deri në fund të vitit 2021 (përfshirë vlerën debitore para vitit 2019) është **11,346,600 lekë** (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba). Kjo vlerë përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Patos nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur vlera e gjobës (kamatëvonesës) në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore*ò, me ndryshime, Kreut XI, ñ*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*ò, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ñ*Kodi Penal i RSh*ò me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, i ndryshuar neni 9 ñ*Të drejtat dhe përgjegjësitë*ò pika 1.3., neni 35, ñ*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*ò, me ligjin nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 66-75 të Raportit të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Bashkia Patos, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej **11,346,600lekë** (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba, sipas, sipas listës në aneksin nr. A-16, A-17 dhe A-18 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

***a. T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.**

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme.

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Patos, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Patos ushtrojnë aktivitetin 11 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Për subjektin E. SHPK, me NUIS L.....H, pavarësisht se ka sekuestro konservative për asetet, qëllimi i sekuestros është ndalimi i shitjes së aseteve, statusi në QKB është ñAktivò dhe duhet të pajiset me licencë për tregtimin e hidrokarbureve, duke plotësuar

dokumentacionin dhe likuiduar detyrimet përkatëse.
Për subjektin G.ShPK, me NUIS L.....A, licenca e të cilit ka përfunduar në datën 21.09.2020 dhe për periudhën e mëparshme është debitor në vlerën 900,000 lekë, është llogaritur e gjithë vlera e papaguar, për të cilën ky subjekt është debitor.
Për subjektin B.ShA Zharrëz, me NUIS K.....H, është licencuar për tregtimin me shumicë të hidrokarbureve dhe nuk është subjekt i licencimit nga pushteti vendor.
Pagesat e kryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitore për subjektet e pajisura me autorizime për tregtimin e hidrokarbureve janë paraqitur**,** në aneksin nr. A-22 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Vlera prej **5,550,000 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos.
Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 66-75 të Raportit të Auditimit)

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Patos të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **5,550,000 lekë,** sipas listës/pasqyrës aneks nr. A22 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të AuditimitNë rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE.

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.
Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të nenit 58, ñllojet e masave disiplinoreò të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar,VKM nr. 115, datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Patos, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për një punonjës, si më poshtë:

Për problematikat e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe realizimin e buxhetit, si më poshtë vijon;

1. **Znj. M.SH**, me detyrë Drejtore e Financës, për mos zbatimi të akteve ligjore e nënligjore të mëposhtme:
Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñ*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*ò, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë

17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, neni 9 pika 1.3 germa ñcò dhe ñçò; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñ*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñ*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*ò, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ò; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ò dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

<u>Për problematikat e konstatuara në lidhje me Pasqyrat financiare, si më poshtë vijon;</u>

2. ***Znj..*** **XH.GJ**, me detyrë Përgjegjëse e Kontabilitetit.

- Mos regjistrimi në kontabilitet për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat Financiare për vitin 2020 dhe 2021 të ñUjësjellës Kanalizime Patos ShA.ò në vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
- Mos zbatim të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñ*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*ò Kapitulli I, pika 1. dhe Udhëzimi i MFE nr.8, datë 9.3.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, referuar raportit të auditimit.

<u>Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon;</u>

3. ***Z. A.M,*** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore;

4. ***Znj. S.M,*** me detyrë specialiste në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore;

5. ***Z. E.A,*** me detyrë inspektor në Drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore.

Për mos zbatimi të akteve ligjore e nënligjore të mëposhtme:

Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 ñ*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*ò i ndryshuar; ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, i ndryshuar, ligji nr. 48/2014 ñ*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ò; ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 ñ*Për tokën*ò, i ndryshuar; ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, ñ*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*ò i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò, i ndryshuar, nenet 4, 5, 9 dhe 27; VKM nr. 531, datë 21.08.1998 ñ*Për tokat bujqësore të pandara*ò, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, ñ*Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tôu lidhur me qeramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñ*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*ò; VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa ñbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2., UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, ñ*Për Taksat Kombëtare*ò, UKM nr. 1, datë 18.07.2012 ñ*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*ò, etj.

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësen e mëposhtëm nuk rekomandojmë masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi punonjësja ka dalë në pension:

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte: *mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj:*

1- Znj. A.L, me detyrë ish Drejtore e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, aktualisht dalë në pension.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Patos pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Patos pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, indryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT